

Qendra për Aksion të Padhunshëm
Beograd / Sarajevë

PAJTIMI?!

Doracak për punë me ballafaqimin me të kaluarën
përmes trajnimeve dhe punëtorive

Ivana Franović • Nenad Vukosavljević • Tamara Shmidling

PAJTIMI?!

PAJTIMI?!

Doracak për punë me ballafaqimin me të
kaluarën përmes trajnimeve dhe punëtorive

Qendra për Aksion të Padhunshëm
Beograd - Sarajevë

Titulli i originalit:

POMIRENJE?!

Priručnik za rad na suočavanju sa prošlošću kroz treninge i radionice

© CNA, 2012

PAJTIMI?!

Doracak për punë me ballafaqimin me të kaluarën
përmes trajnimeve dhe ushtrimeve

Ivana Franoviq Nenad Vukosavljeviq Tamara Shmidling

Përkthimi: Ardian Saliu

Lektura: Rexhep Rexhepi

Kontrollloi: Albulena Karaga, Fllanza Jusufi Saliu



Qendra për Aksion të Padhunshëm

Beograd – Sarajevë, 2012

Pajtimi

Doracak për punë me ballafaqimin me të kaluarën nëpërmjet trajnimeve dhe ushtrimeve

Botues në Republikën e Maqedonisë:

Aksioni Paqësor, Prilep – Tetovë

Redaktore:

Ivana Franoviq

Autore/ë:

Nenad Vukosavljeviq

Ivana Franoviq

Tamara Shmidling

Përkthimi:

Ardian Saliu

Lektura:

Rexhep Rexhepi

Kontrolli:

Albulena Karaga, Fllanza Jusufi Saliu

Dizajni:

Ivana Franoviq

Fotografite:

Nenad Vukosavljeviq

Nexhad Horozoviq

Ilustrimet:

Dushan Pavliq

Shtypi:

Shtypshkronja Acetoni

Botimin e këtij libri e ka ndihmuar Ministria për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim e Republikës Federative të Gjermanisë (BMZ)

2019

*As lejlekët këtu nuk vijnë më
Nuk ju shijojnë më shishet tona
Ballkani, thjeshtë s'ju shkon më për shtati
Ngaqë, mëkat është të lindish fëmijë aty ku fluturojnë plumbat*

...

*Por mos e çani kokën
Tani do të ketë zgjedhje, ja ku po afrohen fushatat për të na e tërhequr vëmendjen
Do na sjellin zgarë në fshatin tonë
Do ndahen salçiqe, do rrotullohen qengja e gica
Që të harrojmë modricat
Kuletat e zbrazëta
dhe kartelat tona bosh*

...

*Ngaqë, mëkat është të lindish fëmijë aty ku fluturojnë plumbat
Por përsëri budallenjtë, budallenj të ri udhëheqin
Përsëri ikën lejlekët e mi
Nuk e di për ju o njerëz, por unë i dua lejlekët tanë
Ata ashtu si unë, duan paqen, duan fusha të pastërta dhe ujra të pastër
Ujë pa kufoma dhe fusha pa mina
Ata fëmijë sjellin,
E unë, sot a nesër, do të doja të kem një bijë ose bir.*

Edo Maajka

Përmbajtja

Parathënie	9
Ballafaqimi me të kaluarën në hapsirat e Ish Jugosllavisë <i>Nenad Vukoslavljeviq</i>	13
Për qasjen e punës të QAP në ballafaqimin me të kaluarën <i>Ivana Franoviq</i>	23
Për trajnimet e QAP <i>Tamara Shmidling</i>	30

SHEMBUJ TË USHTRIMEVE PËR KRIJIMIN E PUNËTORIVE

Të njoftuarit/ ushtrimet hyrëse 39

- Rethet koncentrike për njohje 41
- Emri im 43
- Diagramet e Venit 43
- Pritshmëritë nga trajnimi 44
- Ruga ime deri këtu 45
- Vendet që i kam të rëndësishme (Harta) 46
- Vendi nga ku vij 46
- Vendi ku jetoj 47
- Biseda ne çiftin e zgjedhur 48
- Unë të prezantoj 48
- Tre ngjarjet që kanë ndikuar në angazhimin tim 49
- Kjo fotografi flet për mua... 49
- Tre identitetet e mia 49
- Dy të vërteta dhe një gënjeshtër 50
- Si jemi të lidhur mes veti 50
- Unë prezantohem 51
- Veri-Jug, Lindje-Perëndim 51

Ushtrimet për të kuptuarit e kontekstit në të cilin jetojmë 53

- Barometri i madh: Dhuna 55
- Paragjykimet për grupet etnike 58
- Asociacionet 59
- Imazhet e armiqëve 60
- Imazhet e armiqëve (2) 60
- Mohimi 61
- Vështrimi tjetër 62
- Një hapë përpara 63
- Katrorët/pikat e vogla 65
- Ishulli 66
- Autobusi 66
- Hartimi/Mapimi i patriarkatit dhe militarizmit në shoqëritë tona 67
- Komuniteti im 68

Ushtrimet për shtjellimin e temës “ndërtimi i paqes” 69

- Lumi i paqes 71
- Kontributi im për ndërtimin e paqes/pajtimit 71
- Çka mund të bëjmë (“Situatat”) 72
- Situatat 2 (versioni për trajnim me veteranë) 73
- Barometri i madh: “Është ndërtim paqeje”
- – “Nuk është ndërtim paqeje” 74
- Çka kontribuon për ndërtim të paqes 75
- Çka na tregon se (nuk) jetojmë në paqe? 76
- Çka mund të shkaktojë ndonjë luftë të radhës? 76
- Prioritetet e ndërtimit të paqes nëpër rajonet dhe shtetet 76

- Cilët janë sfidat në ndërtimin e paqes? 76
- Alternativat 76
- Ndërtimi i paqes dhe unë 77
- Treshet rotulluese rreth aktivizmit paqësor 78
- Si e kuptoj ndërtimin e paqes? 79
- Përse pajtim? 79
- Kush me kë/me çfarë duhet të pajtohet? 80
- Puna në mjediset lokale 80

- Kriteret për aktivistët/et (Ishulli “Dub”) 81
- Pritshmëritë nga aktivistët/et paqësor/e 82
- Barometri i madh: Çka është/nuk është etike? 83
- Situatat me vështirsi në punë 84
- Ushtrim me detyra rreth ndërtimit të paqes 84
- Ushtrim me detyra rreth ndërtimit të paqes (2) 87
- E kaluara-e ardhmja 88
- Karrigeja e fuqishme 88

Ushtrimet për shtjellimin e temës “ballafaqimi me të kaluarën”

89

- Gazetat e murit hyrëse 91
- Barometri laraman (aka “Sytë e laramane”) 91
- Ballafaqimi destruktiv dhe konstruktiv me të kaluarën 92
- Barometri: Çfarë (nuk) kontribuon për ballafaqimin me të kaluarën 92
- “Hotelet” 94
- Karriget e nxehta: Lufta dhe unë 95
- Karriget e nxehta: Më vjen keq... 96
- Çka më pengon në tregimet për luftën? Çka më mungon? 97
- Mohimi – arsyetimi – kërkimi i së vërtetës 97
- Qasja e shoqërive tona ndaj të kaluarës 97
- Çka do të ishte një raport i ndershëm ndaj së kaluarës? 98
- Narrativet kolektive rreth luftërave të fundit 98
- Narrativet familjare 99
- Kur arsyetohet lufta? 99
- Çfarë duhet të përkujtojmë ne si shoqëri? 100

- Barometri rreth ballafaqimit me të kaluarën 101
- Akuariumi rreth ballafaqimit me të kaluarën 102
- Pro dhe kundër 103
- Ballafaqimi me të kaluarën në shoqërinë time 104
- Unë dhe pajtimi 104
- Çfarë mund të bëj unë? 105
- Heronjtë 105
- Tabutë 106
- Memorializimi: përmendoret 106
- Kultura e përkujtimit para dhe pas viteve nëntëdhjeta 107
- Lajme nga e ardhmja 107
- Drejtësia – falja – e vërteta – pajtimi 108
- Drejtësia – falja – e vërteta – paqja 109
- Kolazh i së kaluarës 110
- Thuaje 110
- Luajta e roleve – aktorët/et e ballafaqimit me të kaluarën 111

FJALORTH

- Amnistia 115
- Sprastrimi etnik 116
- Gjenocidi 117
- Kujtesa kolektive dhe narrativet nacionale 118
- Komisonet për të Vërtetën 120
- Faji dhe përgjegjësia 122
- Kultura dhe politika e përkujtimit 123
- Lustrimi 124
- Tribunali Penal Ndërkombëta për ish-Jugosllavinë (TPNJ) 125

- Vendet e përkujtimit dhe memorializimi 126
- Falja 127
- Pajtimi 128
- Mohimi 130
- Reparacionet 132
- Drejtësia restauruese 133
- Drejtësia retributive/ndëshkuese 134
- Imazhet e armikut 135
- Drejtësia tranzicionale 136
- Viktimizimi 137

Parathënie

Muajin e kaluar mbaruan 15 vite që nga themelimi i Qendrës për Aksion të Padhunshëm. Kanë kaluar edhe 12 vite që kur kemi botuar¹ doracakun *Padhunshmëria*?² Gjatë kësaj kohe, fokusi i programeve tona për arsimim për paqe ka ndryshuar bashkë me rrethanat shoqërore-politike. Ashtu si kanë kaluar vitet që nga përfundimi i luftërave dhe si kanë filluar plagët të shërohen, ashtu është krijuar hapësirë për të punuar në temat e rëndësishme politike dhe emocionale.

Në fund të viteve të nëntëdhjeta dhe në fillim të vitit dymijë ngjarje me rëndësi ka qenë që njerëzit nga vendet e ndryshme të ish- Jugosllavisë thjeshtë të takohen. Aso kohe ka qenë gati e pamundur të flitet lidhur me temën e “identitetit nacional”, e rreth paragjykimëve etnike as të mos flasim, por e kemi përmendur shkarazi në kuadër të temës së përgjithshme, “identitetet”. Vërtetë, mjaftonte që të parashtrohet pyetja rreth përkatësisë nacionale dhe megjithëqë kishte hapsirë të mos deklarohemi në qoftë se nuk kemi dëshirë, niveli i stresit në hapësirën e punës bëhej aq i dukshëm, sikur të kishte hyrë ndonjë mjegull aty brenda, ndërsa shumë fytyra rrinin të ngrira nga frika... Kur shikojmë nga perspektiva e sotshme, trajnimet e atëhershme kanë qenë relativisht të buta, pasi që kanë hapur tema kërkuese dhe të ndjeshme me shumë kujdes dhe në mënyrë sipërfaqësore (të cilat sot nuk i përfjetojmë si të tilla). Megjithatë, e di se edhe atëherë kemi punuar deri në kufijtë e caktuar të mundshëm. Shkëmbimi i ndërsjellë atëherë ishte shumë më emocional, dukuri e shpeshtë ishte që gjysma e grupit të qanin duke përfshirë edhe ekipin e trajnerëve, pasi që historia e dikujt na ka tronditur ose e kemi pasur vështirë që t' dalim ballë temës. Edhe sot e kësaj dite nuk jemi imun ndaj atyre derdhjeve të emocioneve, por nuk më kujtohet se kur kam përjetuar për së fundi herë që gjysma e njerëzve të qajnë ose të pyetemi se a guxojmë që të pyesim njerëzit që për nevojat e ushtrimit të ndahen në grupe sipas etnisë dhe të mos pyetemi se a do të çohet dikush dhe të shkojë në shtëpi që nga ai moment.

¹ Për shkak të transparencës së tekstit në pjesën më të madhe të doracakut më shpesh do të përdoret si gjenerike gjinia mashkullore, edhe pse në ekipet e trajnerëve si dhe në trajnimet kanë marrë pjesë, njëjtë në numër, persona të gjinisë femrore dhe mashkullore. Këtu ai i referohet të dy gjinive, në qoftë se nuk është përcaktuar ndryshe.

² Nenad Vukosavljeviq. *Padhunshmëria? Doracak për trajnime me temë përpunimi padhunshëm i konflikteve për punë me të rritur* (Sarajevë: CNA, 2000)

Siç kalonte koha, ashtu lëvizte edhe fokusi i trajnimit. Ndonjëherë si temë kyçe kishim shtjellimin e padhunshëm të konflikteve, ndërsa pastaj saqë mundej, edhe konfliktet në shoqëri, raporti ynë ndaj tyre, përgjegjësia ndaj tyre, etj. Sot për tema kyçe kemi ndërtimin e paqes dhe ballafaqimin me të kaluarën, dhe pa vështirësi të mëdha diskutojmë edhe me termet siç janë lufta, krimet e luftës, spastrimet etnike, serbët, kroatët, shqiptarët, përgjegjësia individuale dhe kolektive, pajtimi, dhe askush nuk largohet nga vendi për shkak të të përmendurit të këtyre termeve. Në disa momente edhe emrin e programit për arsimim për paqe e kemi ndryshuar nga *Trajnimi për përpunimin e padhunshëm të konflikteve në Trajnim për ndërtimin e paqes*, pasi që ky emërtim e përshkruan më mirë fokusin e trajnimit.

Gjatë asaj kohe kemi mësuar shumë gjëra. Ky doracak në fakt paraqet tentim për të sistematizuar një pjesë të asaj dijenie dhe përvojë që ta ndajmë me të tjerët. Kur kemi filluar të hapim temën për ballafaqimin me të kaluarën, ndodhte që tërë natën në trajnime të çajmë kokën me atë se çfarë është e mençur të bëjmë nesër, pa asnjë lexim që të na inspirojë, duke u mbështetur veçanërisht në dijet dhe përvojat e deri atëherëshme dhe vlerësimin se ku gjenden njerëzit për momentin në grup, dhe deri ku mund të shkojnë. Në dispozicion nuk kemi pasur asnjë doracak në lidhje me këtë temë, por do të na shërbente shumë në situatat e tilla. Mësonim nga puna e drejtpërdrejtë me njerëzit. Ndonjëherë nuk kemi qenë të sigurt se a është mirë të bëjmë diçka ose jo, a është ndonjë detyrë tepër e rëndë ose jo, (pasi që gjithmonë jemi munduar të shkojmë deri në kufirin e mundshëm), mirëpo, atëherë atë gjë e kemi kontrolluar me pjesëmarrësit e trajnimit – se sa janë të gatshëm që të ballafaqohen me detyrën e vështirë. Nga ata/ato kemi mësuar më së shumti.

Idea e për krijimin këtij doracaku ishte në fakt dëshira që të ndajmë përvojën e mbledhur. Mendojmë se në rajon ekziston deficit i qasjes konstruktive të ballafaqimit me të kaluarën, dhe shpresojmë se me këtë do të inkurajojmë edhe disa njerëz të tjerë që të angazhohen për punë. Vetëm në vitin e fundit, 12 vite pas botimit, doracaku *Padhunshmëria?* është shkarkuar nga faqja e internetit 30.000 herë (më së shumti në gjuhët “bks”, por edhe në versionet e gjuhës hungareze, maqedonase dhe shqipe). Kjo tregon se ka qenë i vlefshëm investimi i gjithë energjisë për të punuar për të, përkthimi dhe botimi. Mes tjerash, kjo na ka inkurajuar që të botojmë gjërat e reja që kemi mësuar dhe deri ku kemi arritur.

Shpresojmë që ky doracak do t'u shërbejë të tjerëve si frymëzim për punë konkrete në lidhje me këto tema. Dhe se disa njerëz në pjesët tjera të botës të cilët sapo fillojnë ose mendojnë të fillojnë të punojnë me tema të tilla të kenë guxim të fillojnë, se sado që e vështirë që duket, mund të punojnë.

Ky doracak përbëhet nga tre blloqe. Në të parin janë seri të teksteve hyrëse me të cilat kemi tentuar të përshkruajmë kontekstin në të cilin punojmë (ose si e përjetojmë), të qartësojmë qasjen të cilën e kemi dhe të japim imazhin e asaj se si funksionon trajnimi. Në pjesën qendrore ka katër kapituj me ushtrime të cilat i përdorim në trajnime, ndërsa numri i madh i tyre është i shoqëruar me njohuritë praktike deri tek të cilat kemi arritur. Në fund ndodhet “Fjalori i termeve”, të cilin e kemi paramenduar si koleksion të teksteve të shkurtra relevante për ballafaqimin me të kaluarën.

Shumica e ushtrimeve të shënuara janë të krijuara në “kuzhinën e QAP”. Më efektive kanë qenë ato të cilat i kemi krijuar për grupe të caktuara, të inspiruar nga puna me ata njerëz konkret. Këtë e kemi vërejtur shumë herët, kështu që, me vite të tëra praktikojmë që pjesën më të madhe të trajnimit nuk e përgatisim më herët, por e përgatisim në bazë të nevojave dhe vështirësive që has grupi i caktuar dhe kohën e mbushim me atë që është prioritet. Dhe shpresojmë se këtë mësim do ta përçojmë tutje: doracaku nuk duhet shfrytëzuar si recetë për ushqim, por nga situata të vendoset se çfarë do të servohet si para haje, si ushqim kryesor dhe çfarë do të ketë për desert.

Roli i tij do të duhej të jetë që në radhë të parë të inspirojë edhe idenë se si duhet diçka të bëhet, por më së miri është që pyetjet kryesore t'i formuloni vet, në varësi të nevojave të grupit me të cilin punoni.

Dilemë të madhe kemi pasur rreth specifikimit të burimeve për ushtrimet e veçanta, pasi që nuk mund të përcaktojmë me saktësi origjinën e autorit të tyre. Në shumicën e rasteve jemi shërbyer me përvojat e mbledhura nga detajet e dokumentacioneve të cilat kemi përpiluar pas çdo trajnimit, mirëpo, edhe nga doracaku jonë i mëparshëm. Sigurisht që, metodat kyçe nuk i kemi përpiluar ne (barometri i madh dhe llojet tjera të barometrave, akuariumi, karriget e nxehta, etj), por i kemi mësuar në vende të ndryshme dhe nga shumë njerëz. Që nga fillimi frymëzim i madh për ne ka qenë organizata jonë simotër Kurve Wustrow dhe trajnerët/et që mblidhte. Nga doracakët që ekzistojnë, më i dobishmi për ne ka qenë doracaku *Community Conflicts Skills* i autores Mary Fitzduff, një libër plot frymëzim. Kemi mësuar dhe kemi pasur mbështetje nga: Goran Bozhiçević, Diana Francis, Ana dhe Otta Raffai, Care Gibney, Vesna Tersheciq, Boro Kitanoski, Amela dhe Rendy Puljek-Shank, Annemari Myller dhe shumë të tjerë. Ndërsa më me intensitet kemi mësuar nga vet pjesëmarrësit/et e trajnimeve të cilët kanë kontribuar në atë proces aq sa edhe ne vet. I falënderoj të gjithë për këtë.

Mirënjohje të madhe kemi edhe për Dr. Martina Fischer nga fondacioni Berghof e cila ka qenë me ne gjatë të gjitha këtyre viteve, e cila na ka mbështetur dhe na ka dhënë këshilla të dobishme. I falënderojmë edhe ata të cilët na kanë mbështetur financiarisht, ndërsa veçanërisht Ministrinë për Zhvillim të Gjermanisë (BMZ) dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme të Zvicrës, të cilët kanë qenë mjaft fleksibil dhe na kanë dhënë hapësirë që të provojmë të hapërojmë në rrugët e pashkelura. Faleminderit edhe të gjithëve të cilët janë kyçur në ekipet tona të trajnerëve për shkëmbimet reciproke dhe të eksperiencës, dhe veçanërisht i falënderoj anëtarët dhe anëtare e tanishme dhe të dikurshme të ekipit të QAP-it.

Në fund, pranoj se kemi pasur privilegjin që jo një, po tre mikeshat tona të dashura të lexojnë me kujdes versionet e para të këtijë doracaku dhe të na japin sugjerimet, pikëpamjet dhe pyetjet e tyre të çmuara: Marija Stojciq, Davorka Turk i Katarina Miliçević, ja faleminderit nga zemra.

Ivana Franović

Tetor, 2012

Ballafaqimi me të kaluarën në territoret e ish Jugosllavisë

Nenad Vukosavljeviq

Kuptimi

Të përpunosh një përvojë të rëndë lufte, të mësohesh të jetosh me të, do të thotë t'i japësh kuptim asaj përvoje traumatike kolektive dhe individuale, asaj përvoje pasigurie, humbjeje, frike, urrejtjeje. Shoqëritë tona në territoret e ish Jugosllavisë në të kaluarën e tyre kanë qenë shpesh të ballafaquara me sfidën që t'i gjejnë kuptim luftës dhe sakrificës dhe ato tashmë kanë mekanizmat e tyre të vendosura për caktimin e themeleve dhe ceremonive për përkujtim të përbashkët, me të cilat i vërtetojmë identitetet tona. Identitetet kolektive, si kritere të vuajtjeve, e kanë ndrydhur pikëllimin për humbjen e njerëzve të afërt dhe kanë ofruar aureolën e viktimës kuptimplotë për kolektivin. Kolektivizimi i viktimave ka paraqitur edhe kolektivizimin e pikëllimit. Bashkë jemi ndjerë të pikëlluar dhe krenarë, kokëllartë dhe sfidues. Para së gjithash, jemi ndjerë të bashkuar.

Pas Luftës së Dytë botërore, përkujtimi kolektiv i viktimave të asaj lufte është vënë në shërbim të krijimit të mbështetjes së regjimit të ri socialist. Koncepti i lirisë është njësuar me revolucionin socialist, rezistenca ndaj okupatorit është vendosur në kontekst të bashkim vëllazërimit të popujve dhe kombësive tona. Përkujtimi i luftës, në vend të pikëllimit dhe dëshpërimit, ka festuar sakrificën heroike të heronjve të njohur dhe të panjohur, ka ofruar shpresë për një të ardhme më të mirë dhe na ka ushqyer ndjenjën e krenarisë kolektive.

Kultura e përgjithshme e të përkujtuarit ka qenë e varur nga politika e të përkujtuarit, ndërsa politika ka qenë në shërbim të frymës kolektive, e dizajnuar në një rreth autoritar. E kaluara është përcaktuar me lehtësi, jo rrallë është zbuluar ose me kast është keqinterpretuar, që t'i përshtatet më mirë frymës “tonë” të drejtë kolektive, kundrejt “*armiqve të jashtëm dhe tradhtarëve në mesin tonë*”. Ajo që nuk ka guxuar të vihet në pyetje ka qenë versioni bardhë e zi, “ne” dhe “ata”, historia dhe realiteti ekzistues. Zërat e mospajtit shpallëshin akte armiqësore, dhe përballeshin me zemërimin e drejtësisë së “punëtorëve dhe fshatarëve”, të udhëhequr nga censorët e shtetit një partiak, për këtë shkak zhdukeshin shpejt. Identiteti jonë i viktimës do të ishte i pakuptimtë pa kolektivin armiqësorë, ndërsa heqja dorë nga insistimi i armiqësisë i është referuar bujarisë sonë kolektive. Ashtu ka qenë, por edhe sot në të shumtën e rasteve ndodh e njëjta. Radikal, mirëpo, transformim i kryer butë i “popullit punëtor socialist” në serb të Mëdhenj, kroat të Mëdhenj... në fillim të viteve nëntëdhjeta nuk solli ndarjen e matricës autoritare kolektive. Përkundrazi. Në

kurriz të ngjashmërive, dallimet mes ish “popujve vëllezër” shpesh potencohen deri në absurditet.

Ata të cilët kanë diktuar vendosjen e politikave të reja të përkujtimit (me prapavijë të ndryshme etnike dhe ideologjike) në fakt kanë qenë “bijtë më të mirë” të atij sistemi autoritar komunist, e kanë mësuar atë shkollë dhe e kanë përsëritur të njëjtën shkollë të mendimit, duke zbatuar metodat e njëjta të ngrirjes së historisë që të jetë joshëse, më e bukur dhe e lehtë për ta pranuar. Ndërsa, nuk ka pasur rezistencë shumë të madhe ndaj historisë së re, pasi që ndjenja e dëshiruar e sigurisë është e mirë kur diçka është e njohur, kur e dimë se si thirret, si zbatohet dhe si mbrohet.

Nacionalizmi është ideologji e vetës së parë shumë, e cila na tregon se kush jemi ne dhe njëkohësisht edhe ideologjia e vetës së tretë, pasi që na tregon edhe atë se kush nuk jemi *ne*³. Ndërsa mitet nacionale ushqehen me histori, me viktimat e veta, me virtytet e veta të drejtësisë, me ndershmërinë, me dashurinë për lirinë dhe krenarinë. Luftërat janë burimi i tyre më i mirë, ndërsa aleati më i mirë është keqpërdorimi politik i religjionit.

Krejt ajo me të cilën duhet të ballafaqohet kolektivi veç më është e përfshirë në paketën e lartpërmendur.

Për këtë shkak termi ballafaqimi me të kaluarën është shumë i urryer, pasi që tek njerëzit zgjon frikë se do t'u merret kuptimi i cili u është ofruar/imponuar, sado i konstruktuar ngathët dhe bosh qoft ai. Që të jetë i suksesshëm procesi i ballafaqimit me të kaluarën, ai duhet të ofrojë dhe të komunikojë me përgjigje të qarta dhe jo të dykuptimta rreth kuptimit të tij, duhet të ndryshojë imazhet e thjeshtësuara të krijuara nga lufta e kënde, duhet të ndërtojë ura dhe të fitojë, duhet t'u shmanget kurtheve të drejtësisë, të tërheqë masë të madhe të popullit ose të dënohet me rrënim, ndërsa ne me përsëritjen e historisë.

Ballafaqimi konstruktiv me të kaluarën duhet të nënkuptojë konstatimin e përbashkët e jo kundërthënës dhe të anshëm të fakteve rreth ngjarjeve të luftës. Kjo është e rëndësishme me qëllim që të vendoset e vërteta me të cilën në të ardhmen nuk do të mund të manipulohet dhe shtrembërohet sipas nevojave politike. Kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme edhe për njerëzit, të afërmit e të cilëve kanë vuajtur nën rrethana të paqarta. Ata me këtë fitojnë siguri dhe një lloj qetësie, ndërsa njëkohësisht edhe situata konfliktuale transformohet në bashkëpunim. Respektimi i viktimave të palës tjetër bëhet i kuptueshëm, i mundshëm dhe i dëshirueshëm, ndërsa hapet hapësira për rishikimin e narrativeve kolektive. Në fund ose në fillim të atij procesi, gjithsesi edhe gjatë, në brendinë të tij, shoqëria e cila e shtyn këtë proces bën një distancim nga padrejtësitë e bëra në emër të të gjithëve, duke marrë përsipër përgjegjësinë për të kaluarën, e me këtë krijon ardhmëri më të sigurt dhe më të parashikueshme.

Ky proces është pak ilaç i hidhur sepse nënkupton ballafaqim me idetë e gabuara personale. Ai nënkupton se një numër i madh i individëve duhet të ndryshojnë botëkuptimet e veta, të shohin idetë e gabuara dhe gabimet, të rishikojnë mitet dhe besimet dhe të tejkalojnë ndjenjën e turpit që të bëjnë hapat drejt ndryshimit të vetes dhe opinionit publik. Kush mendon se njerëzit ndryshojnë ashtu që duhet t'u biesh në kokë (figurativisht ose jo⁴), duke i dënuar pasi që janë të fajshëm për dallim nga *ne të mirët, të mençurit dhe të drejtët të cilët gjithmonë jemi në të drejtë*, le të pushojë me veprimin e vet për ndryshimin e shoqërisë. Që tani e tutje.

Pasi që, më keq është të harxhosh dhe të komprometosh një ide të mirë, sesa ajo të mos ketë ekzistuar kurr.

³ Michael Billig. Nacionalizmi banal (Beograd: Biblioteka e shek. XX, 2009)

⁴ Me nënçmim, me ofendim, me nënvlerësim.

Kush i pari?

Procesi i ballafaqimit me të kaluarën në shtetet e ish Jugosllavisë nga lufta e këndej është zhvilluar joproporcionalisht. Ka munguar konkurrencë siç ka qenë gjatë përpjekjeve që sa më shpejt të kyçemi në pompën monetare të Bashkimit Evropian, pardon, që sa më shpejt të përmbushim standardet Evropiane të organizimit dhe menaxhimit, dhe që pikërisht shteti jonë të jetë më evropiani, me ç'rast në mënyrë indirekte tregojmë “jo-evropianitetin” e atyre që kanë ngecur apo janë penguar gjatë asaj rruge.

Çdo shtet, por edhe pjesë të caktuara të shteteve janë subjekt i specifikave të tyre, për shkak të ngjarjeve të ndryshme të luftës që i kanë kapluar, si dhe për shkak intensitetit të ndryshëm të ballafaqimit me të kaluarën dhe masat të cilat i kanë aplikuar me shpresë se ai proces do të ndodh. Gjegjësisht, që ai të drejtohet në mënyrën e njëjtë ideologjike siç ka ndodhur deri tek luftërat e viteve nëntëdhjeta. Derisa në të kaluarën ai proces ka qenë në shërbim të sistemit autoritar kuazisocialist, këtë herë është drejtuar që të jetë në shërbim të miteve nacionale, i akomoduar për nevojat e homogenizimit nacionalist, do të thotë, segregacionit ndaj tjerëve.

Çfarë ballafaqimi?

Më lehtë është të përshkruash gjendjen ndaras, veç e veç nëpër shtete dhe regjione edhe pse kjo nuk vlen për qëllimin e arritjes së suksesit në procesin konstruktiv të ballafaqimit me të kaluarën. Nënvizoj fjalën “konstruktive”, pasi që e kaluara e luftës është shumë e pranishme në publik si objekt i manipulimit nacionalist, ashtu siç janë edhe interpretimet e saj të njëanshme dhe të thjeshtësuara. Me të kaluarën e luftës në hapësirën publike manovrohet çdo ditë, ajo çdo ditë është e pranishme në jetën tonë. Interpretimi i thjeshtësuar nënkupton se “ne” gjithmonë jemi mbrojtur, se krimet mbi popullin tonë ishin brutale, ndërsa ata krime që janë bërë në emrin tonë zvogëlohen ose relativizohen dhe arsyetohen. Populli i do të vërtetat e thjeshta⁵, andaj nuk është befasi pranimi aq i gjërë i atyre narrativeve të cilat përshtaten me konceptin e madhërimit historik të kombit tënd dhe nënçmimit të tjerëve, “nga të cilët dallojmë shumë, dhe se thjeshtë, çudi është që edhe ne edhe ata i takojmë qenies njerëzore”.

Ky theksim i qasjes konstruktive dhe destruktive ndaj të së kaluarës së luftës ka për qëllim të qartësojë dhe të nxjerr në pah se shoqëritë tona janë marrë me përpunimin e ndodhive të luftës që nga fillimi, dhe se ajo që ne zakonisht e quajmë ballafaqim me të kaluarën, më së shpeshti është vetëm përpjekje që brenda diskursit ekzistues të futen dimensionet e harruara, të lëna pas dore dhe faktet. Ballafaqimi me të kaluarën i cili është në shërbim të ndërtimit të paqes, me vetë këtë, është në konflikt me interpretimet e së kaluarës të cilat lindin nga matrica ideologjike e nacionalizmit agresiv. *Konflikti/përplasja zakonisht nuk është ana më e më e fortë e paqësorëve, dhe shpesh diskursi paqësor lëviz vijës të cilën e relativizojnë ata që merren me kokëfortësi me të drejtat e njeriut.* Të them të vërtetën, ballafaqimi me të kaluarën mund të del nga kurthi i relativizimit (për shkak të pajtimit të menjëhershëm), dhe njëkohësisht të mos thellojë plagët ekzistuese dhe mosbesimin. Arti i lëvizjes në këtë trajektore (konstruktive, dhe pa frikë nga përplasja) shtrihet në përcaktimin konsekuent në nivel vlerash në padhunshmëri, ndërsa përcaktimi procesor drejt dialogut, bashkëpunimit, reflektimit dhe vet reflektimit.

⁵ Edhe për mua janë të dashura, pasi që nuk kërkojnë përpjekje në të kuptuarit, janë të qarta dhe pa kuptim të dyfishtë, bardhezi, shpejt pranohen dhe transmetohen, ndërsa u ngjanë edhe zbukurimi.

Konteksti dhe aktorët

Konteksti i ballafaqimit me të kaluarën dhe ndërtimin e paqes në territoret e ish Jugosllavisë e përcakton fortë edhe ekzistimin e Tribulani Penal Ndërkombëtar për Krime Luftë në territorin e ish Jugosllavisë, të cilin e kanë e kanë themeluar Kombet e Bashkuara dhe i cili gjendet në Hagë të Holandës. Përveç këtij institucioni, për përpunimin e shkeljeve të të drejtave ndërkombëtare të luftës dhe zakoneve të luftës, gjyqet nacionale në masë të madhe ose në masë të vogël, por edhe të pamjaftueshme kanë marrë detyrën e ndjekjes dhe procesimit të përgjegjësve për krime lufte. Detyra themelore e procesimit të krimeve të luftës duhet të jetë krijimi (i asaj apo kësaj) drejtësie dhe krijimi i parakushteve për procesin e pajtimit. Megjithatë, vet familjet e viktimave ose vet viktimat e torturave kryesisht kanë qenë të pakënaqur me vendimet gjyqësore, ndërsa nevoja për pranimin e padrejtësisë së bërë, rrallë herë është bërë. Procedurat kundër atyre “nga ana e vet” shpesh kanë qenë të vlerësuara si të padrejta, ndërsa përgatitja e gjyqeve vendase që të procesojnë oficerë të rangut të lartë dhe politikanë ka qenë shumë e ulët. Proceset gjyqësore nuk kanë ndjekur krijimin e diskontinuitetit me politikën nacionaliste dhe matricat kulturore të cilat mbështesin dhe arsyetojnë dhunën dhe diskriminimin ndaj etnisë dhe çfarë do lloj diversiteti tjetër. Nën rrethana të tilla, një numër i madh i organizatave të shoqërisë civile me vendosshmëri dhe këmbëngulje me dokumentimin e tyre kanë mundur një numër të madh të proceseve gjyqësore⁶ ose kanë siguruar vendosjen e fakteve rreth numrit të viktimave⁷, që nga njëra anë ka ndikuar edhe në ndryshimin e vetëdijes publike në shoqëritë tona rreth ngjarjeve të luftës. Për transformimin e atmosferës së armiqësisë në shoqëritë tona, siç janë krijuar dhe ekzistojnë edhe pas luftërave, ekziston një periudhë më e gjatë se ajo 10-15 vjeçare dhe një spektër shumë më i gjerë i masave, veç proceseve gjyqësore dhe procesimit të shkeljes së të drejtës së luftës. Në fund të fundit, humbja e jetëve të ushtarëve gjatë veprimeve “të zakonshme” ushtarake nuk janë subjekt i hetimeve për përgjegjësinë, ndërsa ajo humbje dhe shtjellimi i saj në nivel shoqëror janë shumë të rëndësishëm për procesin e ballafaqimit me të kaluarën dhe ndërtimin e kulturës shoqërore të kujtimit e cila do të ishte në funksion të ndërtimit të paqes e jo glorifikimit të luftës.

Përveç kësaj, procesi i ballafaqimit me të kaluarën për ndërtimin e paqes ka për detyrë të përfshijë një numër të madh të shtresave shoqërore dhe nuk guxon të jetë vetëm një fushë e ngushtë e veprimit të shoqatave të viktimave dhe organizatave joqeveritare të shoqërisë qytetare. Bëhet fjalë për shërimin e shoqërisë. Merremi me të kaluarën që të kemi një të ardhme më të mirë dhe më ndryshe për të gjithë qytetarët dhe qytetarët. Procesimi i padrejtësive të bëra, nga vrasjet dhe dhuna, uzurpimi i pronave e deri tek dëbimi, gjithsesi se janë detyra të domosdoshme në drejtimin e shërimit të shoqërisë. Edhe atëherë duhet të pyetemi se çfarë funksioni ka dënimi dhe çfarë pritet dhe çfarë fitojmë nga ai. Do të dëshiroja që në vend të fjalës procesim të përdor fjalën korrigjim të padrejtësive, mirëpo, e di se është e pamundur. Nuk ka përmbushje të nevojave, nuk ka korrigjim, mund të ketë vetëm gjykime shoqërore të autorëve të krimeve dhe padrejtësive dhe njohje publike të të njëjtave, dhe në bazë të gjithë kësaj, nuk ka indinjata të përgjithshme dhe të singërta sociale ndaj mizorive të kryera. Kam frikë se drejtësi për të kaluarën as që do të ketë dhe as që mund të ketë, pasi që askush nuk mund të kthejë të vdekurit nga varri ose përsëri t'i jetojnë vitet e humbura. Mundemi vetëm të përpiqemi që e njëjta gjë të mos përsëritet, ndërsa këtu hapësira e gjyqësorit është shumë e kufizuar.

Në qoftë se, indi lidhës i shoqërisë mbetet vet-glorifikimi i miteve dhe narrativeve, nëse ndjeshmëria jonë në kryerjen e krimeve dhe në vuajtjen e tjerëve nuk bëhet të paktën e përafërt me

⁶ Psh. Fondi për të Drejtën Humanitare.

⁷ Psh. Qendra për Hulumtim dhe Dokumentacion – Sarajeva me projektin e vëllimshëm *Ljudski gubici u BiH 1991-95*.

përjetimin e vuajtjes tonë (si do që e definuar kush jemi “ne”), atëherë nuk duhet të shpresojmë se historia nuk do të përsëritet, me aktorët e njëjtë ose me tjerë⁸. Në qoftë se, kultivojmë paragjykime se ekzistojnë bashkësi etnike të mira dhe të këqija, se disa popuj i kemi miq, ndërsa tjerët armiq, nuk do të shkojmë larg. Që të dalim nga humnera dhe të krijojmë besimin na duhet shumë dialog, komunikim, bashkëpunim, mbështetje, durim, kohë. Shumë takime, arsimim, filma, libra, artikuj, fjalime, dëshmi, vizione, lot, gëzime, siguri jetësore dhe pa kufi kalime kufijsh deri sa nuk i bëjmë krejtësisht të pakuptimta, si në kokat tona ashtu edhe në rampat kufitare.

Padrejtësitë – gjendja e të drejtave të njeriut

Trashëgimia e regjimit autoritar, ksenofobia shumëvjeçare e induktuar sistematikisht dhe mos durimi ndaj çdo lloj diversiteti (qoftë të jenë në pyetje anëtarët e nacionalitetit tjetër, fesë, racës, orientimit seksual...) janë vetëm disa nga faktorët që ndikojnë që të dominojë perceptimi i identitetit si përjashtues/ekskluziv (“ose-ose identitet”), i cili në vetveti bëhet bazë për përplasje të mëtutjeshme.

Në rrethana të tilla, gjatë thirrjes në demokraci dhe respektimit të të drejtave të njeriut, qytetarët/et nuk kuptojnë lidhjen dhe ndikimin e tyre në jetën e tyre të përditshme. Në rastin më të mirë, çështja e të drejtave të njeriut shihet si çështje e humanizmit abstrakt, si diçka për të cilën ende nuk ka ardhur koha (pasi që, ekzistojnë “probleme më të mëdha dhe më të rëndësishme”); ndërsa në rastin më të keq – si diskurs i importuar, i fshehtë dhe skllavërues i Perëndimit.

Humbjet e njerëzve

Nga luftërat në Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi, Kosovë dhe Maqedoni, jetën kanë humbur rreth 150.000 njerëz, rreth 4 milion kanë qenë të zhvendosur përkohësisht ose përgjithmonë, sot (2012) ende 13.000 persona janë të regjistruar si persona të pagjetur. Numri i njerëzve të cilët kanë marrë pjesë më betejat e armatosura është vlerësuar në rreth 3 milion, pasojat e luftës i kanë përjetuar të gjithë të cilët jetojnë në këtë rajon.

Kthimi i pronës

Shtëpitë e braktisura dhe të konfiskuara kryesisht gjithkund u janë kthyer pronarëve të vërtetë, me të gjitha dredhitë që kanë bërë pushtetet që të pengojnë kthimin e pakicave, prej ndërprerjes së shërbimeve komunale dhe dokumentacioneve e deri te sulmet fizike dhe vrasjet. Megjithatë, përgjithësisht mund të thuhet se një përqindje e madhe e njerëzve kanë realizuar të drejtën për kthimin e pronës, natyrisht që kjo nuk nënkupton edhe kompensimin e dëmeve për pronën e shkatërruar.

⁸ Të atyre që paraqesin se atë e bëjnë në emër të popullit.

Kthimi i refugjatëve dhe personave të zhvendosur

Duhet thënë se, për dallim nga disa vende të botës, vet kthimi fizik i refugjatëve është lejuar në të gjitha vendet e rajonit, mirëpo, shpesh nuk është materialisht i qëndrueshëm (mungojnë infrastruktura, puna, etj.), në një pjesë është e lidhur edhe me rrezikun e ekspozimit ndaj sulmeve fizike dhe kërcënimit e jetës që është shkak që një numër i madh i njerëzve ka hequr dorë nga kthimi. Taktika e pushtetit në vitet e pas luftës që të vështirësojë dhënien e dokumentacioneve dhe zeheroj jetën e njerëzve ka sjellë deri tek fakti që njerëzit në ndërkohë kanë organizuar jetën e vet atje ku kanë shkuar, dhe se nuk kanë dëshiruar që përsëri të migrojnë në pasiguri. Fytyra tjetër e politikës së segregacionit ka qenë inkurajimi i refugjatëve të qëndrojnë⁹ që të ndërrojnë imazhin etnik në atë vend, të thellojnë segregacionin e përgjithshëm dhe të konfirmojnë pamundësinë e bashkëjetesës. Ekzistimi i urrejtjes dhe mosdurimit ndaj fqinjit nënkuptohet, megjithëse edhe aty situata me kalimin e kohës është relaksuar (përveç në Kosovë, ku ky përparim është i vogël). Faktet tregojnë rreth asaj se një numër i konsiderueshëm i territoreve janë “pastruar” etnikisht, një pjesë me dhunë dhe me kanosje me armë (psh. Bosnja lindore, Posavina, Hercegovina, Krajina e kroatëve), e një pjesë thjeshtë nga frika, diskriminimi, dhe pasiguria (Beogradi nga shqiptarët, migrimet brenda Maqedonisë, Kosova).

Paditë e drejta dhe të rrejshme për krimet e luftës

Numri i kryerësve të krimeve të luftës të cilët asnjëherë nuk janë procesuar është shumë i madh dhe ky fakt krijon ndjenjën e frikës, pasigurisë dhe mosbesimit tek viktimat dhe familjet e tyre, që reflektohet në mënyrë shumë negative edhe në procesin e kthimit të refugjatëve dhe të të zhvendosurve. Përgjegjësit e krimeve shpesh kanë pasur sukses të mbajnë funksionet e tyre në sistemin shtetëror dhe një numër i vogël i tyre janë dënuar për krimet e tyre.

Ekziston një numër i madh i rasteve në të cilat njerëzit janë akuzuar padrejtësisht, me kast. Në Kroaci një kohë pas luftës proceset gjyqësore janë kryer në mungesë, kundër individëve të cilët kanë luftuar në anën e serbëve në luftë, dhe janë marrë vendimet gjyqësore ku të dyshuarit as nuk janë vënë në pyetje. Praktika e tillë ka shkaktuar frikë në mesin e refugjatëve, pasi që pas kthimit do të burgoseshin dhe do të duhej të dëshmojnë pafajësinë duke qenë në burg. Kjo praktikë është ndaluar kur filloi para disa viteve bashkëpunimi ndërmjet drejtësisë kroate dhe serbe. Në Serbi rasti i fundit është i vjetër 2 vite, kur është burgosur ish ushtari kroat në dyshim për krim luftë, ndërsa pas disa muajve u vërtetua se ai ka qenë i burgosur dhe i torturuar në burg në Serbi nga ana e organeve ushtarake, dhe i detyruar të nënshkruaj pohim të rrejshëm. Në vend që të burgosen ata që e kanë torturuar dhe e kanë detyruar të bëj pohim të rrejshëm, ai 15 vite pas vuajtjeve personale përsëri ka kaluar disa muaj në burg në Serbi. Personalisht di për rastin e një person nga Bërçko i cili para dy viteve është gjendur në listën e qeverisë së Republika Serpskës si i dyshuar për krimet luftë, ndërsa në kohën kur është kryer krimi ai ka qenë në logor si i burgosur i serbëve, për të cilin ekzistojnë dëshmi të pakundërshtueshme.

Në Kosovë pas luftës në shumicën e rasteve ka ndodhur që individët të dëshmojnë rrejshëm kundër serbëve që janë kthyer duke i gjykuar për krimet. Me të drejtë ata kanë qenë njerëz që kanë qenë të mobilizuar gjatë luftës nga ana e serbëve në polici ose ushtri, por që nuk kanë kryer krimet për të cilat janë ngarkuar. Prezenca e gjykatësve ndërkombëtar në gjykatën e Kosovës ka ndaluar

⁹ Heqja dorë nga kthimi në vendin e jetesës para lutës.

që në rastet e mungesës së dëshmive njerëzit të dënohen.

Lustrimi

Për dallim nga përgjegjësia penale për krime lufte të cilës i janë shmangur qindra kryerës, ndërsa disa jo, përgjegjësia për nxitje publike të luftës, të krimeve dhe të urrejtjes nuk është sanksionuar. Për më tepër, në vend të lustrimit, një numër i madh i individëve të cilët janë dalluar me gjuhën e urrejtjes, qoft si politikanë ose si gazetarë dhe intelektualë, edhe sot e kësaj dite janë në pozita të fuqishme, me shfaqjet e tyre të adoptuara në kohën e sotshme. Kështu, është e mundshme që kryetar shteti të bëhet një vojevode çetnik, dora e djathtë e të gjykuarit për krime lufte, njeriu i cili ka folur publikisht se nuk ndjen keqardhje për viktimat e vrasjeve politike siç janë gazetari Çuruvija dhe premieri Gjingjij. Një numër i madh i gazetarëve, të dalluar në kohën e propagandave të luftës, pa asnjë pasojë, kanë ndërtuar karrierat e tyre duke mos hezitur të paraqiten si autoritete të profesionit gazetaresk dhe etik. Edhe pse ndikimi i këtyre njerëzve në jetën publike sot është pakrahasueshëm më pak destruktiv, ndonjëherë edhe konstruktiv, ekziston nevoja për pranimin e padrejtësisë së bërë. Nuk është e mjaftueshme që pa asnjë fjalë të tejkalohet e gjithë ajo që është thënë dhe që është bërë dhe sot të veprojë ndryshe, pasi që, kjo hap pyetjen se kur dhe në çfarë kushtesh ai ndryshim mund të ndodh përsëri.

Pasojat

Pasojat e të gjitha padrejtësive të numëruara janë frika, urrejtja, kolektivizimi i fajësisë dhe viktimës, vetviktimizimi¹⁰, themelimi i urrejtjes ndaj tjerëve në identitetet nacionale, ndërsa në gjithë këtë edhe kufizimi subjektiv i lirisë së lëvizjes, mendimit, jetesës, dhe në fund, por jo edhe më pak e rëndësishme, varfëri materiale dhe shpirtërore. Sikur me gjeneratën e cila e ka përjetuar luftën në lëkurën e saj të gjitha këto pasoja të zhdukeshin, ndoshta do t'i kishim shtyrë nën qilim dhe do të pritnim të veniten. Për fat të keq nuk është aq e thjeshtë. Këto pasoja kanë dimension të shumë brezave, pasi që, barten nga gjenerata në gjeneratë përmes narrativeve dhe edukimit arsimor, ndërsa paragjykimet personale dhe të huaja gjenerojnë edhe përvoja të reja të cilat i vetvërtetojnë dhe i zhvillojnë më tej. Sistemi arsimor është treguar si bazë e jashtëzakonshme për thithje të narrativeve të tilla dhe multiplikimin e tyre.

Diskurset dominuese

Përmendoret

Përmendoret janë reflektim i diskursit dominant të politikës dhe kulturës së përkujtimit të kohës në të cilën kanë ndodhur. Ato paraqesin materializimin e përkujtimit kolektiv dhe janë pjesë e politikës së identitetit, respektivisht aktiviteteve të imagjinuara të cilat janë të drejtuara në zhvillimin dhe përforcimin e identiteteve kolektive. Marrëdhëniet e shoqërisë ndaj luftërave të kaluara janë të dukshme prej përmendoreve të atyre luftërave, mirëpo, edhe përmes ndryshimeve

¹⁰ Psh. Deklarata: “Ata na kanë therur”, që nuk nënkupton se autori i kësaj deklaratë e ka përjetuar personalisht masakrën.

që i kanë përjetuar gjatë kohës ato përmendore. Prandaj, edhe pse vendosja e përmendoreve ka për qëllim të lë shenjë të pashlyeshme, faktet tregojnë se intervenim në aspektin e ndërrimit të përmendoreve të vjetra ka pasur dhe do të ketë. Ato intervenime fillojnë nga këputja e kreve të mermerta në bustet nëpër parqe, minimi i monumenteve të përmendoreve partizane e deri tek ndryshimet graduale dhe diskrete të teksteve fyese ose çmontimi modest dhe largimi i monumenteve të papërshtatshme që shqetësojnë grupe njerëzish. E gjithë kjo ka ndodhur në këtë troje vitet e kaluara.

Nga luftërat e fundit e këndeje u krijuan një numër i madh i përmendoreve, kryesisht ato të cilat lavdërojnë viktimat e popullit që dominon në territorin ku është vendosur përmendorja. Ndërsa, dominimi nënkupton shumicën në nivel komunal nën kompetencën e së cilës është dhënia e lejeve për vendosjen e përmendoreve, që përsëri nënkupton dominimin në komisionin për monumente.

Sipas rregullës, me përmendoret dërgohet një mesazh rreth asaj se duhet t'i kujtojmë viktimat që të mbijetojmë, që do të thotë, të mos e harrojmë kush është armiku jonë dhe të mbahemi bashkë si kolektiv, të jemi të bashkuar dhe unik, pasi që, “vetëm ashtu mund të mbijetojmë”. Në varrezat në Kosovën Lindore kam parë dhjetëra varre të rregulluara, të rrethuara bukur dhe të shënuara me flamuj të cilat kishin përmendore të përpunuara identike. Në çdonjërin prej tyre ishte e gdhendur fytyra e personit të varrosur. Aty kishte meshkuj të rinj dhe të moshuar, gra dhe fëmijë. Çdonjëri ishte i veshur me uniformë ushtarake, me stemën e UÇK-së në njërin kënd, ashtu ishin shfaqur edhe fëmijët. Shembull më ekstrem të kolektivizimit dhe militarizimit të viktimave civile nuk kam parë, vet matricë po, pasi që ajo vlen për të gjithë.

Specifika e fituesit në luftë

Diskursi dominant në Kroaci dhe në Kosovë është se për luftën e cila u është imponuar ka qenë e domosdoshme vetëmbrojtja. Ka qenë e drejtë, e pashmangshme dhe e lavdishme, pasi që, janë arritur idealet për të cilat është luftuar. Fitorja ndaj forcave serbe ishte e qartë, ndërsa kontrolli mbi territorin ka qenë i plotë¹¹. Lufta festohet njëjtë si më parë në RSF të Jugosllavisë, ekzistojnë heronj, sipas tyre emërohen rrugët, shkollat sheshet, në përkujtimet e vuajtjeve mbahen parada me uniforma dhe armë, shfaqen filma dokumentarë për njësitet ushtarake dhe aksionet e suksesshme, ushtarët fitues gëzojnë privilegje. Fotografitë e heronjve zbkurojnë kafenetë, sheshet, pllakatet, qeset e sheqerit nëpër kafenetë, shiten kapela dhe shenja nëpër bashkësitë lokale dhe sheshet e qyteteve. Çdo krijim i problemit për mitologjinë e luftës dhe matricën mitologjike rreth *fitores së të Mirës ndaj së Keqes në publik tërheq shumë reaksione negative. Ata janë heronj pa asnjë të metë, ndërsa armiku është i padukshëm, ata janë fuqi të errëta, të cilat pa asnjë arsye kanë sulmuar thelbin e identitetit tonë dhe idealin tonë për liri me qëllim që të na e rrëmbejnë, të na skllavërojnë, të na vrasin, të na dëbojnë, të na shkatërrojnë dhe të na helmojnë*. Pjesë e rëndësishme e asaj matrice është edhe të ushqyerit e tensioneve se *armiku nuk fle, por vetëm është fshehur, duhet të ekzistojë vigjilenca, edhe pse jemi më të fortë, nuk duhet të jemi të relaksuar*. Diskursi kryesor edhe sot e kësaj dite është i njëjtë. Për pikëpamje të ndryshme rreth historinë as që bëhet fjalë, multiperspektiva, çfarë është kjo? Interpretimi është gjithçka, faktet janë relative, pasi që interpretimi jep sqarim se si njerëzit nuk duhet të lodhen me të menduarit. Kuptimi instant përgatitet çdo ditë dhe dozat e paketuara konsumohen nëpërmjet emisioneve televizive, shtypit, rretheve familjare. Çdo gjë është gati për luftën e ardhshme, “dhashtë Zoti”. Sikur mos të ishin disa organizata paqësore si Dokumenta dhe Qendra për

¹¹ Përveç veriut të Kosovës.

Studime Paqësore, çdo gjë do të ishte perfekte.

Specifika e humbësve

Në kontekstin e shoqërisë në të cilën pas luftës nuk mbretëron euforia për shkak të fitores, por gëzimi për shkak të përfundimit të vuajtjes, e përzier me dhimbjen për shkak të humbjeve të mëdha, si për shembull, rasti në Bosnje dhe Hercegovinë, është pakrahasueshëm më e lehtë të artikulohet diskurs që është në konflikt me atë dominant, ngaqë, vet vendosja e shoqërisë është e tillë që njerëzit janë të përzier pavarësisht nga përpjekjet e bëra që të bëhet e kundërta. Në vend të një diskursi konfliktuoz dominant thjeshtë ekzistojnë më së paku tre¹² diskurse konfliktuozë paralele njëri pranë tjetrit, edhe atë në atë mënyrë që konfrontimi i tyre me kalimin e kohës nuk është përjetuar si problem. Thjeshtë, vlen si normale që boshnjakët, kroatët dhe serbët, respektivisht shqiptarët dhe maqedonasit, të cilët kanë luftuar njëri kundër tjetrit të kenë interpretime të kundërta të shkaqeve, rrjedhëve dhe pasojave të luftës. Shpifjet dhe minimizimi i viktimave të të tjerëve nënkuptohet dhe ky është burim i përhershëm i mllëfit, dhe ajo që është mirë në këtë rast është se mllëfi është i dukshëm. Edhe atëherë kur ato narrativa konfliktuozë janë shumë të ngjashme në konstruktin e vet, është mirë që nuk janë të vetmuara dhe të vetme siç është rasti tjetërkund. Pa dyshim, konfrontimi për çështjen e përgjegjësisë për të kaluarën mbart me vete edhe lëndimin, ritraumatizimin dhe përhapjen e frikës dhe pasigurisë, atëherë kur refuzohet shprehja e respektit ndaj viktimave të të tjerëve ose kur ngjarjet dhe dimensionet e tyre mohohen (psh. Mohimi i shpeshtë se është kryer gjenocid në Srebrenicë). Të lënduarit dhe rigjenerimi i traumave të luftës paraqet luftën e përhershme rreth shënimit të vendeve të vuajtjeve (të atyre të cilët më nuk janë dominant në atë territor), me komemorimin e përvjetorëve, vendosjen e pllakave përkujtimore dhe ngjashëm. Ndërsa, në anën tjetër, ata të cilët dominojnë përpiqen që vuajtjet e viktimave të tyre t'i shënojnë në nivel sa më të madh shtetëror. Grupet më ekstreme madje, përpiqen që vdekjen e të tjerëve ta tregojnë si një gjë që ata e kanë merituar.

Në të vërtetë, të tre komunitetet të cilat kanë territoret e tyre në të cilin dominojnë, në fakt, sillen sikur ata janë fitues dhe pronarët e vetëm të vendit ku jetojnë. Të bashkëndjerit me viktimat e të tjerëve në një ambient të tillë përjetohet si subverzive ndaj kapacitetit që komuniteti ka për të luftuar për mbijetesë. Në të vërtetë, shumica e heshtur mbështet virtytet njerëzore për të bashkëndjerë, pa marrë parasysh se për cilat viktime bëhet fjalë, mirëpo, në hapësirën publike ata zëra janë shumë të heshtur.

Megjithatë, pavarësisht nga krejt ajo që u tha, narrativet e të tjerëve janë të njohura dhe është e qartë se me dhunë nuk mund shuhet, ndërsa ndërvarësia e komuniteteve është e madhe, edhe pse tendencat janë kah e kundërta.

Specifika e “mbikëqyrësit” aktiv

Vetëm Serbisë mund t'i referohet roli i gjoja se mbikëqyrësit, kur në të vërtetë ka qenë pjesëmarrëse dhe iniciuese e luftërave në Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kosovë. Në Serbi qëndrimi ndaj luftërave në B dhe H dhe Kroaci kryesisht është qëndrim i refuzimit të përgjegjësisë dhe mosinteresimit, ndërsa qëndrimi ndaj luftës në Kosovë historikisht ka qenë standard ai i martirizimit. Të rralla janë përmendoret që kanë të bëjnë me luftërat në B dhe H dhe Kroaci, ndërsa organet shtetërore sillen sikur Serbia nuk ka qenë pjesëmarrëse fare. Përshtypja është se në funksion është një proces aktiv i harresës përmes relativizimit dhe shlyerjes së çështjeve të përgjegjësisë së shtetit për luftërat në këto vise. Jo rrallë paraqitet pamja e luftërave të

¹² Për shkak të thjeshtësisë, përjashtoj analizën e konfliktit në Bosnjën perëndimore në drejtim Armata B dhe H (Bihaq) – Krajina e Cazinit, ku aktorë kryesorë në të dyja anët kanë qenë boshnjakët.

fundit në Kroaci dhe B dhe H si “vazhdim” i Luftës së Dytë Botërore, dhe në mënyrë kreative manipulohet me shifrat, ato shtohen dhe zvogëlohen, duke kërkuar “rezultat” i cili do të relativizojë përgjegjësinë e Serbisë dhe serbëve në luftërat e fundit. Narrativet armiqësore ndaj boshnjakëve dhe kroatëve nuk shfaqen shpesh, por ndonjëherë, vetëm në ceremonitë e përkujtimeve sporadike dhe nuk materializohen në përmendore, andaj janë më pak të pranishme.

Institucionet shtetërore në Serbi kanë marrë disa hapa për të cilat mund të thuhet se janë duke ecur përpara, por mbetet përshtypja se bëhet fjalë për veprime deklarative¹³ të imponuara me zor. Mediat dhe sistemi arsimor nuk merren në mënyrë aq intensive me të kaluarën e afërme as edhe në vendet fqinje. Kur e bëjnë këtë gjë, diskursi dominant është diskursi i viktimës, kërcënimet shekullore, dëshira për drejtësi dhe mbrojtja e *qenies kombëtare*.

Ideologjia e nacionalizmit serb, edhe pse e dobësuar edhe me tej jeton në shumicën e partive politike dhe në kohët e krizave rritet në mënyrë të rrezikshme.

Si më tej?

Në të njëjtën mënyrë siç krijohet kultura e përkujtimit që të jetë e tillë siç është, e kjo bëhet me anë të veprimeve politike, aksioneve kulturore, mediave, aksioneve qytetare dhe fushatave, mund të ndikohet që ajo të ndryshojë në mënyrë që, përmes ballafaqimit konstruktiv me të kaluarën, ajo të shpie kah vendosja e politikave dhe kulturës së përkujtimit e cila është më pak dominante, e më shumë reflektuese; më pak shtet formuese, e më shumë e orientuar kah qytetaria.

Zhvillimi i vetëdijes përmes arsimimit për rëndësinë e fokusimit në proces dhe kurthet e proceseve të cilat mund t'i presim (kur nga qëllimi më i mirë bëjmë më shumë dëm sesa përfitim), analiza e ndershme dhe të mësuarit nga përvojat e deritanishme ofrojnë një pikënisje plotësisht të mirë dhe japin arsye për optimizëm.

Ajo çka procesi i ballafaqimit konstruktiv duhet të jetë patjetër dhe prej të cilës nuk mund të ikë, është kalimi i kufijve, mësimi nga të tjerët, ndryshimi i vetes dhe të tjerëve përmes zhvillimit të empatisë, bashkëpunimit, respektimit. Të kuptuarit e kuptimit dhe rëndësisë së multiperspektivitetit në interpretimet e historisë është kyçe. Të fokusuarit vetëm në shtetin në të cilin jetojmë, në këto rrethana është i pakuptimtë dhe dështues.

Edhe në fillim edhe në fund të çdo hapi dhe aksioni, dhe të çdo fushate dhe programi, duhet të ekzistojë analizë e drejtë dhe vlerësim i asaj që është arritur, mësim nga gabimet e tua në vend të fshehjes së gabimeve. Nëse nuk mundemi të ballafaqohemi me dështimet tona, vështirë që do të mund të nxisim të tjerët të bëjnë të njëjtën.

¹³ Rezoluta e Parlamentit të Serbisë, dënimi i krimeve (në vend që thuhet “gjenocid”) në Srebrenicë, dhe vizita e Kryetarit të Serbisë në Memorialin Potoçari.

Rreth qasjes së punës së QAP në ballafaqimin me të kaluarën

Ivana Franoviq

Para më shumë se 10 vjetësh, në një mbledhje të vogël njerëzish të cilët i janë përkushtuar punës paqësore nëpër vende të ndryshme të botës, duke prezantuar punën që në e bëjmë, kolegu im Adnani e filloi fjalimin me fjalët: “Ne merremi me gjëra të rënda...”, kjo shkaktoi simpati nga njerëzit që ishin prezent. Asokohe as që kemi ëndërruar se në çfarë thellësie do të zhytemi dhe se sa i saktë është ky përshkrim i thjeshtë.

Qendra për Aksion të Padhunshëm punon në ndërtimin e paqes, pik së pari në rajonin e ish Jugosllavisë. Ju përkushtohemi vlerave të padhunshmërisë, solidaritetit, drejtësisë sociale, të drejtave dhe lirive të njeriut. Ndoshta dikujt kjo i tingëllon si profesion i bukur dhe i lehtë në këtë Ballkan të palumtur. Mbase edhe do të ishte, sikur të vendosnim të merremi vetëm me komunikimin e padhunshëm, afirmimin e potencialeve njerëzore, me motivimin e njerëzve që të përhapin vlerat e padhunshmërisë... Mirëpo, ne merremi edhe me tema të rënda. Jo sepse i duam ose sepse kemi shtysë vuajtjen dhe pikëllimin, por për shkak se kemi parë se pa i dalë ballë për ballë dhe pa u ballafaquar me atë që është e dhimbshme në shoqëritë tona nuk mund të ketë ndryshime të vërteta.

Do të përpiqem që në këtë tekst të qartësoj qasjen e punës në ndërtimin e paqes, të afrojmë pikënisjen tonë, atë që përpiqemi ta arrijmë, por edhe të paraqes se si e kuptojmë ndërtimin e paqes, përse e ndërldhim me ballafaqimin me të kaluarën, dhe pse mendojmë se ballafaqimi me të kaluarën është temë e pashmangshme e arsimit për paqe.

Çka është për ne ndërtimi i paqes

Me ndërtimin e paqes nënkuptojmë jo vetëm ato përpjekje të cilat ndërpresin përsëritjen e luftës dhe dhunën në shkallë të gjerë, por edhe të gjitha përpjekjet e drejtuara në zvogëlimin e sasisë së dhunës në shoqëri, nga ajo më qarta, direktja, deri tek dhuna *strukture dhe kulturore*, me të cilat jemi të rrethuar. Ndërtimin e paqes e përbëjnë të gjitha përpjekjet të cilat kontribuojnë drejt asaj që të jetojmë në paqe me veten tonë, me rrethin tonë, ndërsa veçanërisht me fqinjët tanë dhe ata të cilët i takojnë grupeve të pakicës dhe grupeve të marginalizuara. Them – veçanërisht, për shkak se ata janë ata të cilët më së shumti vuajnë për shkak të mungesës së paqes. Ndërtimi i

paqes pretendon dekonstruktimin e matricës së marrëdhënieve ndaj *Tjetrit* dhe *Të ndryshmit* (si do që të jetë i/e përcaktuar ai/ajo: sipas gjinisë, etnisë, religjionit...). Kjo nuk do të thotë të qenurit pasiv, pranimit të situatës së padrejtësisë dhe mungesës së reagimit. Ndërtimi i paqes nënkupton aksionin e padhunshëm *aksionin/reaksionin* dhe veprimin aktiv kundër padrejtësisë në shoqëri. Kjo dotë thotë të hapurit e konfliktit dhe shfaqjen e problemit, dhe në qoftë se kemi sensibilitet të mjaftueshëm, urtësi, por edhe kreativitet, të japim propozime për zgjidhje; do të thotë punë në ndërtimin e besimit, në zhvillimin e solidaritetit ndërmjet bashkëqytetarëve, do të thotë ndërtimin e shoqërisë në të cilën diskriminimi mbi çfarëdo baze është i papranueshëm, ndërtimin e shoqërisë në të cilën njerëzit kanë shanset e barabarta, në të cilën nuk ka imazhe të armiqve, dhe që nuk u nxit frikë fqinjëve të vet. Kjo do të ishte shoqëri në të cilën do të kishim jetuar të lirë dhe pa frikë.

Me punë në ndërtimin e paqes, domosdoshmërisht hapen konfrontime me shtresat/grupet në shoqëri të cilat nuk duan të arrihet deri tek ndryshimet shoqërore. E rëndësishme është që të mos pranojmë *status quo*-në dhe të punojmë në konfliktet e tilla, mirëpo, me rëndësi të njëjtë është që qasja të jetë në natyrën e padhunshmërisë, që të mos vijmë deri te *shkatërrimi* në vend të *ndërtimit të paqes*. Kjo nënkupton punë në të kuptuarit e palës së kundërt: cilat janë shkaqet e saj, çfarë nevojash ka, çfarë frikash; mirëpo, edhe në rishikimin e vetes: ndoshta unë/ne dikund gabojmë, ndoshta i thellojmë frikat e dikujt, ndoshta nuk tregojmë besim, ndoshta kemi neglizhuar nevojat themelore të dikujt dhe me këtë arrijmë që pala tjetër të ndjehet e kërcënuar... Kjo është punë e cila kërkon shumë imagjinatë dhe ide rreth asaj se çka dhe si mund të bëhet në rrethanat e dhëna, por edhe vetëkritikë të mjaftueshme. Kërkon edhe optimizëm, respektivisht besim se mund të bëhet më mirë. Ndërsa, kërkon edhe guxim personal dhe gatishmëri për punë në vetëdijesimin e paragjytimeve personale, dilemave dhe frikave.

Pse ballafaqimin me të kaluarën e ndërlidhim me ndërtimin e paqes

Në kontekstin tonë post-Jugosllav në të vërtetë është e pamundshme të ndërtohet paqe pa ballafaqime me të kaluarën. Pasi që, nuk fillojmë nga zeroja, por kemi barra të trashëgimisë së luftës: armiqësi dhe imazhe të armiqve, narrative dominante konfrontuese rreth luftërave, diskriminime jo të rralla në baza etnike, madhërim dhe lavdërim të kriminelëve të luftës, madhërimin e vet luftës si mbrojtëse, mosnjohjen e viktimave të të tjerëve – pasi që, *ne* jemi viktimat më të mëdha, gjuhë të qëndrueshme të urrejtjes e cila nuk njihet si e tillë dhe është e pranueshme për shoqërinë, dhe natyrisht, frikë nga tjetri. Të gjitha këto janë kushte ideale për fillimin e një lufte tjetër (në atë moment kur do të ketë interes për të).

Pas përvojës së luftës e cila ka goditur me miliona njerëz, për shkak të së cilës një numër i madh i njerëzve është dashur të lëshojnë shtëpitë e tyre, në të cilën kanë humbur jetën qindra mijë njerëz, edhe më shumë se aq kanë mbetur pa të dashurit e tyre, nuk mund të kthejmë faqen dhe të themi: Hajde tani të ndërtojmë paqe, zotohemi për pajtim. Tmerret e luftës që kanë përjetuar njerëzit dhe e gjithë ajo që kanë humbur nuk mund të harrohet dhe nuk mund tejkalohet aq shpejt. Nuk është e mjaftueshme as të burgosësh disa qindra kriminelë të luftës dhe të procesosh krimet e luftës. E nevojshme është që të shërojmë plagët, të cilat as sot, disa vite pas përfundimit të luftës, nuk janë shëruar. As që mund të shërohen, kur nuk njihen vuajtjet e të tjerëve, kur në shoqëritë tona glorifikohen ata të cilët janë përgjegjës për vuajtjet e njerëzve tjerë dhe kur kultivohen narrativet armiqësore dhe të vërtetat e shtrembëruara rreth luftës. Me këtë, nga njëra anë, viktimat ende i viktimizojnë; nga ana tjetër, krijohet shoqëri në të cilën dhuna, jo vetëm që është lejuar, por

është edhe e dëshiruar.

Situata komplikohet edhe më shumë kur në mënyrë të përhapur bëhet identifikimi me viktimat “tona” (atyre etnike), kështu që horrori që kanë përjetuar anëtarët individual të atij grupi shumë lehtë pasqyrohet ndaj të gjithë grupit: të gjithë ne e kemi përjetuar atë, të gjithë ne jemi viktimat e atyre (ndonjëherë duke marrë parasysh ngjarjet nga shekulli i kaluar ose nga ndonjë histori më e largët)¹.

Sido që të jetë, këto shoqëri nuk do të shkojnë larg në ndërtimin e paqes dhe në parandalimin e ndonjë lufte të ardhshme derisa me ndershmëri nuk merremi me të kaluarën tonë të luftës dhe padrejtësitë të cilat janë bërë në emrin tonë. Besoj se paqe të qëndrueshme në këto troje nuk do të ketë deri sa njerëzit nuk krijojnë ndjenjë të sigurisë dhe besim se drejtësia është e arritshme.

Në qoftë se, duam të ndërtojmë paqe, medoemos të ndryshojmë atë që lufta e bëri të mundshme. Ndërsa, duhet edhe të pyesim veten se cila është përgjegjësia jonë individuale për luftërat, çfarë kemi bërë e çfarë nuk kemi bërë, çfarë kemi mundur të bëjmë ndryshe, e veçanërisht çfarë mund të bëjmë sot që të mund të kontribuojmë në ndërtimin e paqes së qëndrueshme, dhe pastaj me ndershmëri të shikojmë cila është përgjegjësia e shoqërisë ku jetojmë dhe çfarë duhet ndryshuar, çka duhet punuar. Dhe këtu është e rëndësishme të bëjmë dallimin mes përgjegjësisë dhe fajit. Unë nuk jam *fajtor* për atë që ka bërë shteti (ose struktura udhëheqëse) në emrin tim, pasi që faji mund të jetë vetëm individual. Mirëpo, jam *përgjegjëse*, bile edhe nëse kam qenë fuqishëm kundër asaj që e ka bërë shteti.

Duhet mësuar mësimet nga e kaluara.

Arsimimi për paqe dhe ballafaqimi me të kaluarën

Për fat të keq, në shoqëritë tona, por edhe në përgjithësi në botë, arsimimi për paqe vazhdon të jetë dukuri e rrallë. Ndërsa kjo botë çirret për arsimim për paqe i cili mund të bëhet nëse jo forcë lëvizëse për ndryshimet shoqërore, atëherë njëra nga levat për arritjen e tyre. Programet e rralla të arsimimit për paqe, ata formale dhe joformale, akoma, rrallë herë përfshijnë edhe fushën e ballafaqimit me të kaluarën. Ballafaqimi me të kaluarën kryesisht lidhet me të ashtuquajturën “e drejta tranzicionale” dhe kryesisht studiohet në kornizat e të drejtës ndërkombëtare dhe shkencave politike. Ashtu siç bëhen të pandara fushat e ndërtimit të paqes dhe ballafaqimit me të kaluarën, ashtu bëhet e domosdoshme që ballafaqimi me të kaluarën të klasifikohet dhe të studiohet në kornizat e arsimimit për paqe i cili *përcaktuar në bazë të vlerave* dhe pretendon që sa

¹ Ky identifikim bëhet vetëm në rast nevojë: kur për ndonjë shkak duhet të pastrosh përgjegjësinë nga vetja dhe të paraqitesh si viktimë, kur vetes dhe të tjerëve duhet t'u tregosh se merr pjesë në ndonjë grup (e cila gjithmonë është viktimë, pasi që, grupi “jonë” në asnjë mënyrë nuk mund të jetë grup kriminel) ose të krijosh ndjenjën e përkatësisë duke nënvizuar ekzistimin e armikut të përbashkët, kur jemi të dëshpëruar për shkak të situatës në shoqëri dhe është e nevojshme që dikë të fajësosh, kur është i nevojshëm arsyetimi për diçka që nuk kemi bërë, ndërsa kemi mundur ta bëjmë, por para së gjithash edhe një numër i madh i arsyeve politike, pasi që kjo shfaqje u shkon për dore elitave politike në rajon. Them se identifikimi nuk është i përhershëm, por paraqitet sipas nevojës, parasëgjithash nga arsya se nuk ekziston empati e përhapur me viktimat, ato nuk janë në fokusin e këtyre shoqërive, i kujtojmë sipas nevojës ose i përkujtojmë në përvjetoret, mirëpo, nuk kemi gjetur mënyrën se si tua lehtësojmë ta tejkalojnë humbjen dhe të vazhdojnë jetën më tej, si tua mundësojmë jetën sadopak të mirë, si të arrihet drejtësia për to, dhe për shoqërinë në përgjithësi... Sa herë që për disa arsye nuk janë të nevojshme, në fakt ata viktima paraqesin barrë për shoqërinë, pasi që kërcënojnë konformizmin e përhapur.

më thellë të merret me sfidat aktuale dhe të promovojë ndërtimin e paqes.

Që nga themelimi i QAP në vitin 1997, kemi zhvilluar dhe kemi kryer një sërë aktivitete: tribuna publike, seminare, promovime, prodhim të filmave dokumentar, publikimin e botimeve, takime për këmbim, etj. Megjithatë, aktiviteti jonë kryesor, i cili të gjitha këto vite ecën dhe nga i cili nxjerrim ide, bashkëpunëtorë/re dhe fuqi për gjithçka tjetër, janë programi i arsimit për paqe, gjegjësisht siç i emërojmë: trajnimet. Duke vlerësuar nevojat në periudhat e ndryshme kohore, duke reflektuar përvojat e mbledhura, kemi zhvilluar programe të ndryshme të arsimit për paqe, ndërsa ato pothuajse patjetër tematizojnë ballafaqimin me të kaluarën si proces të domosdoshëm për ndërtimin e paqes. Këto programe janë dedikuar grupeve të ndryshme, ndërsa më shpesh i kemi organizuar për:

a) Grupe shumë heterogjene në të cilat marrin pjesë njerëz nga më shumë shtete të ish Jugosllavisë, me profesione dhe moshë të ndryshme dhe

b) Veteranë të të aq. “treshes së Dejtonit” (nga Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia dhe Serbia)

Ekzistojnë dy shkaqe kryesore përse në ballafaqimin me të kaluarën punojmë parasëgjithash përmes arsimit për paqe:

1. Në kontekstin tonë e pamundur është të punosh në ndërtimin e përhershëm të paqes pa ballafaqim me të kaluarën.

2. Shoqërive tona u mungon edukimi paqësor, ajo që do të punojë në mënyrë aktive në ndërtimin e paqes dhe që do të ndërtojë qasje konstruktive për ballafaqimin me të kaluarën.

Të tematizosh ballafaqimin me të kaluarën në korniza të arsimit për paqe (që i përgjigjet konceptit të trajnimeve të QAP²) është shumë frytdhënëse. Thjeshtë: vlen munda, pasi që tema mund të shtjellohet thellë dhe me përkushtim, ndërsa arsimimi për paqe ofron kushte për ndërtimin e besimit mes pjesëmarrësve, dhe pastaj me punë të kujdesshme dhe me kushte për degradimin efikas të imazheve të armiqve, për të kuptuar narrativet e të tjerëve, për rishikimin e narrativeve dominante dhe rolin e “*palës tonë*”, për rishikimin e rolit të vet, për motivimin e njerëzve që të aktivizohen në fushën e ndërtimit të paqes dhe ballafaqimit me të kaluarën dhe për t’iu afruar modelit të qytetarëve/eve aktiv të cilët mbajnë përgjegjësinë për veten dhe shoqërinë ku jetojnë.

Me këtë qasje realizohet një parakusht i rëndësishëm për kuptim më të mirë të mekanizmave në nivelin e shoqërisë: vjen deri tek kuptimi më i mirë i rolit individual dhe raporti ndaj të kaluarës, pasi që duke mësuar për ballafaqimin me të kaluarën, ne në fakt me atë të kaluar edhe ballafaqohemi. Këto procese mund të bëhen shumë emotive dhe të rënda, veçanërisht kur diskutimi kalon nga niveli politik në atë personal dhe kur përpiqemi të dëgjojmë dhe të kuptojmë kur të tjerët flasin, por edhe kur ndajmë sinqerisht me të tjerët përvojën tonë. Kështu domosdo vjen deri tek mirëkuptimi i tjetrit. Por, edhe deri tek empatia.

Disa karakteristika të qasjes sonë

Angazhimi që puna jonë të jetë **përtejkuftare dhe rajonale** paraqet një aspekt të konsiderueshëm të qasjes së punës në ndërtimin e paqes. E konsiderojmë të pashmangshëm dhe

² Më shumë për konceptin e trajnimeve të QAP shikoni në kapitullin “Rreth trajnimit të QAP”. Gjithashtu, shikoni Nenad Vukosavljeviq “*Padhunshmëria?*” *Doracak për trajnime nga përpunimi i padhunshëm i konflikteve për punë me të rriturit* (Sarajevë: QAP, 2000)

besojmë se paqja e qëndrueshme duhet të ndërtohet *përtej kufijve*, për çfarëdo kufij dhe barriera të bëhet fjalë, e veçanërisht na interesojnë ato etnike, nacionale dhe politike. Paqja nuk mund të ndërtohet në brendinë e vetëm një grupi, por duhet të punohet edhe në grupin kundërshtues/në grupet paralele, e veçanërisht të rëndësishme janë pikat e takimit, përkatësisht shkëmbimi në mes njerëzve të anëve të ndryshme. Ndërsa, puna e ndërtimit të paqes në grupet “e përziera” është i rrallë, shpesh na mungojnë shkëmbimet konstruktive, por ajo punë mund të krijojë efekte katarsis. Dhe për këtë shkak punojmë me njerëz të vendeve të ish Jugosllavisë.

Për ne procesi i ballafaqimit me të kaluarën është në *funkcion të ndërtimit të paqes*, përkatësisht përpiqemi të kemi qasje konstruktive në ballafaqimin me të kaluarën, duke menduar vazhdimisht rreth pasojave dhe efekteve të padëshirueshme dhe rreth preventivës së tyre.

Në fokus nuk vendosim kriminelët e luftës, por as edhe krimet dhe viktimat e luftës. Në fokus kemi shoqëritë tona edhe atë se si vendosen shoqëritë tona ndaj çështjeve të së kaluarës së luftës. Ndoshta më drejtë do të ishte të themi se punojmë për *pajtimin*, pa marrë parasysh sesa jemi përmbajtur në fillim që ta përdorim atë term³.

Njëra nga detyrat tona të para/qëllimet kryesore është *ndërtimi i besimit*: mes nesh dhe njerëzve me të cilët punojmë, por edhe njerëzve të cilët janë të konteksteve të ndryshme, ndërsa pastaj edhe transferimi i atij besimi nga niveli individual në atë shoqëror (që në fakt është zvogëlimi i mosbesimit ekzistues). Besimi është i rëndësishëm, pasi që na jep hapësirë që të merremi me temat e rënda në mënyrë konstruktive dhe jo kur të jetë diçka e dhimbshme të futemi në kurth dhe të akuzojmë njëri-tjetrin duke transferuar përgjegjësinë e kriminelëve individual në tërë grupin, e pastaj përgjegjësinë e tërë grupit në anëtarët individual që janë të pranishëm aty para nesh.

Ndihmë e madhe për ndërtimin e besimit, por edhe për qasjen tonë në përgjithësi, është *përbërja e ekipit të QAP* i cili në vetvete është i larmishëm: jemi nga vende të ndryshme, nga shtete të ndryshme. Disa nga ne i kanë, ndërsa disa nuk i kanë të shprehura identitetet nacionale dhe fetare, por, pa marrë parasysh atë jemi të perceptuar se u takojmë grupeve të ndryshme etnike. Kemi përvoja dhe afinitete të ndryshme jetësore, dhe, thjeshtë jemi njerëz të ndryshëm. Ky organizim është i rëndësishëm për vet ne në sensibilizimin e mëtejshëm për çështjet e pajtimit dhe të kuptuarit më të mirë të frikave dhe nevojave ekzistuese në anët e ndryshme të gjithë rajonit. Ajo që na bën të dllueshëm është besimi i lartë reciprok dhe afërsia e madhe, pasi që marrëdhëniet tona tejkalojnë marrëdhëniet e kolegëve dhe kolegeve të punës. Këtë gjë e dallojnë dhe e ndjejnë njerëzit me të cilët punojmë, dhe kjo gjë na lehtëson “hapjen e derës” dhe na jep hapësirë që të merremi me temat e rënda dhe zakonisht të papëlqyeshme. Për qasjen tonë shumë e rëndësishme është ajo se kemi motivim të lartë individual për punë në ndërtimin e paqes në shoqëritë tona dhe për të kontribuar në ndryshimet shoqërore, dhe një angazhim i tillë nuk mund të jetë “vetëm punë”. Na intereson se si funksionojnë shoqëritë tona, pasi që jemi pjesë e saj, por kemi edhe përgjegjësi qytetare të ndikojmë në atë që shoqëritë tona të bëhen më të drejta, të sinqerta, të sigurta dhe të hapura për të gjithë ne.

Në mesin e qëllimeve të rëndësishme hyn edhe *dekonstruktimi i imazheve të armiqve*, kështu që atij *armiku* do t'i japim një pamje njerëzore dhe do t'i japim peshë zhvillimit të empatisë për jetën e tij. Interesante për mua është të vë re se në dekonstruktimin e imazheve të armiqve është kryesisht më lehtë të punohet me veteranët e luftës, sesa me popullatën më të re e cila deklarohet si anti-nacionaliste ose si opsioni qytetar liberal. Duke punuar me veteranët e luftës,

³ Njëra nga shkaqet kryesore që i jemi shmangur termit është fakti se një numër i madh i njerëzve këtë term e lidhin ose e identifikojnë me faljen, ose e nënkuptojnë si diçka që është farsë ose sipërfaqësore.

që nga vet fillimi bëhet evidente se imazhet rreth armiqve ekzistojnë dhe se ekzistimi i tyre është problematik. Duke punuar me grupin tjetër, shpesh vjen deri tek mohimi i ekzistimit të stereotipeve dhe paragjytimeve dhe marginalizimit të problemeve.

Qëllimi tjetër i rëndësishëm për ne është ndikimi në *ndryshimin e narrativeve dominante* rreth luftës dhe së kaluarës (të cilat sipas rregullave janë në kundërshtim me njëra-tjetrën), nëpërmjet krijimit të kushteve që të arrihet deri tek rishikimi, zhvendosja, por edhe deri tek njohja dhe pranimi i dallimeve në narrativet e të *Tjerëve*⁴, që hap hapësirë për të kuptuarit e tyre më të mirë.

Kundrejt qasjes së përhapur se me ballafaqimin me të kaluarën duhet të merresh vetëm në “oborrit tënd”, ne ia lejojmë vetes që të kritikojmë të gjitha shoqëritë post-jugosllave dhe nuk është e pazakonshme që ato kritika të përjetohen si të papërshtatshme. Megjithatë, ne si individë kryesisht duhet të fillojmë me kritikë të “oborrit tonë” (përkaj faktit se më së shumti të drejtë kemi të kritikojmë atë shoqëri ku dalim në zgjedhje, qasja e kundërt do të sillte deri tek degradimi i përshpejtuar i ndërtimit të besimit), mirëpo, nuk ndalemi aty. Pasi që, na intereson gjithçka çka ndodh në këto shoqëri. Bile edhe sikur mos të na lidh asgjë me gjithë këtë rajon, duhet të na interesojnë ngjarjet në fqinjësi, pasi që ato edhe atë shumë ndikojnë në ndodhitë shoqërore-politike “në shtëpi”. Mendojmë se në këto kontekstet tona, shumë e rëndësishme është të kemi standarde të njëjta për të gjithë, gjegjësisht të krijojmë pamje të balancuar në atë që ka të bëjë me padrejtësinë, diskriminimin, shkeljen e të drejtave të njeriut, madje edhe krimin, dhe në atë pamje të mos ndikojë përkatësia në ndonjë grup etnik, as përkatësia jonë, as e autorit të krimit, as e viktimës.

Sinqerisht, ndonjëherë ndjehemi sikur ecim mbi vezë, sepse nuk duam të bëjmë dëm më të madh se ai që ekziston. Por, nuk trembemi të provojmë dhe të gabojmë, dhe të mësojmë nga gabimet tona. Ndonjëherë zhytemi në dëshpërim, të mposhtur nga të kërkuarit e kuptimit. Secila përmendore, secili tregim, secili imazh dhe secila këngë, çdo e mbyllur e syve, çdo lot dhe çdo përqaftim, janë hapa në tentimin që t'i jep kuptim përvojës së trishtueshme të luftës dhe të humbjes. Që humbja të mos jetë e kotë. Ndërsa kuptimin ndonjëherë është aq rëndë të gjesh, por në qoftë se, si shoqëri e gjejmë në kultivimin e urrejtjes, paragjytimeve dhe vetviktimizimit kolektiv, e sigurtë është se jemi në rrugën më të mirë të që të bëhemi gjithë ajo që urrejmë dhe që dënojmë gjeneratat e ardhshme me përsëritjen e fateve tona. Dhe e vetmja gjë që nuk dihet është ajo se a do të ndryshojnë rolet radhën tjetër, siç ka ndodhur plot herë deri më sot. Besojmë se barra e së kaluarës na obligon që kuptimin ta gjejmë bashkë, duke krijuar shoqëri të lira nga padrejtësitë, nga frika dhe urrejtja. Dhe nuk jemi të drejtët që me shpata ndriçojnë rrugën të cilën njerëzit tjerë duhet të na ndjekin, por një grup i vogël që kërkon aleatë mes të afërmeve dhe atyre me mendime të kundërta.

Në filmin *Vizitat e veteranëve*⁵, Nenadi, një invalid lufte nga Doboji, flet rreth aksioneve për vizita të përbashkëta në vendet e luftimeve dhe të bërit homazh për të rënë në grupin e ish armiqve, dhe thotë: “Sa i përket këtyre vizitave, vështirë është të shkosh në vendet e luftimeve. Vështirë. Mirëpo, e nevojshme. E nevojshme është që edhe unë të ndjej vuajtjet e tyre në atë luftë, por edhe ata të ndjejnë se çka ka ndodhur këtu, do të thotë, vuajtjet tona.” Ballafaqimi me të kaluarën nuk është i lehtë. Ne me këtë merremi për shkak të së ardhmes, pasi që besojmë se ashtu duhet, dhe se kjo është parakusht për shërimin e shoqërisë dhe shmangies së gabimeve të njëjta në

⁴ Dan Bar-On. *Tell Your Life Story. Creating Dialogue among Jews and Germans, Israelis and Palestinians* (Budapest: CEU Press, 2006), fq.26.

⁵ Nexhad Horozoviq. *Vizitat e veteranëve* (Beograd, Sarajevë: QAP, 2009), DVD. Në dispozicion në http://kino.nenasilje.org/posjete_veterana_2009.

të ardhmen. Për këtë është e nevojshme ndershmëri e mjaftueshme dhe fuqi që së pari të shikosh veten e pastaj edhe njerëzit përreth. Nenadi tregon se sa e rëndësishme është që sa më shumë njerëz të inkuadrohen në aktivitetet paqësore dhe shpjegon: “Kjo është më së shumti për të ardhmen... Më shumë më intereson ardhmëria e fëmijës tim dhe fëmijëve të tij, që atyre të mos u përsëritet kjo që na ka ndodhur neve.”

Doracak për punë me ballafaqimin me të kaluarën përmes trajnimeve dhe punëtorive

Rreth trajnimit të QAP

Tamara Shmidling

Gjatë përvojës sime pesëmbëdhjetë vjeçare në ndërtimin e paqes në rajonin e ish Jugosllavisë, anëtarët/et e ekipit të QAP kanë zhvilluar një koncept unik të trajnimit për ndërtimin e paqes dhe shtjellimit të padhunshëm të konflikteve, të përshtatshëm për nevojat veçanta dhe formave komunikative në rajonin e ish Jugosllavisë. Segment i rëndësishëm i çdo trajnimi është puna me ballafaqimin e së kaluarës.

Përse trajnim?

Programet joformale të arsimit për paqe, përmes trajnimeve dhe punëtorive, janë vetëm njëra nga mënyrat e mundshme të ndikimit në fushën e ndërtimit të paqes. Suksesi i plotë arrihet vetëm në kombinim me llojet e ndryshme të ndikimit, që përfshijnë punën në tre nivelet e piramidës shoqërore (*grassroots, middle dhe top level*), ashtu siç e ka definuar John Paul Lederach⁶. Kjo përfshin reformën e institucioneve, zonën e politikave publike, rregullat legjislative, lobimin dhe përfaqësimin e qasjeve konstruktive për zgjidhjen e problemeve më të rëndësishme shoqërore, por edhe padhunshmërinë, aksionet direkte në komunitetet lokale, si dhe ato që janë të fokusuara në bashkëpunimet përtej kufijve. Këto aksione mund të zhvillohen në spektër të gjerë, nga zgjidhja e problemeve të shërbimeve lokale deri tek aktivitetet e drejtuara kah ndërtimi i besimit ndëretnik dhe mikroprocesit të pajtimit në nivel lokal.

Në këtë spektër të gjerë të mënyrave të mundshme të veprimit, rëndësia e arsimit për paqe në kontekstin e ndërtimit të paqes është kyçe dhe bazike. Pas një deklarate të tillë qëndron besimi se transformimi i shoqërisë që është i vërtetë, i thellë dhe afatgjatë, që shpie nga një shoqëri e cila zgjedh dhunën si përgjigje dominante ndaj problemeve, drejtë një komuniteti i cili është rregulluar në bazë të vlerave të paqes dhe padhunshmërisë, është i *pamundshëm* pa arsimim për paqe të menduar mirë dhe të qëllimshëm. Ky lloj i arsimit për paqe duhet të nxisë, të forcojë, të provokojë, të inspirojë me kontinuitet, të mbajë të qëndrueshëm dhe me përgjegjësi ndikimin në shoqëri.

⁶ John Paul Lederach. *Building Peace: Sustainable Reconciliation in Divided Societies* (Washington: U.S. Institute of Peace, 1997)

Për këtë shkak është e rëndësishme të potencohet se trajnimi është vetëm mjet, vegël, të cilën e përdorim që të fillojmë ndryshimin shoqëror. Trajnimi nuk është qëllim në vetvete, e as nuk është neutral sa u përket vlerave. Sipas fjalëve të koleges sonë Ivana Franoviq:

Me arsimim për paqe nënkuptoj atë edukim i cili është pa mëdyshje i anshëm – ai që shqyrton, që stërvit, që mbështet, që inkurajon, që hulumton, që mëson, që punon – për paqe, ndërsa kundër dhunës. Dhe ai nuk guxon të jetë vetëm “informativ”, por duhet të jetë i përcaktuar në nivel përvojash dhe vlerash (assesit neutral) – që të nxisë ndryshime në shoqëri dhe ndryshime të ne vetë, si vepra të asaj shoqërie, dhe të na nxisë që të punojmë për ato ndryshime; të kritikojë, të rishikojë dhe si pyetje kyçe të ketë: ku gjendemi ne në krejt këtë, cila është përgjegjësia jonë dhe çka mund të bëjmë ne për këtë⁷.

Trajnimi për ndërtimin e paqes pjesëmarrësve u jep mundësinë për:

- Senzibilizim për gjithë spektrin e problemeve shoqërore të cilat shpesh gjenden në margjinat e interesimit të institucioneve shtetërore, sistemit arsimor etj.
- Rishikim të qëndrimeve dhe vlerave individuale, si dhe shqyrtimin e pozitës individuale në shoqëri
- Marrjen e njohurive dhe aftësive të domosdoshme, të nevojshme për punë në ndryshimin shoqëror pozitiv, përkatësisht për luftë kundër padrejtësive shoqërore
- Nxitje dhe përforsim në angazhimin konkret shoqëror, në nivelin lokal, shtetëror, rajonal
- Lidhje me njerëzit në rajon që punojnë me problemet e njëjta ose të ngjashme
- Ndërtimin e aleancave të domosdoshme në ndërtimin e paqes stabile dhe të qëndrueshme

Llojet e trajnimit

Gjatë punës sonë shumëvjeçare kemi zhvilluar programe të ndryshme të arsimit për paqe, nga të cilët dallojmë:

- *Trajnimit bazik të ndërtimit të paqes*, program dhjetëditor të cilin e organizojmë 2-3 herë në vit. Deri më tani kemi organizuar 37 trajnime bazike.
- *Trajnim për pjesëmarrësit e luftërave*, program për veteranët e luftës të cilët i organizojnë mesatarisht një herë në vit.
- *Trajnim i avancuar i ndërtimit të paqes*, program për pjesëmarrësit/et më të motivuar të cilët kanë kaluar trajnimin bazik.
- *Trajnim për trajnues/ese*, program gjashtë mujor ose një vjeçar, që deri më tani ka pasur gjithsej 5, ndërsa i fundit ka mbaruar në vitin 2004. (Do të mundohemi që gjatë vitit 2014 të organizojmë edhe një).

⁷ Ivana Franoviq. “Arsimimi për Paqe si Nxitës i Ndryshimeve Shoqërore” Në: H. Rill T. Shmidling, A. Bitoljau (ur.), 20 Nxitje për Zgjim dhe Ndryshim (Beograd – Sarajevo: Qendra për Aksion të Padhunshëm 2007), fq. 91.

Për kë janë të dedikuar trajnimet?

Trajnimet bazike për ndërtimin e paqes janë të hapura për persona të moshave, profesioneve, gjinive, përkatësive etnike dhe fetare të ndryshme. Thirren njerëz aktiv në OJQ, të punësuarit në institucionet arsimore, aktivistë/e të partive politike, gazetarë/e, veteranët e luftërave, anëtarët/et e shoqatave të viktimave, personat e punësuar në institucionet shtetërore, punëtorët/et social. Me një fjalë, mund të paraqiten të gjithë ata që janë të motivuar për punë paqësore dhe marrje të përgjegjësisë për shoqërinë dhe komunitetin e vet.

Koncepti i trajnimit është vendosur ashtu që kërkon pjesëmarrje intensive dhe kontribut personal të çdo pjesëmarrësi/e, dhe kështu kufiri më i ulët i moshës për paraqitje është 21 vjet, ndërsa kufiri më i lartë nuk ekziston.

Grupet janë regionalisht dhe etnikisht shumë heterogjene, të ndërtuara nga njerëz të të gjithë vendeve të ish Jugosllavisë (Serbisë, Kroacisë, B dhe H, Maqedonisë, Kosovës dhe Malit të Zi), përveç në raste kur trajnimet kanë dizajne specifike, të cilat janë të fokusuara në mikroregjione. Gjatë zgjedhjes së grupeve kriteri i rëndësishëm për ne është edhe potenciali i vlerësuar i multiplikimit dhe aplikimi i njohurive.

Trajnimet për pjesëmarrësit e luftërave (tani për tani nga Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia dhe Serbia), ndërsa *trajnimi i avancuar i ndërtimit të paqes është* i dedikuar për pjesëmarrësit më të motivuar të cilët kanë kaluar *trajnimin bazik*.

Si duket një trajnim tipik i QAP?

Kohëzgjatja. Trajnimet që organizon dhe udhëheq ekipi i QAP zgjatin prej 3 deri më 10 ditë, varësisht nga lloji dhe niveli i trajnimit, nga përzgjedhja e temave dhe nga përbërja e grupit.

Ekipi i trajnerëve. Insistojmë në dizajnimin, udhëheqjen dhe evaluimin e trajnimit si *proces ekipor*. Prandaj, çdo trajnim e përgatitim në ekepe të përbëra nga dy deri më katër persona, të cilët janë nga pjesë të ndryshme të ish Jugosllavisë. Gjatë përbërjes së ekipit të trajnerëve tentohet që sa më shumë që është e mundur të bëhet bilanci gjinor, rajonal dhe etnik. Përrjashtim bëjnë *trajnimet për pjesëmarrësit e luftërave* ku ekipin e trajnerëve, si dhe grupin e përbëjnë vetëm burra.⁸

Të gjithë trajnerët/et nga ekipi i QAP janë mirë të trajnuar për punë me grupe të ndryshme dhe kanë përvojë trajnuese shumëvjeçare. Gjithashtu, shpesh ndodh që ekipit t'i bashkëngjitet dikush nga kolegët/et me më pak përvojë ose kolegë/e nga organizatat me të cilat bashkëpunojmë.

Ekulibri i mirë i ekipit të trajnerëve në raport me grupin është, sipas përvojës sonë, njëri nga faktorët kyç në ndërtimin e besimit ndërmjet ekipit dhe grupi. Kjo veçanërisht vjen në

⁸ Përvoja na ka treguar se në trajnimet fillestare për veteranë, procesi i ndërtimit të besimit dhe vendit të sigurt, që janë të nevojshëm për bisedim të sigurt dhe të hapur rreth luftërave të kaluara, ndodh që të jetë i vështirë me praninë e grave. Prandaj, kemi marrë vendimin që për fillim të mos insistojmë në këtë segment të barazisë dhe ndërtimit të paqes. Por, për këtë do të flasim më shumë në ndonjë rast tjetër (prim.ur.).

shprehje në punë me grupet “më të ndjeshme” dhe më komplekse, siç janë për shembull, veteranët e luftës. Për këtë shkak kujdes më i madh i jepet formimit të ekipeve për punë me grupe të tilla, sepse përvoja ne na mëson se kjo është faktor kyç në ndërtimin e besimit midis pjesëmarrësve/eve dhe ekipit të trajnerëve.

Metodologjia që përdorim. Metodologjia që përdorim në trajnimet është e karakterit interaktiv, me punëtori, në masë të madhe mbështetet në të mësuarit nga përvoja, dhe domosdo përfshin përvojat jetësore personale të pjesëmarrësve/eve. Kjo nënkupton punën në plenum dhe në grupe të vogla, ndërsa ndonjëherë edhe punën e pavarur: diskutimet në grupet më të mëdha ose më të vogla, në barometra, përgatitjen dhe/ose interpretimin e prezantimeve, gazetat e murit dhe “brainstormingje”, luajta e roleve dhe stimulimi i situatave reale, shkëmbim të përvojave dhe tregimeve personale, inpute të shkurtra teorike, ndonjëherë edhe analiza të mediave të shkruara, filma dokumentarë, artikuj përkatës nga literatura etj. Ekipi i trajnuesve tenton që, bashkë me grupin të formojë hapësirë të sigurt ku *ndërmjet veti dëgjohen dhe bisedojnë, ndajnë dhe reflektojnë*.

Në këtë mënyrë, as trajnuesit/et nuk janë në pozitën e ligjëruesit/es, e as pjesëmarrës/se nuk janë konsumatorë pasiv të dijes dhe informatave që ua përcjell ekipi i trajnuesve. Punëtoritët fitojnë kualitetin e plotë atëherë kur realizohet interaksioni, shkëmbimin e përvojave personale, mendimeve dhe dilemave në grup; respektivisht ndërtimi i hapësirës së përgjegjësisë së përbashkët në të cilën të gjithë marrin pjesë në kornizat e mundësive të tyre.

Përgjegjësia e ekipit trajnues përbëhet nga vendosja e kornizave të konceptit të gjithë trajnimit, dhe në ndjekjen e kujdesshme të nevojave të grupit gjatë trajnimit. Trajnuesit/et vendosin kornizat tematike dhe metodologjike për punë ndërsa përgjegjësinë për vet përmbajtjen dhe cilësinë e diskutimit përpiqen ta ndajnë me pjesëmarrësit/et e grupit.

Ndihmë e madhe për ekipin trajnues është që të kenë sa më shumë informata për përbërjen e grupit që më parë. Ndërsa, për rastin e trajnimeve shumëditore resurs i rëndësishëm janë vet punëtoritë fillestare gjatë të cilave mund të arrihet imazhi se me çfarë lloj përvojash disponon grupi dhe çfarë mund të jenë tabut dhe pengesat, e çfarë mund të jenë rrethana lehtësuese për punë konstruktive. Gjatë punës me grupet e ndryshme mbahet llogari veçanërisht rreth mjaftueshmërisë, përshtatshmërisë dhe shumëllojshmërisë së metodave të shfrytëzuara dhe teknikave të punës. Edhe puna me veteranët e luftës edhe puna me, për shembull, të rinjtë, kërkojnë kreativitet dhe fleksibilitet, siç e parasheh tema, ashtu edhe në mënyrën e realizimit të tyre. Gjithsesi, pamja përfundimtare e këtyre trajnimeve zakonisht dallon konsiderueshëm për shkak të specifikave të çdo njërit nga grupet dhe nevojat e tyre të ndryshme, interesimit, nivelit të të qenit të hapur për këtë lloj pune. Metodologjia optimale për punë me cilëndo grup duhet të përfshijë ato mjete metodologjike të cilat në masë më të madhe u mundësojnë pjesëmarrësve/eve që të shprehen dhe të ndjehen të sigurt në grup.

Nuk duhet harruar:

- Sado që të jenë të motivuar njerëzit, kanë nevojë për momente pushimi dhe ajër të pastër nga shtjellimi i temave të rënda.
- Sado që të jenë diskutimet e frytshme dhe interesante, ato nuk janë qëllim në vetvete dhe nuk duhet tepruar me kohëzgjatjen dhe intensitetin e tyre.

Ku i organizojmë trajnimet? Njëri nga parakushtet për ndërtimin e suksesshëm të grupit

është edhe zgjedhja e vendit për mbajtjen e trajnimit.

Për zgjedhjen e vendit të trajnimit përqipemi të gjejmë vend i cili përmbush kushtet e mëposhtme:

- Ndjenja e sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit/et
- Mundësia e qasjes së lehtë dhe transportit deri tek vendi i zgjedhur
- I shmangemi përzgjedhjes së ndonjë vendi të izoluar
- I shmangemi përzgjedhjes së zonave qendrore të qyteteve të mëdha, ose vendeve turistike në valën e sezonit.

Në një rajon i cili ende është i ngarkuar me mosbesim dhe me një numër të madh të paragjytimeve, me rëndësi të veçantë është të zgjedhësh mjedis në të cilin të gjithë njerëzit në grup, në masë më të madhe, do të mund të ndjehen të sigurt dhe të relaksuar me identitetet e tyre.

Të punohet në hotel (që është rast më shpeshtë në rajonin tonë) ose në shtëpi të dedikuar në mënyrë speciale për mbajtjen e trajnimeve dhe seminareve, e rëndësishme është sigurosh hapësirë të përshtatshme e cila është mjaftueshëm e madhe dhe e ndritshme, e cila në mungesë të alternativave adekuate mund të shërbejë si hapësirë për t'u shoqëruar në orët e mbrëmjes dhe aktiviteteve në kohë të lirë.

Koncepti i trajnimit

Një ditë pune tipike në trajnim është e organizuar në dy blloqe, në atë paradite dhe në atë pasdite, të cilët zgjasin përafërsisht nga 3,5 orë, me pauzë për t'u relaksuar në mes të blloqeve. Ndërmjet dy blloqeve kemi pauzë 3 orësh për pushim dhe relaksim.

Dita e punës dizajnohet ashtu që në fillim organizohet hyrja në temë, ndërsa fundi i sesionit të pasdites zakonisht është i rezervuar për rrumbullaksimin e temave të hapura, dhe për “daljen” dhe evaluimin e ditës.

Në rast të *trajnimit bazik për ndërtim të paqes* orari i temave është i vendosur ashtu që të niset nga ato të lehtat (komunikimi dhe puna ekipore), drejt temave më të rënda dhe më komplekse (të kuptuarit e konflikteve, dhuna, paragjykimet, ndërtimi i paqes dhe ballafaqimi me të kaluarën), dhe rrethi përfundon me një set temash të cilat janë të fokusuara në mundësitë e veprimit konkret në komunitetin lokal dhe më gjerë (shtjellimi kreativ i konflikteve, padhunshmëria dhe aksioni i padhunshëm).

Në rast të trajnimeve me pjesëmarrësit e luftës, tentohet që të hapen dialogje të sinqerta si rrugë drejt zhvillimit të empatisë. Që të arrihet deri tek ajo, punohet në të dëgjuarit dhe të kuptuarit të ndërsjellë, ashtu që të mos tejkalohen çështjet e rënda, por për ato flitet pa akuzime dhe gjeneralizime të ndërsjella. Atmosfera e dialogut, e të kuptuarit dhe e besimit e krijuar një herë, është bazë për aksione paqësore të përbashkëta, konceptimi i të cilave shpesh është pjesë e trajnimit. Me vet grupin e formuar i cili i ka kaluar bazat e dialogut dhe ka filluar bashkëpunimin, kemi udhëhequr trajnime specifike të njohurive dhe aftësive të thelluara, në temat siç janë planifikimi i veprimit ose kultura e përkujtimit.

Përmbajtja e çdo trajnimi është shpikur në mënyrë që ofron mundësi për punë në dy nivele paralele:

- **Personal**, që nënkupton rishikimin e vet mekanizmave dhe modelet e sjelljes në situatat e punës ekipore; situatave konfliktuoze; situatave në të cilat biem ndesh me dhunën direkte, strukturore ose kulturore;

- **Shoqëror dhe politik**, që ofron mundësinë për të kuptuarit e shoqërive në të cilat jetojmë dhe fenomeneve të cilat na rrethojnë, të kuptuarit e të cilave është e nevojshme për të punuar në mënyrë aktive në fushën e ndërtimit të paqes.

Trajnimet e ndërtimit të paqes janë mundësia për ndryshim personal, zhvillim dhe përparim. Ata, megjithatë, paraqesin një akt të qartë të veprimit politik, dhe si të tillë fuqizojnë qëndrimin që me politikë mundet dhe medoemos të merremi në mënyra të ndryshme konstruktive dhe në nivele të ndryshme.

Parimet themelore të punës sonë trajnuese

Përgjegjësia për procesin dhe përmbajtjen është e përbashkët. Me ndarjen e përgjegjësiave të caktuara me grupin dëshirojmë të dërgojmë mesazh se nga të gjithë njerëzit në rreth dhe kontributit të tyre individual, varet cilësia e punës së përbashkët. Duke pasur parasysh se gjëja themelore të cilën dëshirojmë ta nxisim tek pjesëmarrësit/et është marrja e modeleve të qytetarëve/eve të përgjegjshëm për shoqërinë në të cilën jetojnë, situatën e trajnimit e shohim si një mundësi të shkëlqyeshme për të ushtruar ndikimin e përgjegjshëm që nënkupton pjesëmarrje aktive individuale, emërtimin e problemeve kur i vërejmë, ofrim të zgjidhjeve alternative, ofrim të mbështetjes së atyre që kanë nevojë, përgatitje në të kuptuarit kritik të procesit në grup.

Ekzistojnë edhe përgjegjësi specifike të ekipit trajnues. Trajnuesit/et gjithsesi kanë një sërë përgjegjësisë specifike që fillojnë nga vendosja e kornizave të punëtorisë, përmes udhëheqjes dhe moderimit të diskutimeve, deri tek ndjekja e nevojave të të gjithë njerëzve në grup, që disave prej tyre, të mund t'u përgjigjen në procesin e punës. Kjo nuk do të thotë se misioni i ekipit është që të përmbush të gjitha dëshirat dhe kënaqësitë e mundshme, të gjitha nevojat në lidhje me trajnimin. Para së gjithash bëhet fjalë për domosdoshmërinë e ekzistimit të vetëdijes se punojmë në rajon të ndjeshëm, në tema të ndjeshme, me njerëz që tregimet e tyre jetësore kanë plot përvoja të rënda nga lufta dhe pas lufta. Për këtë shkak, qëllim i punës kualitative është, domosdoshmëria që pandërprerë të dëgjohet se si merr frymë grupi dhe cilët janë kufijtë e tij, dhe në përputhje me këtë të vlerësojë se sa larg dhe sa thellë mund të shkohet në përpunimin e temave të caktuara. Zgjedhja e temave më të përshtatshme, mbajtja e llogarisë rreth metodologjisë së ndryshme, perceptimi i mekanizmave të dinamikës grupore, aftësia që të hapen dhe të ndërpriten diskutimet kur është e nevojshme – e gjithë kjo hyn në domenin e përgjegjësiave të specifike të trajnuesve. Me rëndësi të veçantë është të kihet parasysh se puna e trajnuesve nuk është një gjë mund ta zotërosh brenda një nate, veçanërisht jo në trajnimet intensive dyditore. Bëhet fjalë për një punë dhe për njerëz dhe kjo gjë kërkon edukim afatgjatë, kodeks të qartë etik dhe ndërlidhje të qartë të qëllimeve të dëshirueshme dhe mundësive që realizimin e tyre e sigurojnë trajnimet dhe puntoritë.

Trajnuesit/et nuk janë vetëm moderatorë/e dhe fascilitatorë/e të procesit. Ata shpesh marrin pjesë në diskutimet ku paraqiten përjetimet individuale, mendimet dhe përvojat personale. Në këtë mënyrë hapësira e sigurt në grup dhe besimi në relacionin grup-ekip ndërtohet më tej, ndërsa ekipi i trajnuesve përpiqet që t'i ikë kurthit që të përjetohet si një ekip i cili “vëren dhe vlerëson”. E nevojshme është, natyrisht, që vazhdimisht të kemi në mendje specifikimin dhe përgjegjësinë e pozitës së trajnuesve, të kemi parasysh faktin se hapësira që e ndajmë së bashku

dhe të mësuarit të mos kthehen në një skenë për të prezantuar vetëm qëndrimet e trajnuesve. Gjithashtu e rëndësishme është që të kihet kujdes që qëndrimet e prezantuara nga ana e ekipit trajnues të kenë rëndësi specifike, dhe është e nevojshme që të gjendet një masë e mirë në të dhe të kihet kujdes në sensibilitetin e rolit individual.

Dallimet në të menduarit nxiten dhe inkurajohen. Mënyrat e ndryshme në të cilat i shohim, i ndjejmë dhe i mendojmë gjërat janë pjesë normale e jetës sonë. Dallimet në të menduarit janë veçanërisht të vlefshme dhe e pasurojnë kontekstin e trajnimit. Për këtë shkak, ekipi i trajnuesve synon të inkurajojë pjesëmarrësit/et që të shprehin mendimet të cilat ndoshta janë të ndryshme nga ato të që mbizotërojnë në shumicën e diskutimeve (qoftë në shoqëritë tona, qoftë në vet trajnimin). Hapësirën në trajnim nuk e shohim vetëm si situatë e cila duhet të rezultojë me marrëveshje të përgjithshme dhe miratimin e konkluzioneve të përbashkëta, por parasëgjithash si shans për të gjithë ne të mësojmë të dëgjojmë qëndrimet e ndryshme dhe të kemi qasje konstruktive ndaj tyre.

Çështjet e rënda dhe çështjet të cilat janë burim i mospajtimit nuk anashkalohe. Njëri nga tiparet e njohura të trajnimeve të QAP është edhe përgatitja që në punëtoritë të merren me çështjet më të dhimbshme të shoqërive tona, si dhe ato çështje me potencial më të lartë për konflikt (d.t.th. ato që në shoqëritë tona janë burim i diskutimeve dhe mospajtimeve të pandërprera). Ekipi trajnues përpiqet që të vlerësojë mirë se sa është potenciali i një grupi të caktuar që në mënyrë konstruktive të merret me këto çështje dhe t'i "trajtojë" ato. Nuk praktikohet qasja "me kokë në mur", por nuk mund t'i nënshtrohesh ndonjëherë as pritjes së pranishme që të shmanget hapja e këtyre çështjeve për shkak të harmonisë në grup. Atë që duam të promovojmë më punën tonë është besimi se përparim i vërtetë mund të ndodh atëherë kur do të bëjmë mes veti një hapësirë që të flasim hapur për temat e ndërlikuara. Edhe pse, ndonjëherë kjo mund të duket si kundërshtim i drejtpërdrejtë i nevojave për formimin e grupit, përvoja jonë tregon se me këtë qasje arrihet besim më i fortë dhe më thelbësor mes njerëzve.

Konceptet fleksibile, në vend të pikave të planifikuara dhe të pandryshueshme që më herët. Përvoja shumëvjeçare na ka mësuar se çelësi i trajnimit të suksesshëm është në të dëgjuarit e kujdesshëm të nevojave në grup, si dhe në ndjekjen e kujdesshme të mundësive dhe kufijve brenda grupit. Plani i paraqitur i punës që më parë në trajnim mund të tregohet si një pengesë e madhe kur konstatojmë se me grupin e caktuar është e domosdoshme që të shkojmë në drejtim tjetër, ose duhet t'u kushtojmë kujdes temave të caktuara, ndërsa disave t'u largohemi tërësisht. Për këtë shkak përpiqemi që për çdo trajnim të vendosim korniza me pika të listuara të cilat medoemos duhet t'i mbulojmë. Mënyrën në të cilën do ta bëjmë këtë gjë e caktojmë kur e shohim dhe "e ndjejmë" grupin, dhe punëtoritë i përgatitim çdo ditë në mbrëmje pas evaluimit. Kjo gjë kërkon përpjekje dhe përvojë të madhe të ekipit trajnues që për një kohë të shkurtër të gjenden mënyra të mira të përgjigjeve për nevojat e vërejtura të grupit me të cilin punohet, në vend të skemave të punëtorive të përgatitura më parë.

Përparësi i jepet përvojës dhe praktikës konkrete në raport me modelet dhe konceptet teorike. Trajnimet që organizon QAP nuk janë programe akademike dhe fokusi është vendosur në shkëmbimin e përvojave dhe praktikave konkrete të pjesëmarrësve/eve të trajnimit. Për këtë shkak, në aspektin metodologjik, ushtrimet, diskutimet, dhe shkëmbimet në grup kanë përparësi në raport me analizën dhe prezantimin e modeleve teorike. Gjithsesi, se në punë merren parasysh konceptet e zhvilluara teorike ekzistuese, mirëpo, vetëm atëherë kur nuk janë qëllim në vetvete, por kur reflektojnë problemet e shoqërive tona dhe kur ndihmojnë në të kuptuarit e fenomeneve të caktuara (siç janë dhuna, konflikti, identiteti dhe konstruktet e tij, etj.).

Shembujt e ushtrimeve për krijimin e punëtorive



Të njoftuarit
ushtrimet hyrëse

Qëllimet e këtyre grupeve të ushtrimeve:

Çdo trajnim, pa marrë parasysh fokusin tematik, kohëzgjatjen dhe intensitetin, kërkon që pjesëmarrësit/et dhe anëtarët/et e ekipit trajnues të njoftohen mes veti dhe të kenë mundësinë të prezantohen mes veti. Shpesh do të vërtetohet pas disa punëtorive se njoftimi paraprakisht i menduar mirë është themel për krijimin e atmosferës nxitëse për punë dhe hapësirës së sigurt brenda grupit.

Ushtrimet hyrëse për t'u njoftuar kanë për qëllim të sigurojnë informacione bazike për secilin nga pjesëmarrësit/et, të formojnë bazën jo vetëm për shkëmbimin faktografik, por edhe për shkëmbimin e mëtejshëm përmes përvojës dhe shkëmbimin emocional, të lehtësojnë njohjen e gjërave që i kanë të përbashkëta, si edhe të njohin dhe të vlerësojnë dallimet në përvojat, vlerat dhe vizionin ndaj botës. Është shumë e rëndësishme që përzgjedhja e ushtrimeve të jetë e përshtatur mirë për grupin me të cilin punohet që pjesëmarrësit/et as mos lodhen tepër por as ta kuptojnë këtë si formalitet të thjeshtë në rrugën drejt temave të “vërteta” të trajnimit.

Përvoja na tregon se anëtarët/et e ekipit trajnues duhet të marrin pjesë në procesin e njoftimit.

Metodologjia të cilën e përdorim gjatë njoftimit dhe ndërtimit të grupit:

Ushtrimet e propozuara shfrytëzohen me metoda të ndryshme të punës interaktive – punë në grupe të mëdha; punë në çifte; punë në grupe më të vogla. E rëndësishme është që gjatë përzgjedhjes së ushtrimeve të kihen ndërmend disa fakte:

- Ushtrimet e ndryshme mbulojnë aspekte të ndryshme të të njoftuarit. Duhet të vlerësohet mirë se cili nivel i të njoftuarit i nevojitet grupit me të cilin punojmë, dhe sa thellë duam të shkojmë në të njoftuarit në punëtoritë fillestare.
- Njerëzve të ndryshëm u konvenojnë mjete të ndryshme të shprehjes. Disa pjesëmarrës/se më mirë do të ndjehen me vetë prezantimin verbal, disa të tjerëve më shumë ju konvenon të shkruajnë, ndërsa të tretëve më lehtë ju shkon ndonjë mënyrë e paraqitjes vizuale përmes vizatimit, fotove dhe rekuizitave të tjera. Mirë është që të kemi parasysh këto dallime dhe të tentohet të ketë bilanc të mirë ndërmjet teknikave të ndryshme të shprehjes.

Rrethet koncentrike për njohje


Të gjithë nga grupi ulen në karriget të cilat janë të vendosura në dy rrethe koncentrike, ashtu që secili nga njëri rreth rri ulur përballë një personi nga rrethi tjetër. Të gjithë bisedojnë në çifte me personin që kanë përballë, dhe pas 3-5 minutash kohë për bisedë pjesëmarrësit/et nga rrethi i brendshëm lëvizin për një vend në anën e djathtë, në këtë mënyrë çdo kush fiton bashkëbisedues/e të ri për pyetjen e ardhshme. Pas bisedës së shkurtër pjesëmarrësit/et nga rrethi i jashtëm rrotajnë për një vend nga ana e djathtë...

Disa nga pyetjet e mundshme për bisedë:

- Me çka merresh?
- Vendi ku jetoj?
- Familja ime...
- Ngjarja që më së shumti ka ndikuar në jetën time
- Cili person ka pasur ndikim të fuqishëm në jetën time?
- Çka më solli mua këtu?
- Si ndikon politika në jetën time?
- Çka do të doja të ndryshoj?
- Pasojat e dukshme dhe "të padukshme" të luftës në vendin ku jetoj?
- Disa gjëra që i kam të rëndësishme në jetë
- Çka duhet të arrij patjetër në jetë?
- Cila është mbështetja ime?
- Me çfarë kënaqem vërtetë shumë?
- Shumë nervozohem kur...
- Dua të të pyes?

Kohëzgjatja: 20-60 minuta (varësisht nga numri i pjesëmarrësve/eve dhe ritmit së rrotimit)

Vërejtje: Ky ushtrim nuk mundëson që çdokush të bisedojë me çdokënd, por është zgjedhje e mirë për ata njerëz të cilët e kanë më lehtë që në fillim të trajnimit të bisedojnë për një temë të caktuar vetëm me një person, në vend që mendimet e tyre t'i shprehin para gjithë grupit. E rëndësishme është që përzgjedhja e pyetjeve për bisedë të jetë e përshtatshme për profilin e njerëzve në grup. E nevojshme është që udhëzimet për kohëzgjatjen të jepen qartë, që në secilin rotacion të dy bashkëbiseduesit/et të kenë mundësi të prezantojnë veten.





Emri im

Pjesëmarrësit/et janë të ulur në rreth. Një nga një, kanë për detyrë ta thonë emrin e vet dhe të tregojnë ndonjë tregim lidhur me atë: çka do të thotë, si e ka marrë emrin, kush ia ka lënë...

Diagramet e Venit

Të gjithë marrin nga një fletë në të cilën ka të vizatuara diagrame të Venit (tre qarqe/elipsa të cilat kryqëzohen, të shihet në foto) aq sa ka pjesëmarrës/se. Një diagram i Venit është për një person. Në vendin e paraparë duhet të shkruhet emri i tij dhe në çdo rreth të atij diagrami duhet të shkruhet nga një informacion i caktuar për të. Për shembull:





1. Ku jeton?
2. Me çfarë kënaqesh?
3. Një specialitet kuzhine i yti.

Pjesëmarrësit/et çohen nga vendet e tyre dhe kanë për detyrë t'i afrohen çdo personi në grup, t'i parashtojnë pyetje nga diagrami dhe t'i shkruajnë në fletën tyre.

Kohëzgjatja: 30 minuta



Vërejtje: Me këtë ushtrim mund të arrihet që emrat e të gjithëve në grup të mbahen mend më lehtë, është ushtrim i mirë në fillim të seminarit/trajnitimit pasi që i vendos njerëzit në situatë që të gjithë të fillojnë të kontaktojnë (kontakti i parë) dhe është shumë mirë që njerëzit mund të lëvizin, pasi që kjo ndikon shumë mirë në krijimin e atmosferës së relaksuar. Natyrisht, fletat e mbushura me diagramet mbeten tek pjesëmarrësit (shpesh u shërbejnë për t'u kujtuar, kur duan t'u kujtohet emri i dikujt). Ne nuk formulojmë shpesh pyetje të tretë, por u japim pjesëmarrësve detyrë që të formulojnë pyetje të cilën do t'ua parashtojnë të gjithëve. Ky variant i ushtrimit është më argëtues, pasi që pyetjet dinë të jenë të llojllojshme, por edhe interesante (psh. nga "A e do Kryetarin tënd?" deri tek "Më trego një barsoletë."). Duhet të kemi parasysh se kohëzgjatja e ushtrimit mund të zgjatet nëse njerëzve u duket situata zbavitëse, andaj mund të jetë e dobishme në qoftë se e kufizojmë kohën.



Pritshmëritë nga trajnimi

Në tre flipchartat e vendosura (në mur ose në dysheme) është shkruar njëra nga pyetjet që vijnë:

- Çfarë pritshmëriësh kam nga ky trajnim?
- Çfarë pritshmëriësh kam nga vetja në këtë trajnim?
- Çfarë pritshmëriësh kam nga të tjerët në këtë trajnim?

Secili/a për vete, në letrat vetë ngjitëse (stikera), duhet të shënojë përgjigjet e veta. Pastaj, një nga një le të afrohen pranë flipcharteve, le të lexojë përpara të gjithëve çfarë ka shkruar dhe le të ngjis/vendos letrat në flipchartin përkatës.

Rruga ime deri këtu

Çdokush për vete në një letër le të vizatojë një shigjetë që do ta ilustrojë rrjedhën e jetës, “rruga ime deri këtu”, dhe në të le të shënojë vendet, respektivisht pikat të cilat kanë qenë të rëndësishme për të në jetë (deri 5 minuta). Pastaj, në plenum, çdokush që dëshiron, mund të prezantojë “shigjetën” e tij/saj.


Kohëzgjatja: 90 minuta



Vërejtje: Për këtë ushtrim, është shumë me rëndësi që të zhvillohet në qetësi, të mos ketë pëshpëritje dhe komente në grup, e as zëra nga jashtë të cilët pengojnë, respektivisht duhet të ketë kushte që e tërë vëmendja të përqëndrohet te personi që flet. Ky ushtrim nxit ndërtimin e besimit në grup, megjithëse disa individëve/eve u duket i ndërlikuar si për fillim të trajnimit. Është e dëshirueshme që edhe trajnuesit/et të marrin pjesë në këtë grup dhe në këtë mënyrë të inkadrohen në procesin e të njoftuarit të ndërsjellë, madje mund të bëhet edhe më mirë nëse dikush nga ekipi i trajnuesve fillon i/e pari/para tregimin e tij/saj dhe me këtë u jep shembull të tjerëve. Ushtrimi ofron mundësinë për një njoftim të thellë të grupit dhe nxit empati, dëgjim dhe respekt të ndërsjellë. Shpesh ndodh që realizimi i ushtrimit të tejkalojë kohën e duhur, e kjo mund të jetë e lodhshme për ditën e parë të trajnimit, veçanërisht nëse njerëzit nuk e kanë shprehur që të dëgjojnë me kujdes njerëz tjerë (është gjë e zakonshme). Për këtë shkak është shumë e rëndësishme që ushtrimi të udhëhiqet me mjeshtëri, me ndjesi për njerëzit dhe për tregimet e tyre (të mos ndërpriten, por t'u jepet ndonjë shenjë diskrete se ka kaluar koha e parashikuar). Kjo do të ndihmonte edhe dinamikën e punës. Është e dobishme të potencohet që në fillim të ushtrimit se cilat janë kornizat kohore të parapara për një person, sa kohë ka në dispozicion gjithësej, dhe të përmendet se në cilën mënyrë (diskrete) udhëheqësi/ja do ta paralajmërojë për tejkalimin e kohës.

Vendet që janë të rëndësishme për mua (Harta)

Në mur është e varur harta e ish Jugosllavisë, Evropës ose Botës (më së miri në qoftë se janë të vizatuara vetëm konturet). Një nga një, çdo person i afrohet hartës dhe me stilograf shënon në të, vendet të cilat janë të rëndësishme për të, të cilat e lidhin me ndonjë kujtim apo përvojë të caktuar. Lidhja me çdonjërin prej vendeve duhet shkurtimisht t'u sqarohet të tjerëve në grup.

Kohëzgjatja: 60 minuta

Versioni tjetër i ushtrimit: Në hartën e përgatitur prej më herët vizatohen të gjithë vendet nga vijnë pjesëmarrësit/et. Detyra e tyre është të afrohen dhe të nënvizojnë me cilat prej këtyre vendeve janë të lidhur dhe në çfarë mënyre (ashtu që të gjitha vendet e “tyre” të jenë të lidhura me vijë të ndërprerë)

Kohëzgjatja: 60 minuta

Vërejtje: Në kontekstin e trajnimeve të QAP, i cili mbledh njerëz nga anët e ndryshme të rajonit të ish Jugosllavisë, ky ushtrim mund të ketë rëndësi të veçantë. Kontribuon për të kuptuar përvojat e ndryshme jetësore brenda grupit, konceptimet e ndryshme rreth ish shtetit të përbashkët dhe rajonin e sotëm me kufijtë e shteteve të reja të dala prej tij. Është njësoj i mirë edhe kur punohet me grupe të sapoformuara edhe me grupe që njihen mes veti, dhe mund të punohet në fillim, si edhe në cilën do pjesë tjetër të trajnimit. Është i dobishëm kur nevojitet që njerëzit të kthehen te përvojat personale dhe lidhjet personale, ose kur duhet të kontribuoj për përmirësimin e mirëkuptimit të ndërsjellë.

Vendi nga ku vij

Secili/a në rreth tregon vendin nga vjen dhe tre gjëra të cilat i pëlqejnë, e lidhen me atë vend.

Kohëzgjatja: 20-25 minuta



Vendi ku jetoj (nga vij)

Në dysheme gjendet një letër e madhe e cila mjafton që pjesëmarrësit/et të mblidhen rreth saj (p.sh. disa flip çarte të ngjitura). Pjesëmarrësit/et luten që çdo kush për vete të vizatojë diçka në këtë letër që nuk u pëlqen dhe ka të bëjë me jetën në vendin e tyre (rajonin, shtetin). Ne qoftë se mendojnë se nuk kanë talent për të vizatuar, mund të vizatojnë simbole dhe diagrame. Kur të jenë gati vizatimet çdokush të shpjegojë në plenum për vizatimin e tij.

Letra tjetër e madhe vendoset në dysheme dhe pjesëmarrësit/et luten të vizatojnë diçka që u pëlqen në lidhje me jetën në vendin, rajonin ose shtetin e tyre. Pas kësaj në radhë vijnë shpjegimet në plenum.

Kohëzgjatja: 60 minuta



Vërejtje: Në qoftë se personat nga grupi vijnë nga vende të ndryshme, ky ushtrim mund të shërbejë për të njoftuarit më të mirë të konteksteve të ndryshme nga të cilët vijnë pjesëmarrësit/et. Shërben edhe për të njoftuarit e ndërsjellë, përkatësisht këmbimin e informatave për atë se çka kemi të rëndësishme në shoqëritë e vendeve nga vijnë. Ushtrimi mund të shërbejë si hyrje kur nevojitet një hap përtej nga niveli personal kah niveli shoqëror, duke ua dhënë mundësinë pjesëmarrësve që në qetësi të mendojnë për shoqëritë ku jetojnë. Gjithashtu, ai mundet t'i jap ekipit trajnues informata të mjaftueshme për rrjedhjen e mëtejshme të trajnimit: çka individët ose gjithë grupi tematizojnë, kujt i japin rëndësi të veçantë, në çfarë mënyre interpretojnë disa dukuri shoqërore, çka nuk është përmendur, për çka hesitet...

Biseda në çiftin e zgjedhur

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Pjesëmarrësit/et, për secilën temë, bëhen çift me person të ndryshëm, në këtë mënyrë: me atë për të cilin mendojnë se e është më i/e ngjashëm/e me veten, pastaj më i/e ndryshëm/e nga vetja, pastaj më misterioz/e etj.

Disa nga tema të mundshme për bisedë:

- Prej nga unë këtu?
- Çka dua të arrij në jetë?
- Ngjarja në jetën time që më së shumti ka ndikuar tek unë?
- Në çka me të vërtet gjëj kënaqësi?
- Çka më dhemb në rrethin ku jetoj?

Kohëzgjatja: 25-30 minuta

Unë të prezantoj

Pjesëmarrësit/et ndahen në çifte. Çdo njëri i tregon partnerit të vet diçka për veten. Personi tjetër dëgjon me kujdes dhe mundohet të mbajë mend. Pastaj i ndërrojnë rolet. Në fillim çifteve ju tregohet se sa kohë kanë (më së shumti 10 minuta).

Të gjithë kthehen në rreth dhe në plenum kanë për detyrë ta prezantojnë partnerin e vet përpara pjesëmarrësve tjerë.

Kohëzgjatja: 40 minuta.

Vërejtje: Nëse në grup nuk ka njerëz që njihen mes veti dhe/ose në qoftë se atmosfera është e tensionuar, njerëzve ky ushtrim mund t'u jetë i komplikuar, dhe mund t'u ndihmoj në qoftë se prej fillimi ju tregoni se do të kenë për detyrë që të prezantojnë njëri-tjetrin. Gjithsesi ky ushtrim nuk duhet të bëhet në vet fillimin e ushtrimeve hyrëse. Në qoftë se disa nga njerëzit në grup njihen prej më herët ky ushtrim mund të bëhet shumë interesant.



Tre ngjarjet të cilat kanë ndikuar ne angazhimin tim

Në tabelë në linjën kohore janë prezantuar tre periudha – para luftës; gjatë luftës; pas luftës. Secili duhet për veten e tij të shkruaj nga një gjë/ngjarje nga këto tre periudha të cilat kanë ndikuar në angazhimin e tij/saj në fushën e ndërtimit të paqes. Pastaj, një nga një të gjithë, dalin përpara tabelës dhe shkurtimisht tregojnë çka kanë shkruar.

Vërejtje: *Ushtrimi është i përshtatshëm për grupet të cilat të paktën një pjesë e pjesëmarrësve kanë përvojë me angazhim paqësor/shoqëror.*

Kjo fotografi flet për mua...

Në mes të rrethit janë renditur një numër i madh i fotografive/kartolinave të llojllojshme. Pjesëmarrësit/et kanë pesë minuta që t'i shikojnë dhe të zgjedhin një fotografi e cila në një farë mënyre flet për veten e tyre, por nuk mund ta marrin derisa nuk ju jepet shenjë. Pas kohës së kaluar çdokush merr fotografinë e dëshiruar, dhe shpjegon se përse e ka zgjedhur pikërisht atë, respektivisht si ajo fotografi flet për të.

Kohëzgjatja: 35-40 minuta

Tre identitetet e mia

Çdokush për vete shkruan tre identitete (sipas dëshirës). Pastaj një person çohet dhe lexon një nga një identitetet e tij/saj. Kur e lexon një identitet, bën një pauzë të shkurtër, ndërsa të gjithë ata/ato të cilët e gjejnë veten në identitetin e lexuar, çohen në këmbë poashtu, për një kohë të shkurtër. Pastaj çohet personi i radhës në rreth dhe lexon identitetet e tij/saj...

Kohëzgjatja: 20-25 minuta

Vërejtje: *Në disa nga grupet ndodh që ky ushtrim të mos jetë mjaft i qartë. Forma më e thjeshtë e ushtrimit është që detyra të jetë: të shkruhen tre fjali për veten të cila fillojnë me "Unë jam..."*

Dy të vërteta dhe një gënjeshtër

Ushtrimi mund të bëhet me një grup me të madh ose më të vogël. Luten të gjithë që të shkruajnë nga tre fjali/pohime për veten, por njëra të jetë gënjeshtër. Pastaj, me radhë, çdo pjesëmarrës/se të lexojë fjalitë, ndërsa të tjerët të gjejnë cila është gënjeshtër. (Për shembull: “Unë kam studiuar historinë e arteve”, “ushtroj kik-boks”, “Babai im gatuan mirë.”)

Kohëzgjatja: 20-30 minuta

Kohëzgjatja: Ky ushtrim mund të ndihmojë që njerëzit në grup të njihen mes veti më mirë, por të shërbejë edhe si ushtrim për aftësinë e të dëgjuarit. Mund të bëhet në grup ku pjesëmarrësit/et njihen mes veti, si dhe në grup ku pjesëmarrësit/et nuk njihen mes veti. Ushtrimi është i këndshëm dhe shumë shpesh edhe zbavitës, që kontribuon në krijimin e një atmosfere relaksuese.

Si jemi të lidhur mes veti

Një person shkon në mes të dhomës, thërret dikë nga grupi dhe sqaron shkurtimisht se çfarë i lidh ata të dy. Të dy personat mbeten në mes të dhomës, kështu që personi i dytë thërret personin e radhës, dhe me sqarim të shkurtër tregon se çfarë i lidh ata të dy. Personi i tretë thërret të katërtin dhe kështu me radhë derisa të gjithë nuk gjenden të lidhur në një zinxhir në mes të dhomës. I gjithë procesi, në qoftë se ekziston nevoja për të, mund të përsëritet disa herë. Çdo zinxhirë zbulon lidhjet e papritura ndërmjet njerëzve të cilët ndoshta për herë të parë, takohen në jetë.

Kohëzgjatja: 15-30 minuta

Vërejtje: Bazuar në pohimin se të gjithë njerëzit në botë janë të lidhur mes veti të paktën në një mënyrë, ky ushtrim ofron mundësi zbavitëse që njerëzit në grup të provojnë të njohin lidhjet e ndërsjella. Ushtrimi funksionon po aq mirë edhe me njerëzit që njihen prej më herët, edhe me ata/ato me të cilët takohen për të parën herë. Është e dobishme që pjesëmarrësit/et të nxiten që gjatë ndërtimit të “zinxhirëve” të kërkojnë edhe ato lidhshmëri të cilat nuk janë të dukshme në shikim të parë, dhe të cilat padashje mund t'i anashkalojmë.

Unë prezantohem

Çdokush merr nga një fletë letre dhe në mes shkruan emrin e vet.

Pastaj shënon:

- Në këndin e majtë lartë: si ndjehem momentalisht
- Në këndin e djathtë lartë: dy gjërat që preferoj t'i bëj
- Në këndin e majtë poshtë: librin e fundit që e kam lexuar
- Në këndin e djathtë poshtë: ku dëshiroj që të jem në këtë moment

Pasi ti kenë shkruar përgjigjet, letrën e ngjisin në gjoks, ecin nëpër dhomë, lexojnë se çka kanë shkruar të tjerët/at dhe flasin rreth saj.

Kohëzgjatja: 20-25 minuta

Vërejtje: Ky ushtrim është veçanërisht i përshtatshëm për punë me grupet e të rinjve ngaqë puntorisë hyrëse i jep dinamikë dhe dozë gazi dhe relaksi.

Veri-Jug, Lindje-Perëndim

Luten të gjithë të çohen dhe të pozicionohen në raport me qendrën e dhomës, kështu që pozicioni i tyre në hartën gjeografike tregon se nga cili vend kanë ardhur. Kur ndalen të gjithë aty ku u konvenon, udhëheqësi/ja fillon të ec nëpër dhomë nga njëri person tek tjetri dhe u parashtron pyetje njerëzve se nga janë, si ndjehen atje, çfarë është specifike për atë vend etj.

Pas kësaj vjen në radhë pozicionimi i radhës me pyetje – tani gjeni vendin ku do të kishit dëshirë të jetoni. Udhëheqësi/ja përsëri do të bëjë një “xhiro” nëpër dhomë dhe kësaj radhe do ua jap shansin të gjithë të pranishmëve që t’u përshkruajn të tjerëve vendet ku kanë dëshirë të jetojnë.

Kohëzgjatja: 30 minuta



Ushtrime për të kuptuarit e
kontekstit në të cilin jetojmë

Qëllimet e këtij grupi të ushtrimeve:

Në trajnimet bazike të QAP këto ushtrime bëhen në kornizat e temave të ndryshme të cilat zakonisht u paraprinë temave të ndërtimit të paqes dhe ballafaqimit me të kaluarën: puna ekipore dhe sjellja e vendimeve, të kuptuarit e konflikteve, dhuna, paragjykimet, etj. Para se të punohet më thellë në ndërtimin e paqes, por edhe në ballafaqimin me të kaluarën, më rëndësi është të detektohen dhe të bëhen të vetëdijshme të gjitha ato dukuri shoqërore dhe procese të cilat e cënojnë atë paqe. Po këtë rol e ka grupi i ushtrimeve në vijim. Në qëllimet e tyre bëjnë pjesë:

- Të hartuarit (mapimi) i dukurive sociale dhe proceseve relevante për punë në ndërtimin e paqes;
- Vetëdijesimi i paragjykimeve dhe imazhi për armikun;
- Sensibilizimi për diskriminim dhe lloje të tjera të dhunës, me theks tek dhuna strukturore dhe kulturore;
- Njoftimi shoqëror-politik i rrethanave në shtetet fqinje dhe detektimi i problemeve të përbashkëta dhe të ndërlidhura mes veti.

Disa prej tyre si efekt sekondar mund të kenë njoftimin më të mirë mes veti dhe ndërtimin e besimit brenda grupit, si edhe zhvillimin e empatisë me të tjerët dhe të ndryshmit.

Metodologjia të cilën e përdorim:

Në këtë grup të ushtrimeve më së shumti punohet në plenum edhe pse ka edhe punë në grupe të vogla dhe punë individuale. Metodatat më të shpeshta janë ato që nxisin mësim përmes përvojës, të cilat krijojnë përjetim, dhe kjo është luajtja e roleve, përkatësisht simulimet dhe diskutimet/ndarja në grupe të vogla, që kanë për detyrë përgatitjen e prezantimit për temën e dhënë, pas se cilës vijon vazhdimi i diskutimit ose reflektimi në plenum. Gjithashtu, barometrat mund të jenë metoda të dobishme, veçanërisht kur për qëllim kemi shkëmbimin e mendimeve të ndryshme.

Barometri i madh: Dhuna

Në dysheme gjenden numër i madh i fletëve (të paktën nga një për çdo person në grup) me një nga deklaratat e mëposhtme. Çdo pjesëmarrës/e merr të paktën një deklaratë dhe e vendos në polet “Është dhunë” dhe “Nuk është dhunë” duke u udhëhequr nga të kuptuarit e vetë lidhur me atë deklaratë dhe vlerësimin se në ç’masë është apo nuk është dhunë. Pasi të jenë vendosur të gjitha deklaratat, vazhdon diskutimi për disa nga to: A dëshiron dikush të ndryshojë vendin e ndonjëres deklaratë? Përse? Si e shohin të tjerët këtë gjë?

Tematizohen një nga një deklaratat e propozuara.

Rregullat plotësuese të diskutimit:

- Vetëm shpjegojmë përse do t’ia kishim ndryshuar vendin ndonjëres deklaratë në barometër, por nuk mundemi fizikisht të ndryshojmë vendin e deklaratës/fletës që dikush tjetër e ka vendosur.
- Nuk është qëllimi që si grup të bëjmë marrëveshje se cila pozitë do të ishte ideale për deklaratën e caktuar, por të shkëmbejmë mendimet.



Disa deklarata për barometër:

1. Shtetet Ballkanike janë raciste.
2. Bosnja dhe Hercegovina është shtet i të gjithë boshnjakëve dhe hercegovasve.
3. Diasporës duhet t'i ndalohej votimi.
4. Lejohet që xhamia e shekullit XIII në Prilep, e cila është djegur në vitin 2001, të rindërtohet, por të shërbejë vetëm si përmendore kulturore në të cilin nuk kryhen rituale fetare.
5. Fundamentalizmi paraqet rrezik të madh për paqen në botë.
6. Qytetarët ankohen për shpërnguljen e Romëve në lagjet e tyre, sepse mendojnë se ajo do të shndërrohet në një deponi.
7. Tribunali i Hagës ka kontribuar shumë për paqen dhe pajtimin në rajon.
8. Fëmijët HIV pozitiv nuk duhet të shkojnë në shkollë bashkë me fëmijët tjerë.
9. Një nga prioritetet për rindërtim pas luftës, duhet të jenë objektet e rrënuara fetare.
10. E vetmja rrugëdalje për shtetet Ballkanike janë integritet evropiane.
11. Gjuhët e pakicave duhet të jenë lëndë e domosdoshme në shkollë.
12. Kush dëshiron të punojë – gjithmonë do të gjejë punë.
13. Kujt nuk i pëlqen shteti ku jeton, mund të largohet prej tij.
14. Njerëzve duhet t'u lejohet që në shtëpinë e tyre të vendosim cilin do flamur që duan.
15. Maqedonia është shtet i gjithë Maqedonasve.
16. Grupet e pakicave etnike dhe personat me hendikep duhet të jenë pozitivisht të diskriminuar në konkurset për punësim.
17. McDonald's, Nike, Coca-Cola, Nestle
18. Bashkësia ndërkombëtare është duke vendosur demokraci në Libi.
19. Antarsimi në partinë në pushtet është mënyra më e lehtë tu punësuar.
20. Tarifat e shkollimit janë të rëndësishme për cilësi më të mirë të shkollimit.
21. Shtetet e NATO-s e bombarduan Jugosllavinë që të parandalojnë një katastrofë humanitare.
22. Refugjatëve të papunësuar u është çkyçur rryma për shkak se nuk kanë paguar.
23. Populli gjerman e ka filluar Luftën e Dytë Botërore.
24. Ai është qytetar besnik i këtij shteti.
25. Policia nuk reagon derisa një grup i të rinjve rreh pjesëmarrësit dhe pjesëmarrëset e një geje parade.
26. E drejta e tokës i takon atij që ka ardhur i pari aty.
27. Për paqen në BdeH duhet të vendoset entitet i tretë, ai kroat.
28. Republika Serpska duhet të shfuqizohet.
29. Romët janë popull pa brenga.

Vërejtje: Ky ushtrim mund të përdoret kur duam për një kohë të shkurtër, në mënyrë efikase të hapim dhe të mbulojnë një numër të madh të pikave kyçe. Përveç se është i shkëlqyer për procesin e sensibilizimit për dhunën, kontribuon shumë për kuptimin e kontekstit shoqëror dhe nivelin të shpërndarjes të formave të ndryshme të dhunës strukturore dhe kulturore. Gjithashtu mundet të jetë i dobishëm për ekipin trajnues për "detektim" të shpejtë të temave të cilat janë prioritet për punë në atë grup. E rëndësishme është përzgjedhja e deklaratave të jetë aktuale, dhe me to të mbulohen grupe të ndryshme shoqërore dhe lloje të ndryshme të dhunës. Ne, në çdo trajnim e "rifreskojmë" listën e deklaratave.

Vetë metoda e barometrit të madh mund të përdoret për tema të ndryshme, vetëm duhet përzgjedhja e deklaratave të jetë e përshtatme për temën.

30. Orientimi seksual është çështje private brenda katër mureve të shtëpisë.
31. Të gjithë duhet të dijnë gjuhën zyrtare të shtetit ku jetojnë.
32. Të gjithë që kanë kryer ushtrinë gjatë luftës, kanë qenë pro asaj lufte.
33. Duhet t'i ndihmohet Afrikës që të civilizohet.
34. Në luftë gjithmonë të gjitha palët janë fajtores.
35. Në ushtri bëhesh njeri.
36. Serbia e Madhe.
37. Shqipëria e Madhe.
38. Britania e Madhe.
39. Nëpunësi fetar kandidohet për kryetar shteti.
40. Gratë janë më paqedashëse se sa burrat.

Kohëzgjatja: 90-120 minuta



Paragjykimet për grupet etnike

Hapi i parë: pjesëmarrësit/et ndahen në grupe sipas grupit etnik. Secili grup ka për detyrë që në gazetën e murit të shkruaj atë që ka dëgjuar për grupin e tyre etnik, përkatësisht të përgjigjet në pyetjen: si janë serbët/et, kroatët/et, boshnjakët/et, shqiptarët/et, maqedonasit/et, malazezët/et, etj.?

Hapi i dytë: Pjesëmarrësit/et vendosin për njëren nga grupet etnike të cilës nuk i përkasin (grupet etnike që ofrohen janë, ata të cilave u përket të paktën një nga pjesëmarrësit e grupit). E rëndësishme është që në grupe të ketë numër përafërsisht të barabartë të pjesëmarrësve/eve. Kanë për detyrë që në gazetatat e murit të shkruajnë gjithçka që kanë dëgjuar për atë grup etnik.

Pastaj vazhdohet me prezantimet e gazetave të murit nga hapi i parë, pastaj nga hapi i dytë, pastaj vazhdohet me diskutim: si u duket kjo, si ndjeheni kur i shihni të gjitha këto? Sa ndesheni në përditshmëri me këto paragjykime? Çfarë duhet bërë me to?

Kohëzgjatja: 90 minuta



Vërejtje: Është shumë e rëndësishme që ushtrimi të udhëhiqet me kujdes dhe të jepen udhëzime të sakta. Detyra është që të shkruhet ajo që e dimë se ekziston, e jo ajo që është mendim personal. Shpesh nëpër grupe ka njerëz të cilët nuk duan të përcaktohen etnikisht, me vetë këtë edhe nuk duan të marrin pjesë në një ushtrim i cili i sjell në atë pozicion. Mes të tjerash, për këtë është e rëndësishme të qartësohet për çfarë arsye bëhet ky ushtrim. Në kontekstet tona, shpesh herë as nuk na pyesin se cilit grup etnik (ose grupi tjetër) i përkasim, thjeshtë na klasifikojnë duam ne ose jo, pa marrë parasysh a ndjehemi ne si të tillë ose jo. Atyre që nuk duan të përcaktohen etnikisht, mund t'u ofrohet të hynë në atë grup ku më së shpeshti i klasifikojnë njerëzit. E mundshme është që dikush të protestoj dhe të vendos të formoj grup të ri të cilën do ta emërtoj si “jashtëtokësor” ose “kozopolit” dhe kjo natyrisht duhet të lejohet, edhe pse largohet nga tema e dhënë. Ndonjëherë mund të ketë edhe vet censurim sepse “nuk është në rregull diçka të tillë të shkruhet për dikë”. Duhet të qartësohet se qëllimi është të detektohen paragjykimet të cilat ekzistojnë (të cilat nuk është pajetër të jenë tonat, por ato për të cilat kemi dëgjuar në rrethin tonë), dhe pastaj të mendohet se çka duhet bërë me to. Njëra nga qasjet është mohimi se ata ekzistojnë, por vështirë se duke i mohuar do të mundemi ti parandalojmë. Duhet të kemi parasysh se ky ushtrim shpesh herë ju bie rëndë njerëzve, pasi që për herë të parë janë në situatë kur para “tjetrit” duhet ti thonë paragjykimet që ekzistojnë për të. Por, nëse ushtrimi udhëhiqet me kujdes, efekti mund të jetë pikërisht ndërtimi i besimit të ndërsjellë.

Asociacionet

Udhëheqësja/si lexon nocionin, ndërsa pjesëmarrësit/et kanë njëzet sekonda që në letrat veta ngjitëse të shkruajnë asociacione për atë nocion. Pas çdo nocioni pjesa tjetër e ekipit trajnues ndihmon që letrat e shkruara të mblidhen dhe të ngjiten në letrat e mëdha derisa udhëheqësja/si lexon nocionin në vijim... Numri i nocioneve mjafton të jetë deri më dhjetë.

Shembujt e nocioneve: gazetarët, homoseksualët, feministet, politikanët, ateistët, besimtarët, policët, evropianët, amerikanët, menaxherët, OJQ-të.

Bëhet një prezantim i shkurtër i asociacioneve të shkruara, ashtu që të gjithë kanë mundësinë të lexojnë. Pastaj vijon evaluimi i ushtrimit: Si u duket kjo? A jeni të habitur me atë që keni shkruar? Sa jeni censuruar? Nga na vijnë këto asociacione, nga e kanë prejardhjen.



Vërejtje: Në vijim të këtij ushtrimi i cili duket i lehtë mund të ndodh që njerëzit të ndjehen të lënduar për diçka që është shkruar. Qëllimi i ushtrimit është që të vetëdijesohen stereotipat dhe lidhja e tyre me diskriminimin në shoqëri. Ai ofron mundësinë që, në mënyrë jo konfrontuese, brenda grupit të artikulohet ndjenja e padrejtësisë, e lidhur me stereotipat. Nga ky shkak mbledhja e nocioneve i përshtatet ndarjes së grupit dhe kombinohet me ato nocione me të cilët supozojmë se askush nuk do të identifikohet, kjo është ndjenjë e madhe e lirisë që të shprehet stereotipi ose paragjykim i rrënjësor. Duke krahasuar këto dy raste në evaluimin e ushtrimit vërehet mekanizmi të cilin e përdorim kur i zbatojmë paragjykimet.

Imazhet e armiqve

Pjesëmarrësit/et ndahen sipas shteteve/rajoneve nga vijnë.

Hapi 1: Kanë për detyrë që në gazetatat e murit të numërojnë dhe shënojnë grupet, të cilat në rrethin e tyre janë të prezantuara si armiqësore (në fëmijëri, gjatë shkollimit, me anë të mediave, në punë...).

Hapi 2: Pastaj, vendosin se do të shtjellojnë njërin nga ata grupe, dhe përshkruajnë imazhet të cilat i kanë marrë për atë grup (Si janë ata? Përse duhet të kemi frikë prej tyre, ose të kemi kujdes me to?).

Pastaj bëhet prezantimi dhe biseda në plenum. Sa janë prezente këto imazhe në shoqëri? Për çfarë shërbejnë? (imazhet e armiqve)? Kush i ndërton dhe pse?

Kohëzgjatja: 60-90 minuta

Imazhet e armiqve (2)

Ndarja bëhet në tre grupe të vogla. Pjesëmarrësit bisedojnë në lidhje me temat: Kush janë armiqitë në shoqëritë tona, kush janë “të tjerët”? Për çfarë shërbejnë ato imazhe dhe pse? Detyrë e kanë që të përgatitin gazeta të murit rreth asaj për çfarë kanë biseduar. Vijnë paraqitja e gazetave të murit në plenum, pastaj komentet dhe diskutimi.

Kohëzgjatja: 60 minuta



Mohimi

Bëhet ndarja në grupe më të vogla (ndarje e rastësishme ose sipas shteteve/rajoneve). Detyra është të diskutohet dhe të përgaditet prezantimin për temat: Çfarë mohohet në shoqëritë tona? Si? Shembujt e mohimit. Përse vjen deri tek kjo? Të tentohet që shembujt të mbulojnë të tri llojet e mohimeve: atë tekstual, fjalë për fjalë (“Nuk ka ndodhur”, psh. nuk ka pasur krim), mohimi i interpretimit (“Nuk ka qenë pikërsht ashtu”, psh. “Nuk ka qenë spastrim etnik, ata kanë ikur vetë.”) dhe mohimi i rëndësisë ose implikimeve (“Ka ndodhur, por kjo nuk ka të bëjë me mua, unë nuk mund të ndikoj në të.”)¹

Vërejtje: *Që detyra të mos jetë e rëndë, mund të shfrytëzohet inputi paraprak i shkurtër rreth mohimit. Gjithashtu, pjesëmarrësit/et mund të inspirohen përsëri me disa shembuj të vërtetë.*

Kohëzgjatja: 45- 60 minuta



¹ Këto tre llojet e të mohuarit i ka vendosur Stanley Cohen. Shiko Stanley Cohen. *Gjendja e mohimit: Të dihet për krimet dhe vuajtjet*. Përkthimi: Glisliq, S. (Beograd: Vetbotim B92, 2003), fq. 30-33.

Vështrimi tjetër

Hapi 1. Dy karrige lihen anësh dhe në to ftohen të ulen dy persona të cilët nuk janë të nacionalitetit A, por i takojnë grupit etnik “kundërshtar” B. Detyra e tyre është që të vendosen në rolin e personave të nacionalitetit A, ju thuhet të hyjnë në lëkurën e tyre dhe të përpiqen t'u përgjigjen pyetjeve në vijim:

- Me cilat probleme dhe vështirësi ballafaqohesh (për shkak të nacionalitetit tënd)?
- Cilat janë frikat e tua?
- Për cilat padrejtësi ndjen dhimbje?
- Cilat janë nevojat e tua?
- Çka shpreson?

Si përkujtim, në 4 fleta shkruhen nocionet rreth të cilave zhvillohet ushtrimi: frikat, padrejtësitë, nevojat, shpresat.

Pastaj personat të cilët janë të nacionalitetit A kanë hapësirë që të plotësojnë atë që është thënë, dhe të theksohet se nuk duhet ta përmirësojnë atë që është thënë, por të fokusohen që vetëm ta plotësojnë.

Hapi 2. Ushtrimi përsëritet, ashtu që ato dy karrige tani janë në shërbim të personave që nuk i takojnë grupit etnik “kundërshtar” B. Ata kanë për detyrë të vendosen në rolin e personave të nacionalitetit B dhe të përpiqen t'u përgjigjen pyetjeve të njëjta. Pastaj, personat të cilët janë të nacionalitetit B mund të plotësojnë atë që është thënë

Sipas nevojës, pas këtyre hapave, mund të zbatohet kthimi i ushtrimit në plenum: Si ndjeheshit? Çfarë ju la mbresë?

Vërejtje: Në qoftë se e vlerësoni se ky ushtrim nuk do të shkojë lehtë, atëherë “akulli mund të thyhet” kështu që një ditë më parë mund të shihet se a kanë interesim tek pjesëmarrësit/et më të motivuar/a që të marrin pjesë në një ushtrim të tillë dhe se a do të pranonin një gjë të tillë. Kështu, do të kenë një natë të tërë që të mendojnë dhe të përgatiten. Me rëndësi është të kemi nga dy persona nga të dy grupet etnike “kundërshtar” që do të marrin detyrën mbi vete. E rëndësishme është që gjatë fillimit të ushtrimit të jesh transparent dhe t'u thuash të gjithëve se me disa pjesëmarrës jemi marrë vesh që të provojnë të marrin rolet e caktuara, por se ka hapësirë edhe për dikë tjetër që të provojë në qoftë se shpreh dëshirë.

Në grupet që ka pasur më shumë njerëz nga vendet e ish Jugosllavisë (respektivisht në grupet ku ka pasur më së paku 5-6 grupe etnike), vendosim që të tematizojmë raportim mes dy etnive, dhe në ushtrim merreshim me psh. shqiptarët dhe serbët e Kosovës. Megjithatë, në grupet ku marrin pjesë tre grupe etnike, si psh. boshnjakët, kroatët dhe serbët, tematizojmë të tri grupet: së pari ata të cilët nuk janë kroat përpiqeshim t'i fusim në rolin e kroatit, pastaj ata të cilët nuk janë serb përpiqeshim t'i fusim në rolin e serbit, respektivisht ata të cilët nuk janë boshnjakë jemi përpiqur t'i fusim në këtë rol. Duhet të kihet parasysh se ky ushtrim zgjat shumë, she se nuk duhet të përshpejtohet. Psh. versioni me tre grupe etnike mund të zgjat më shumë se dy



orë të tëra.

Emocionalisht ushtrimi është shumë i vështirë, pasi që njerëzit vendosen në pozicion që nuk kanë qenë asnjëherë më parë, shpesh, për së pari herë mendojnë në atë mënyrë. Vet fakti se sa pak dijnë dhe sa rëndë u vjen kur duan të thonë diçka për të tjerët, nxjerr në pah një pjesë të problemit që e jetojnë. Ushtrimi është i ndërlikuar për udhëheqje dhe duhet kryer në atmosferë të qetë dhe me dëgjim të ndërsjellë, dhe nënkupton shkallë të caktuar të njohurive dhe komunikimit në grup. Futja e pauzave të shkurtra ndërmjet hapave të mbajtjes së ushtrimit është e zakonshme, për shkak të nevojës për “ajër të pastër”.

Një hap përpara

Pjesëmarrësve/eve rastësisht u shpërndahen kartela me rolet që do të kenë në këtë ushtrim. Kartelat nuk duhet t’ia tregojnë askujt. Luten që të përpiqen që sa më shumë të futen në rolin që e kanë fituar, të mendojnë rreth mënyrës së jetës dhe detyrave të përditshme si dhe problemeve me të cilat ballafaqohet ai person.

Pastaj renditen në një linjë njëri pranë tjetrit (si në linjën e startit).

Udhëheqësi/ja në zë lexon listën e situatave dhe ngjarjeve, njërën pas tjetrës. Çdo herë kur dikush prej tyre në deklaratën mund të përgjigjet me “po” duhet të bëjë një hap përpara. Pas të gjitha deklaratave të lexuara pjesëmarrësit/et shikojnë se si janë të shpërndarë nëpër dhomë e pastaj i shpallin përpara të tjerëve rolet e tyre. Pas kësaj kanë rastin edhe një herë të shohin se kush ku gjendet. Vazhdon kthimi në plenum dhe biseda rreth ushtrimit: Si kaluat ju? Sa herë jenë kthyer mbrapa? Paralele me përditshmërinë...

Kartelat me rolet:

- Ti je një nënë e papunë dhe e vetme.
- Ti je vajza e drejtorit të bankës lokale.
- Ti je myslimane që jeton me prindërit e tu të cilët janë shumë religjioz.
- Ti je një serbe e moshës mesatare e cila jeton në Prishtinë.
- Ti je një djalosh që lëviz me një karrige invalidësh.
- Ti je një rome 17 vjeçare e cila asnjëherë nuk e ka kryer shkollën fillore.
- Ti je një grua HIV pozitive.
- Ti je një arsimitar i papunësuar në shtetin ku gjuhën e re zyrtare nuk e flet rrjedhshëm.
- Ti je një kryetar i një OJQ-je me ndikim në një qytet të vogël.
- Ti je një invalid lufte që jeton nga ndihmat sociale.
- Ti je kryetar i degës rinore të partisë politike e cila është në pushtet.
- Ti je një imigrant ilegal kinez.
- Ti je vajza e ambasadorit të Amerikës në shtetin ku aktualisht jeton.
- Ti je pronar i një kompanie të suksesshme për eksport-import.
- Ti je një pensionist.
- Ti je një homoseksual 22 vjeçar.
- Ti je udhëheqëse e televizionit më të shikuar.
- Ti je i pastrehë.
- Ti je një 19 vjeçar nga një fshat i largët malor.
- Ti je një maqedonase që 11 vjet jeton në qendër për të zhvendosurit.

Deklaratat që janë të lexuara:

1. Asnjëherë nuk je ballafaquar me ndonjë vështirësi financiare serioze.
2. Ke një shtëpi të mirë me linje telefonike dhe kabllovike.
3. Ndjen se gjuha, feja dhe kultura jote respektohen në shoqërinë ku jeton.
4. Ndjen se mendimi yt për çështjet sociale dhe politike është i rëndësishëm dhe se qëndrimet e tua dëgjohen.
5. Personat tjerë konsultohen me ty për çështje të ndryshme.
6. Nuk ke frikë se do të të ndal policia.
7. E di se kujt duhet t'i drejtohesh nëse ke nevojë për këshillë dhe ndihmë.
8. Asnjëherë nuk ke ndje diskriminim për shkak të origjinës tënde.
9. Ke mbrojtje adekuate sociale dhe shëndetësore sipas

Vërejtje: *ky ushtrim është shumë i mirë si nxitje për të menduar ekzistimin e pabarazive shoqërore, mundësive të ndryshme dhe pasojave që mund t'i ketë gjatë jetës personat që i takojnë ndonjëris prej grupeve pakicë dhe/ose të rrezikuara. (duhet të kihet parasysh që në mesin e kartelave numri më i madh i roleve për pjesëmarrësit/et të jenë nga grupet e rrezikuara dhe të pa privilegjuara). Ky ushtrim me anë të përjetimit të imazheve afon nocionet e dhunës strukturore dhe kulturore dhe u jep mundësinë pjesëmarrësve/eve të hyjnë në "lëkurën e tjetrit/ës". Shërben për të nxjerr në pah pozicionet e pabarabarta startuese që personat i kanë shoqëri dhe se sa vështirë është t'i tejkalojnë kur janë të pafavorshme. Ky ushtrim mund të shërbejë si bazë për shqyrtimin e stereotipave dhe paragjytimeve.*

nevojave tua.

10. Mund të shkosh në pushim një herë në vit.
11. Mund të thërrasësh shokët në shtëpi për darkë.
12. Ke një jetë interesante dhe je pozitiv/e ndaj ardhmërisë tënde.
13. Mund të studiosh dhe të zgjedhësh profesionin sipas dëshirës.
14. Nuk ke frikë se do të jesh i shqetësuar ose i sulmuar në rrugë ose nga mediat.
15. Mund të votosh në zgjedhjet parlamentare dhe lokale.
16. Mund të festosh festat e tua kryesore fetare me familjen dhe shoqërinë.
17. Mund të marrësh pjesë në ndonjë seminar ndërkombëtar jashtë vendit.
18. Mund të shkosh në kinema ose në teatër minimum një herë gjatë javës.
19. Nuk ke frikë për ardhmërinë e fëmijëve të tu.
20. Mund të blesh tesha të reja minimum një herë në tre muaj.
21. Mund të dashurosh kë të duash.
22. Ndjen se aftësitë e tua në shoqërinë ku jeton vlerësohen dhe respektohen.
23. Mund të përdorësh internetin.

Kohëzgjatja: 45 - 60 minuta

Katorrët/pikat e vogla

Çdonjërit/ës pjesëmarrës/e i ngjitet një katorr me ngjyrë në ballë, kështu që ai/ajo nuk e sheh se çfarë i është ngjitur. Për shembull, shtatë persona kanë marrë katorrë të kuq, pesë persona – të kaltër, dy persona – të verdhë, një person merr të zi dhe një person të bardhë. Gjithashtu, disa mund të marrin edhe kombinime të ngjyrave, për shembull, një person mund të merr katorr të kaltër dhe të kuq, ndërsa personi tjetër të verdhë dhe të kuq.

Udhëzimi: Shpërndahuni nëpër grupe sipas ngjyrës, pa asnjë komunikim verbal.

Evalrimi i ushtrimit: Çfarë ndodhi?

Kohëzgjatja: 45 minuta

Vërejtje: Ushtrimi simulon imponimin e identiteteve dhe klasifikimin/grupimin sipas kriterit të imponuar, që është rast i shpeshtë në shoqëritë tona me diskriminim etnik, gjinor dhe lloje të ndryshme të diskriminimeve. Pjesëmarrësit/et shpesh herë, nisen prej asaj se duhet ta zgjidhin detyrën sipas mënyrës së parë logjike, andaj klasifikohen vetëm në bazë të letrës (gjegjësisht sipas ngjyrës së pikave/katorrëve) të cilat kanë marrë. Të njohurit, apo dalja në pah e mekanizmave të cilave ju nënshtrohen, dijnë të jenë të dhimbshme kur njerëzit e shohin veten në rolin e të diskriminuarve dhe atë të diskriminuesit/es. E rëndësishme është që të jepen udhëzime precize, dhe të mos ndikohet gjatë klasifikimit/grupimit të pjesëmarrësit/et, që mos të vijë deri te pika udhëheqësi/ja të jetë në rolin e manipuluesit/es.

Ishulli

Pjesëmarrësit/et ndahen në tre grupe të vogla. U thuhet se gjenden në një ishull të shkretë dhe se nuk ka mënyrë që të largohen nga ai. Për shkak të organizimit të jetës së përbashkët duhet të merren vesh dhe të vendosin sistem të përbashkët të rregullave të cilat do t'ua kishin lehtësuar jetën në ishull. Secili grup i vogël ka 10 minuta për të bërë atë marrëveshje dhe ta shkruaj në një letër të madhe. Pastaj vijon kthimi i shkurtër në plenum, ku secili grup veç e veç, prezanton rregullat e veta.

Në hapin e radhës lutet që nga një person nga secili grup të bëhet vullnetarë. Vullnetarët dalin jashtë nga dhoma dhe u thuhet se nuk do të kthehen në atë grup prej së cilit janë larguar, por do të futen në një grup tjetër, ndërsa detyra e tyre është që të sillen në kundërshtim me rregullat e jetës në atë ishull, gjegjësisht të mundohen që të ndryshojnë sa më shumë rregulla nga marrëveshja e bërë më parë.

Pas qëndrimit 10 minutësh të “personave të rinj” në ishull ushtrimi mbaron dhe bëhet evaluimi.

Pyetjet për evaluim: Çfarë ndodhi? (së pari pjesëmarrësit/et që nuk e kanë ndërruar ishullin, pastaj ata me detyrat speciale). Si janë ndjerë ata që kanë ardhur në rolin e shkelësit të rregullave, e si ata të cilët kanë qëndruar aty kur ka ndodhur mosrespektimi i sistemit të tyre? Kush ka qenë në rolin e viktimës, ndërsa kush në rolin e dhunuesit? Çfarë lidhje ka kjo me jetën e përditshme?

Kohëzgjatja: 60-90 minuta

Autobusi

Stimulim i shkurtër i skenës në një autobus. Katër vullnetarë/e kanë të ngjitur nga një letër të vogël me rol të caktuar: rome me një fëmijë të vogël; djalosh në fanellën e të cilit shkruan “Gay is OK”; fshatare që është nisur për në treg; një grua e mbuluar të cilës i duken vetën sytë. Por, edhe gjashtë “udhëtarë” të tjerë marrin pjesë në këtë skenë, ndërsa detyra është që ndaj të “etiketuarve” të sillen pa censurë ashtu siç e shohin se shoqëria sillet ndaj tyre.

Pastaj vijon evaluimi i ushtrimit: Çfarë kanë vërejtur vëzhguesit/et e skenës? Çfarë kanë dashur të tregojnë pjesëmarrësit/et në skenë?

Hartimi/Mapimi i patriarkatit dhe militarizmit në shoqëritë tona

Ushtrimi udhëhiqet me pjesëmarrësit/et të ndarë në dy grupe. Njëri grup bën gazetë muri me temë hartimi/mapimi i patriarkatit, ndërsa grupi tjetër hartimin/mapimin e militarizmit në shoqëritë tona. Duhet të mbledhin sa më shumë shembuj se ku dhe në çfarë mënyre ekzistojnë këto dy fenomene në shoqëri, kush i mbështet, cilat janë format dhe trajtat e tyre, etj. Vijnë prezantime të shkurtra, eventualisht me pyetje për sqarim. Pastaj biseda në plenum: Cilat janë ngjashmëritë mes patriarkatit dhe militarizmit? Ku gërshetohen ata?

Kohëzgjatja: 60-90 minuta



Komuniteti im

Çdonjërit në grup i jepet një letër e madhe, shënues, stilografë etj. Dhe u thuhet se kanë nga gjysmë ore për përgatitjen e prezantimit i cili do të përshkruajë atë që ata e konsiderojnë si komunitet/bashkësi të vet/en. Secili/a, për një kohë të caktuar, prezanton gjithë atë që ka përgatitur.

Më tej mund të bëhen edhe variante të ndryshme: përvojat në lidhje me përkatësinë time në grupin e caktuar, përvojat në lidhje me zhvillimin e atij komuniteti/bashkësie etj.



Ushtrimet për shtjellimin e temës
“ndërtimi i paqes”

Qëllimet e këtij grupi të ushtrimeve:

Qëllimet e këtij grupi të ushtrimeve janë të numërta dhe të shumëllojshme, dhe duke pasur parasysh se rrallë herë ndodh të kemi të dispozicion kohë mjaftueshme që të shtjellojmë të gjitha nën temat e nevojshme, shumë e rëndësishme është që të vlerësojmë prioritetet: çfarë është më e rëndësishme që duhet të mbulohet në një grup të caktuar të pjesëmarrësve/eve dhe cilat nevoja duhet përmbushur. Vlerësimi i mirë i prioritetëve bazohet në të njohurit e mirë të specifikës të grupit të pjesëmarrësve, njohuritë nga dy seritë e mëparshme të ushtrimeve, përvojën e ekipit trajnues dhe njohuritë e tyre të rrethanave shoqërore-politike në të gjithë rajonin. Ndërsa në mesin e këtyre qëllimeve të numërta janë:

- Të kuptuarit më të mirë të nocioneve relevante themelore për ndërtimin e paqes;
- Planifikimi se çfarë nënkupton ndërtimi i paqes, por edhe vetëdijesimi se sa çdokush prej nesh në përditshmëri punon në ndërtimin e paqes, dhe nëse nuk emërtohet si e tillë;
- Forcimi dhe inspirimi i pjesëmarrësve/eve për pjesëmarrje më aktive në jetën qytetare dhe marrja më e madhe e përgjegjësisë për proceset shoqërore;
- Shkëmbimi i përvojave, njohja me praktikatat e mira, por edhe të mësuarit nga gabimet që i kemi bërë vet ose që i kanë bërë të tjerët;
- Zhvillimi i kulturës kritike (dhe vet kritike);
- Zhvillimi i kulturës së dialogut me ata që nuk kanë të njëjtin mendim;
- Promovimi i padhunshmërisë.

Metodologjia që përdorim gjatë shtjellimit të temës “ndërtimi i paqes”:

Përdoren metodat e zakonshme të punësive. Për këtë grup ushtrimesh është e rëndësishme puna në plenum e cila është kryesisht informative dhe frymëzuese. Mirëpo, shumë e rëndësishme është që në masë më të madhe të jetë e përfaqësuar puna në grupet më të vogla, për shkak të hapësirës së nevojshme për shkëmbim, reflektim, shqyrtim dhe analizë, ngaqë këto procese janë më frytdhënëse kur punojnë së bashku një numër më i vogël i njerëzve. Nuk duhet harruar se e rëndësishme është që të sigurojmë një vend për vetëreflektim dhe për të menduarit, në qetësi.

Lumi i paqes

Të gjithë në grup në letra me ngjyra të ndryshme (stikera) shkruajnë definicionet e veta për paqen. Pastaj secili/a lexon se çfarë ka shkruar, dhe të gjitha letrat lëshohen në dysHEME në mes të dhomës.

Kohëzgjatja: 30 minuta



Kontributi im për ndërtimin e paqes/pajtimin

Të gjithë me radhë, në grup duhet të paraqesin diçka që e shohin si kontribut të tyre për ndërtimin e paqes/pajtimin që secili/a e ka bërë.

Kohëzgjatja: 30-45 minuta

Çfarë mund të bëjmë (“Situatat”)

Lexohet një situatë jetësore (e cila thjeshtë kërkon reaksion) dhe parashtrohet pyetja: Çfarë bëni? Pastaj pjesëmarrësit japin idetë e tyre rreth reaksionit. Qëllimi nuk është që të përcaktojmë reaksionin më të përshtatshëm ose më të mirë, por të mbledhim një spektër të reaksioneve të mundshme që të inspirojmë njëri-tjetrin se çfarë mund të bëjmë në situatat e caktuara.

Disa nga idetë për situatat:

- Je kthyer nga seminari në të cilin kanë marrë pjesë njerëz nga ish Jugosllavia. Takohesh me disa të njohur të cilët të pyesin se si ke kaluar atje. Njëri prej tyre komenton: “Përsëri je shoqëruar me Šiptari?!” Çfarë bën?
- Je në një mbledhje familjare, një nacionale. Aty gjendet edhe një person i nacionalitetit tjetër. Njëri nga anëtarët e familjes e provokon atë person duke i bërë shaka të papërshtatshme (psh. “Ku je Šokice?”) Vëren se personi nuk ndjehet mirë. Çfarë bën?
- Në një festë familjare një kushëri thotë se “të gjithë serbët janë larguar nga Kosova me vet dëshirë”. Çfarë bën?
- Në ndërtesën pranë është paraqitur një grafit “kroatët në rezervatë”. (Ose: “serbët në shelgje”; “boshnjakët nëpër zinxhirë” etj.) Çfarë duhet bërë?
- Në punë një kolegë ankohet: “Shiko këto shqiptarët, të gjitha të drejtat ua kemi dhënë, shiko çfarë na bëjnë...” Çfarë bën?
- Gjendesh në ndonjë konferencë paqësore. Përfaqësuesi i shoqatës së familjeve të të humburve thotë se vetëm viktimat kanë të drejtë të punojnë në ndërtimin e paqes. Çfarë bën?
- Ndodhesh në taksì. Kur e merr vesh taksisti se je nga Bosnja të pyet: “Pash Zotin si i përballoni myslimanët?!” Çfarë bën?
- Shokun tënd e largojnë nga puna për shkak të orientimi të tij seksual. Çfarë bën?
- Në lagjen tënde është planifikuar të ndërtohen objekte banuese për romët. Njëri nga fqinjët të ofron të nënshkruash petition kundër këtij ndërtimi. Çfarë bën?

Kohëzgjatja: deri më 60 minuta

Vërejtje: *Ushtrimi është i mirë si një nga ushtrimet hyrëse për temën e ndërtimit të paqes dhe aktivizmit paqësor, pasi që mund të na përkujtojë se me aktivizëm paqësor mund dhe duhet të merremi të gjithë dhe çdo ditë – edhe kur nuk kemi kushte logjistike ideale por edhe kur nuk kemi mbështetje materiale në formë të donacioneve dhe resurseve. E rëndësishme është të zgjedhim/formulojmë situata që janë të përafërta dhe reale me pjesëmarrësit e punëtorive. Duhet tematizuar 4-5 situata. Për situatat e para nevojiten 10-15 minuta për çdo situatë, ndërsa të tjerat kalohen më shpejt. Rekomandohet që ushtrimi të mos zgjasë më tepër se 60 minuta pasi që njerëzit lodhen nga dinamika e njëtrajtshme, nga të dëgjuarit dhe nga të ndenjurit në një vend.*

Situatat 2 (versioni për trajnimin me veteranë)

Ushtrimi funksionon njëjtë si ushtrimi i mëparshëm, dallon ajo se ky version i ushtrimit është e krijuar për grupin e veteranëve të luftës.

- Merrni ftesë nga shoqata e ushtarëve të Armatës së BdhëH që ju si grup bashkërisht të vini në komemorimin e përvjetorit në Srebrenicë. Çfarë bëni?
- Shoqata e familjeve të të vrarëve në “Kolonën e Tuzllës” ju fton në shënimin e vuajtjeve në Bërçkanska Malltë. Çfarë bëni?
- Është planifikuar një vizitë e përbashkët e vendeve të luftimeve në Sllavoninë Lindore. Shoqata vendase e mbrojtësve kërcënohet nga shoqatat tjera të mbrojtësve dhe ua dërgon këtë informatë një ditë përpara takimit. Çfarë bëni?
- Një parti politike publikisht vendos punën tuaj si meritë të tyre dhe merr qëndrimin se kjo është vërtetim i programit të tyre politik duke konstatuar: “Kjo është dëshmi se entitetet duhet shfuqizuar!” Çfarë bëni?
- Planifikoni një tubim për veteranë nga rajoni në hotelin Villina Vllas në Vishegrad. Për gjithçka është rënë dakord, por disa ditë para fillimit merrni një informatë të besueshme nga një



Organizatë Joqeveritare se gjatë luftës në atë hotel, është organizuar një logor për gra dhe se aty shumë gra janë përdhunuar. Çfarë bëni?

- Përfaqësuesi i shoqatës së familjeve të viktimave kërkon nga ju që t'i mundësoni t'u drejtohet luftëtarëve të palës tjetër që u vijnë në vizitë. Çfarë bëni?
- Planifikoni mbledhje që t'u drejtoheni mediave. Merrni vesh se njëri nga mysafirët e mbledhjes nga grupi juaj është i akuzuar për krim lufte. Çfarë bëni?
- Bashkërisht vizitoni dhomën përkujtimore të HVO (OUK – Organizata Ushtarake Kroate) dhe aty mes tjerash shikoni edhe fotografitë e Tugjmanit dhe Paveliqit. Çfarë bëni?
- Gjatë vizitës së vendeve të luftimeve në një qytet të vogël në mbledhjen e planifikuar me autoritetet lokale paraqitet ndihmës shefi i komunës i cili para disa muajve është kthyer nga vuajtja e dënimit, ndërsa ka qenë i dënuar për krim lufte. Çfarë bëni?
- Shoqata HVIDR (VILA – Veteranët Invalidë të Luftës Atdhetare) nga Zhupanja do t'u ishin kyçur aksioneve të cilat planifikoni të bëni, në qoftë se shoqata e luftëtarëve nga Serbia nga emërtimi i tyre largojnë emërtimin “çlirues”. Çfarë bëni?

Pastaj në plenum bëhet shqyrtimi i të gjitha këtyre situatave.

Barometri i madh: “Është ndërtim paqeje” – “Nuk është ndërtim paqeje”

Metoda “Barometri i madh” është përshkruar në faqen 55.

Dukuritë shoqërore për barometrin:

1. Kthimi i refugjatëve në shtëpitë e tyre
2. Më mirë tanket e KFOR-it sesa policët serb
3. Institucionet fetare kanë ndikuar në zhvillimin e paqes në Ballkan
4. Institucionet fetare
5. Theksimi i identitetit nacional
6. Dënimi me vdekje
7. Bombardimi i NATO-s ndaj Serbisë dhe Malit të Zi
8. Gjykata e Hagës
9. KFOR-i
10. Feminizmi
11. Shërbimi civil në vend të shërbimit ushtarak
12. Gjykimi i kriminelëve të luftës në shtetet e tyre
13. Aborti

14. Legalizimi i drogave të lehta
15. Censurimi i mediave
16. Martesat mes personave Gay/Lezbike
17. Adoptimi i fëmijëve nga çitet Gay/Lezbike
18. Aktivizmi paqësor
19. 51% gra në politikë
20. Armatosja për qëllime mbrojtëse
21. Organizatat ndërkombëtare
22. Patriotizmi
23. Ndihma humanitare
24. Marrëveshja e Dejtonit
25. Privatizimi – hapi drejt Evropës
26. Pilotja, psikologja, gjykatësja, kryetarja, xehtarja, ministrja, bravëndeçësja, prefektja...
27. Futja e edukimit fetar nëpër shkolla
28. Ndërtimi i Ferhadisë në Banja Llukë
29. Flamuri shtetëror në maje të kishës
30. Standardi më i mirë
31. Diskriminimi pozitiv
32. Organizatat joqeveritare – OJQ
33. Globalizimi
34. Tradita
35. Kinezët
36. Amerikanët
37. Barabarësia e grave në ushtri

Kohëzgjatja: 60-90 minuta

Çfarë kontribuon për ndërtimin e paqes

Pjesëmarrësit/et luten që lexueshëm dhe me shkronja të mëdha në tre fletë të shkruajnë nga tri gjëra që i shohin në shoqëritë e tyre, të cilat mendojnë se kontribuojnë në ndërtimin e paqes. Të gjitha fletët shpërndahen në tokë, dhe pastaj vijon diskutimi në plenum lidhur me temën: Si e komentojmë këtë që është shkruar, cilat janë prioritetet, dhe cilat janë gjërat që sipas mendimit tuaj aspak nuk kontribuojnë në ndërtimin paqes?

Kohëzgjatja: 60-90 minuta

Variacioni: fletët e shkruara mund të shfrytëzohen për Barometrin e madh (shih sqarimin e ushtrimit paraprak) në vend të dukurive të përgatitura paraprakisht nga ana e ekipit trajnues.

Çfarë na tregon se (nuk) jetojmë në paqe?

Në plenum punohet një gazetë muri me temë: Çfarë na tregon se jetojmë në paqe?

Pastaj gazetat e reja e murit me temën: Çfarë na tregon se nuk jetojmë në paqe?

Kohëzgjatja: 20 minuta

Çfarë mund të shkaktojë ndonjë luftë të radhës?

Punohen gazeta të murit në temën: Çfarë mund të na shpjerë deri tek ndonjë luftë e radhës?

Pastaj bëhet bisedë rreth asaj se si të zvogëlojmë ato mundësi.

Vërejtje: Ushtrimi ofron mundësinë që të vijë deri tek shkëmbimi i të kuptuarit të shkaqeve të luftës dhe të detektohen rrënjët e padrejtësive të cilat në një kohë afatgjate mund të eskalojnë në dhunë.

Prioritetet e ndërtimit të paqes nëpër rajonet dhe shtetet?

Pjesëmarrësit/et ndahen sipas rajoneve nga të cilat vijnë dhe duhet të definojnë prioritetet e ndërtimit të paqes në ato rajone.

Vijon prezantimi dhe shqyrtimi në plenum.

Cilat janë sfidat në ndërtimin e paqes?

Punohet në grupe më të vogla. Bëhet bisedë dhe kryhen prezantime lidhur me temën: Cilat janë sfidat në ndërtimin e paqes? Pastaj vijon prezantimi dhe shkëmbimi në plenum.

Alternativat

Hapi 1. Brainstorming në plenum: Si do të kishit përshkruar gjendjen në shoqëritë tuaja? Pastaj shënojmë ato shënime që përshkruajnë atë me të cilën nuk jemi të kënaqur në shoqëritë tona.

Hapi 2. Bisedë në plenum: Cila është alternativa (për atë me të cilën nuk jemi të kënaqur në shoqërinë tonë)? Çfarë na ofrojnë si alternativë aktivistët/et paqësor/e? Udhëheqësi/ja shkruan alternativat në tabelë/gazetën e murit, duke parashtruar pyetje për sqarim. Qëllimi është që të gjejmë sa më shumë alternativa.

Ndërtimi i paqes dhe unë

Çdokush për vete mendon rreth çështjeve në vijim: Gjërat që më së shumti më bëjnë konfuz dhe që më iritojnë në lidhje me ndërtimin e paqes. Çfarë nuk e kam të qartë në lidhje me atë proces? Çka është më të rëndësishme për mua në ndërtimin e paqes? Cilat frika dhe dilema i kam në lidhje me të? Në fletët e mëdha që ndodhen në tokë pjesëmarrësit/et shkruajnë mendimet dhe përgjigjet e tyre lidhur me temat e radhës, ndërsa në raport me punën në ndërtimin e paqes: “Më nervozon...”, “Më bën konfuz...”, “Më sfidon...”, “A merrem vallë me...”, “Frikat e mia...”, “Më kryesore për mua është...”

Pasi që të gjithë kanë shkruar atë që kanë menduar në fletën që ndodhet në tokë, hapet diskutimi lidhur me këtë temë: Çfarë na ka lënë mbresë më të madhe nga ajo që është shkruar, çfarë do të dëshironim të komentojmë në plenum?




Treshet rrotulluese rreth aktivizmit paqësor


Nga tre karrige janë të grupuara dhe të vendosura ashtu që të bëjnë qark (shiko fotografinë). Pjesëmarrësit/et të cilët e formojnë grupin/treshen (ulen në tri karrige në grup) dhe caktojnë se kush është personi A, B dhe C. Detyra është që të tjerëve në grupin e vogël t'u përgjigjen në pyetjen e dhënë. Pas përfundimit të kohës, vjen deri tek ndryshimi i vendit: personat A zhvendosen për një vend në të majtë, ndërsa personat B zhvendosen për një vend në të djathtë, me ç'rast formohen treshë të reja për bisedë. Para çdo pyetje të re të parashtruar vjen deri tek këto rotacione.

Pyetjet e mundshme:

- Si do t'i'a kishim paraqitur fqinjit tonë punën tonë në organizatën tonë (dikujt që nuk di asgjë rreth kësaj)?
- Cili është motivimi im për të punuar atë që e punoj?
- Si ndikon kjo që punoj në ndryshimet shoqërore?

Kohëzgjatja: 30 minuta





Si e kuptoj ndërtimin e paqes?

Ndarja në grupe të vogla. Biseda dhe përgatitja e prezantimit në bazë të pyetjeve:

- Çfarë është për mua ndërtimi i paqes?
 - Vlerat të cilat i ndërlidhim me ndërtimin e paqes.
 - Shkaqet se përse ndërtimi i paqes është relevant/i nevojshëm për mjedisin në të cilin jetoj.
 - Kush janë aktorët/aleatët?
- Vijojnë prezantimet në plenum.

Përse pajtim?

Pjesëmarrësit/et duhet të mendojnë se janë në situatë që t'i sqarojnë dikujt se për çfarë na duhet pajtimi, gjegjësisht të gjejnë argumente të mjaftueshme. Një person i ekipit trajnues merr një qëndrim skeptik në lidhje me pajtimin dhe kërkon që çdo argument t'i sqarohet mirë deri sa nuk i bëhet plotësisht i qartë dhe i pranueshëm. Ata argumente shkruhen në gazetën e murit/në tabelë.

Kohëzgjatja: 20-25 minuta

Kush me kë/me çfarë duhet të pajtohet?

Në tokë gjenden fletë të mëdha (në numër të mjaftueshëm që një numër i madh i pjesëmarrësve të mund njëkohësisht të shkruajnë në to). Pjesëmarrësit/et, në qetësi, shkruajnë përgjigjet e tyre në pyetjen: Kush me kë/me çfarë duhet të pajtohet? Pasi që kanë përfunduar, kemi mundësinë të shohim gjithçka që është shkruar. Vazhdon shqyrtimi në plenum.

Kohëzgjatja: 30-45 minuta



Puna në mjediset lokale

Hapi 1. Tre pjesëmarrës nga komunitetet e ndryshme paraprakisht (disa ditë përpara) kanë marrë për detyrë që të përgatisin prezantimin me të cilin do të njoftojnë më mirë të tjerët me situatat në mjediset e tyre (relevante për punë në ndërtimin e paqes). Me këtë rast prezantojnë atë që kanë përgatitur, ndërsa të tjerët kanë hapësirë që të parashtrajnë pyetje për sqarim.

Hapi 2. Pjesëmarrësit/et zgjedhin njërën nga prezantimet e mëparshme të mjedisëve. Kështu formohen tre grupe punuese (do të ishte mirë që të ketë përafërsisht numër të njëjtë të pjesëmarrësve/eve në çdo grup). Duhet të imagjinojnë se jetojnë në atë rreth. Kanë për detyrë të zgjedhin një problem konkret relevant për punë në ndërtimin e paqes dhe të përpunojnë qasje ndaj atij problemi. Çdo grup merr nga një letër me detyrë dhe një sërë pyetjesh të cilat mund t'ua lehtësojnë punën:

“Detyra juaj është që të caktoni problemin në të cilin do të fokusoheni dhe të përpunoni qasjen ndaj atij problemi

Pyetjet ndihmëse:

1. Si vendosni për atë problem? (Përse pikërisht ai?)
2. Cilat janë qëllimet e juaja
3. Definoni principet e veprimit tuaj
4. Cilat janë anët tuaja të forta/dobëta? Cilat kapacitete ju mungojnë?
5. Cilat resurse përdorni që të njihni më mirë mjedisin?
6. Me kë mendoni se është mirë të bëni bashkëpunim? Në cilën mënyrë e bëni këtë? (Cilët janë aleatët tuaj potencial?)
7. Si dëshironi që mjedisi t'u përjetojë? (Çfarë imazhi doni të keni?)
8. Cilat janë efektet e mundshme të padëshirueshme?
9. Cilat aktivitete konkretisht do të mund t'i kishit kryer? Përse pikërisht ato?
10. Tre pyetjet që janë të rëndësishme e që nuk janë në këtë listë.”

Hapi 3. Pas përfundimit të punës në grupe, një nga një grupet ulen në “karrigen e nxehtë”, prezantojnë se çfarë kanë bërë. Ndërsa të tjerët kanë hapësirë të parashtrojnë pyetje dhe të kritikojnë.

Hapi 4. Të gjithë kanë mundësi për të menduar dhe për të shkruar në letrat vetë ngjitëse: Çfarë ishte e vështirë për ju në këtë detyrë? Cilat janë dilemat që keni? Pyetjet që u kanë mbetur të hapura. Pastaj vijon një bisedë e shkurtër në plenum.

Hapi 5. Gazetat e murit. Çfarë pikëpamjesh të reja keni fituar për punën në mjedisin lokal? Përpunimi i gazetave e murit në plenum

Kohëzgjatja: 2-3 blloqe pune.

Kriteret për aktivistët/et (Ishulli “Dub”)

Hapi 1. Ndarja në tre grupe. Detyra është që pjesëmarrësit/et të caktojnë cilat kriteret duhet të përmbushin dhe çfarë kualitetesh duhet të kenë njerëzit që merren me ndërtimin e paqes dhe t'i shkruajnë në fletë të madhe. Pastaj vijojnë prezantimet e shkurtra në plenum.

Hapi 2. Më pas nga grupet dalin 1, 2 dhe 3 vullnetarë/e. Në grupin nga i cili janë larguar tre persona vijnë tre persona të ri me detyrë speciale që të përpiqen të ndryshojnë diçka nga kriteret, ndërsa në grupin nga i cili është larguar një person, në vend të tij vjen një person i ri me detyrën e njëjtë. Në grupin e tretë vijnë dy persona prej të cilëve njëri është “kundër” ndërsa tjetri “për” kriteret e shënuara.

Vërejtje: Ky ushtrim është i mirë kur është e nevojshme të punohet rreth punës në grup dhe konfliktit, në duke tematizuar njëkohësisht punën në ndërtimin e paqes.

Renditja evaluimit në radhë nëpër grupe mundëson punë më të fokusuar në raport me

Evaluumi (fokusi është te procesi, për përmbajtjen në ushtrimin e radhës): Çfarë ndodhi?

Kohëzgjatja: 60-90 minuta



variantin e evaluimit kur me radhë ndërrohen pyetjet. Renditje interesante është kur fillohet nga grupi në të cilin ka ardhur një person i ri. Së pari anëtarët/et e atij grupi pyesin që t'u tregojnë të gjithëve atë që ka ndodhur, ndërsa pastaj "personit të ri" i jepet hapësirë që të tregojë se çfarë ka ndodhur dhe si është ndjerë ai/ajo. Atë e lusin që të tregojë se çfarë ka qenë roli i tij/saj, gjegjësisht çfarë detyre speciale i është dhënë. Gjithsesi pyetje e rëndësishme është edhe ajo se sa kritere është munduar të ndryshojë. Pas evaluimit të atij grupi, mund të kalohet në evaluimin e grupit në cilin kanë ardhur 3 persona. A ekziston dallimi në dinamikë ndërmjet grupit të parë dhe të dytë? Pse është ashtu? Në fund duhet bërë evaluimin e grupit në të cilin kanë ardhur 2 persona të ri, por me detyra të ndryshme. A janë perceptuar dhe trajtuar ndryshëm nga ana e anëtarëve/eve të grupeve tjera? Përse? Në qoftë se kjo gjë nuk është nënvizuar gjatë evaluimit, në fund do të bëjmë një shqyrtim rreth paraleleve me jetën e përditshme.

Pritshmëritë nga aktivistët/et paqësor/e

Mund të punohet lidhur me ushtrimin *kriteret për aktivistët/et* (Ishulli "Dub") ose pavarësisht nga ai

Versioni 1: Fletat me kriteret e aktivistëve/eve paqësor/e nga ushtrimi i kaluar vendosen në një vend të dukshëm. Vazhdon biseda në plenum: Cilat janë pritshmëritë reale nga një person që merret me ndërtimin e paqes? Cilët kritere ju personalisht i përmbushni? Për çfarë mund të them se nuk e posedoj ose që nuk dua të posedoj?

Vërejtje: Shumë shpesh pritshmëritë ndaj aktivistëve/eve paqësor/e janë të tepërta, ndërsa kriteret e ndërtuara paraprake duken sikur të jenë të krijuara për super njerëz, të përkryer dhe të pagabueshëm, kështu që në të vërtetë askush nuk do të merrej

Versioni 2: Pas ushtrimit *Kriteret për aktivistët/et (Ishulli “Dub”)* në fletë të veçanta shkruhen kriteret për aktivistët/et të cilët janë shfaqur (një kriter në një letër). Udhëheqësit/et eventualisht marrin disa që mendojnë se janë të rëndësishme për tu diskutuar. Pjesëmarrësit/et marrin nga një ose disa fletë-nocione dhe i vendosin në barometrin me polet “pritshmëri të tepërta” dhe “pritshmëri reale”. Pastaj vazhdon diskutimi: A do të kishte ndryshuar dikush pozitën e ndonjë nocioni në barometër? Përse? (Më shumë informata rreth metodës Barometri i madh shikoni në fq. 41).

Versioni 3: Punohet pavarësisht nga ushtrimi *Kriteret për aktivistët/et (Ishulli “Dub”)*. Detyra është që çdokush për vete të shkruajë në disa fletë kriteret të cilat duhet të përmbushin aktivistët/et paqësor/e (një kriter në një fletë letre). Pastaj ushtrimi punohet njëjtë si Versioni 2.]

me ndërtimin e paqes pasi që nuk mund të përmbush të gjitha këto kriteret. Këtu me rëndësi është që të forcojmë njerëzit dhe t'u jepet këtyre “paqësorëve” pamje njeriu, me të meta dhe me gabime, pikërisht të ndërtojmë imazhin që të gjithë të mund të punojnë në ndërtimin e paqes, kur të duan.

Barometri i madh: Çka është/nuk është etike?

Janë ekspozuar fletë me njërën nga situatat/qasjet e shënuara më poshtë (ekzistojnë nga dy kopje të së njëjtës situatë). Çdo pjesëmarrës/e merr nga një nga fletët me situatën e shënuar dhe e vendos në barometrin me polet “Është etike” dhe “Nuk është etike”. Pasi të jenë vendosur të gjitha fletët, vijon diskutimi: A do ta kishte ndryshuar dikush pozitën e ndonjë situatë në barometër, përse, si e shohin këtë të tjerët...

Situatat/qasjet:

1. Krijimi i programit sipas udhëzimeve të donatorit.
2. Anashkalimi i vështirësive dhe problemeve në raportet për aktivitetet.
3. Të jetosh nga puna e ndërtimit të paqes.
4. Bashkëpunimi me yjet e muzikës popullore për promovimin e ideve tona.
5. Kritika publike për OJQ-ët e tjera.
6. Bashkëpunimi me shoqatat e veteranëve të luftës.
7. Pagesa e mëditjeve të pjesëmarrësve/eve në trajnim për ndërtimin e paqes.
8. Organizimi i seminarit për të rinj në hotelin më të shtrenjtë në shtet.
9. Copyright në ndërtimin e paqes.

Situatat me vështirësi në punë

Bëhet ndarja në tre grupe. Çdo grup i vogël merr dy (nga tre situatat e shkruara më poshtë) situata të cilat duhet t'i shqyrtojnë dhe të përgjigjen në pyetjet: Si reagoni dhe si pozicionoheni në atë situatë? Cilat pyetje dhe dilema i keni?

Pas kësaj, grupet paraqesin qasjet për të cilat kanë vendosur dhe vijon një diskutim i shkurtër.

Situata 1: Ju ftojnë që të merrni pjesë në një televizion nacional të shtetit fqinj. Tema e emisionit është procesi i pajtimit në rajonin e ish Jugosllavisë. Pranoni ftesën, dhe nga redaksioni i emisionit merrni sugjerim që gjatë emisionit të fokusoheni vetëm në kritikën ndaj shtetit tuaj.

Situata 2: Jeni partner lokal i QAP në organizimin e prezantimit publik të punës paqësore me veteranët e luftës. Jeni duke përgatitur tribunë në vendin tuaj. Disa ditë para mbajtjes së tribunës u paraqitet shoqata e viktimave të luftës me një kërkesë të qartë që t'i përfshini në mesin e folësve në tribunë.

Situata 3: Partnerët shumëvjeçar nga jashtë ju ftojnë që të jeni pjesë e një projekti të madh ndërkombëtar (me organizata nga Gjermania, Palestina, Maqedonia, Serbia dhe B dhe H). Projekti për to është i rëndësishëm, veçanërisht për shkak të parave dhe për mbijetesën e organizatës së tyre në të ardhmen. Dyshoni në realizimin e këtij projekti, mirëpo pajtoheni për shkak të mbështetjes së organizatës partnere. Pas një viti të tërë vetëm ju keni bërë pjesën tuaj të punës. Projekti që moti ka mbaruar, ndërsa produktin e përbashkët të punës suaj (doracakun) nuk e keni marrë asnjëherë, as që dini nëse është botuar.

Ushtrimi me detyra rreth ndërtimit të paqes¹

Pjesëmarrësit/et marrin zarfet në të cilat ndodhen përshkrimet e detyrave. Detyra ka aq sa ka edhe pjesëmarrës/e, dhe ato dallojnë. Për një kohë të caktuar (rreth 1 orë) duhet të përmbushen detyrat e dhëna, pastaj vazhdon evaluimi i ushtrimit.

¹ Këtë ushtrim e ka krijuar Goran Bozhiçeviq për Trajnimin e Avancuar për Ndërtimin e Paqes QAP, gjejësisht fazën e parë të trajnimit të mbajtur më 08-18.08.2008, në të cilën si trajnues-mysafir ka mbajtur punëtorinë me temë “Ndërtimi i Paqes”.

Detyrat:

1. Gjeje personin i cili ka udhëzim që të gjejë librin e J. P. Lederach. Bashkë me të bëje ushtrimin.
2. Gjeje tek kush është libri i J. P. Lederach rreth ndërtimit të paqes. Në libër e ke detyrën. Në qoftë se nuk e di gjuhën angleze, ndërroje detyrën me dikë që di gjuhën angleze.
3. Ti je i vetmi person që e di se në librin e J. P. Lederach nuk gjendet detyra. Ti e di se ku gjendet detyra: Tek personi që ka lindur më 22.06. Këtë gjë duhet t'ua thuash anëtarëve tjerë. (thua datën e lindjes të ndonjërit prej pjesëmarrësve, ose, ende më mirë të ndonjërit nga ekipi i trajnuesve.)
4. Gjeni kapitullin në të cilin J. P. Lederach flet për dimensionin e kohës së ndërtimit të paqes. Përgatitni një prezantim të shkurtër se çka është më e rëndësishme nga ky kapitull.
5. Anketo më së paku 5 njerëz nga grupi: Çfarë mendojnë ata për raportin mes padhunshmërisë dhe ndërtimin të paqes? Shkurt, me shkronja të mëdha dhe të lexueshme paraqiti rezultatet e hulumtimit tënd të vogël. Ku përputhen/pajtohen më së shumti? Ku qëndrojnë dallimet në deklaratat? Ke maksimum 5 minuta për ekspozim. Bëre sa më interesant. Përpiku që ekzemplari/kampioni të jetë sa më reprezentativ.
6. Anketo minimum 5 njerëz: Çfarë mendojnë ata për raportin mes punës humanitare dhe ndërtimit të paqes? Shkurt, me shkronja të mëdha dhe të lexueshme paraqiti rezultatet e hulumtimit tënd të vogël. Ku përputhen/pajtohen më së shumti? Ku qëndrojnë dallimet në deklaratat? Ke maksimum 5 minuta për ekspozim. Bëre sa më interesant. Përpiku që ekzemplari/kampioni të jetë sa më reprezentativ.
7. Anketo minimum 5 njerëz: Çfarë mendojnë ata për punën e organizatave joqeveritare në ndërtimit të paqes? Shkurt, me shkronja të mëdha dhe të lexueshme paraqiti rezultatet e hulumtimit tënd të vogël. Ku përputhen/pajtohen më së shumti? Ku qëndrojnë dallimet në deklaratat? Ke maksimum 5 minuta për ekspozim. Bëre sa më interesant. Përpiku që ekzemplari/kampioni të jetë sa më reprezentativ.
8. Anketo minimum 10 njerëz: Çfarë mendojnë ata për raportin e iniciativave civile (qytetare) dhe ndërtimit të paqes? Shkurt, me shkronja të mëdha dhe të lexueshme paraqiti rezultatet e hulumtimit tënd të vogël. Ku përputhen/pajtohen më së shumti? Ku qëndrojnë dallimet në deklaratat? Ke maksimum 5 minuta për ekspozim. Bëre sa më interesant. Përpiku që ekzemplari/kampioni të jetë sa më reprezentativ.
9. Anketo pjesëmarrëset/it dhe 5 njerëz sipas zgjedhjes tënde: Çfarë mendojnë ata për raportin e punës paqësore dhe ndërtimit të paqes? Shkurt, me shkronja të mëdha dhe të lexueshme paraqiti rezultatet e hulumtimit tënd të vogël. Ku përputhen/pajtohen më së shumti? Ku qëndrojnë dallimet në deklaratat? Ke maksimum 5 minuta për ekspozim. Përpiku që ekzemplari/kampioni të jetë sa më

reprezentativ. Bëje sa më interesant.

10. Gjej personin me detyrën numër 4. Kryeni bashkërisht atë detyrë.
11. Gjej personin me detyrën numër 5. Kryeni bashkërisht atë detyrë.
12. Gjej personin me detyrën numër 6. Kryeni bashkërisht atë detyrë.
13. Gjej personin me detyrën numër 7. Kryeni bashkërisht atë detyrë.
14. Gjej personin me detyrën numër 8. Kryeni bashkërisht atë detyrë.
15. Ndiq punën e grupit ashtu që të mos pengosh. Gjej mënyrën që t'ua lehtësosh punën atyre që kanë vështirësi. Mbështeti në mënyrë sa më të përshtatshme.
16. Kujdesu që ato grupe që kanë për detyrë të përgatisim ekspozim, që atë ta bëjnë në mënyrë interesante. Bëhu modest/e në punën tënde. Qëllimi është që sa më shumë ekspozime të jenë interesante, shkurt dhe qartë. Përpiku të mos e zbulosh detyrën tënde.
17. Gjej sa më shumë persona në hotel jashtë këtij trajnimi (minimum 5) dhe anketoi: Si e shohin ata jetën në BdheH për 10 vite? Çfarë duhet bërë që jeta e tyre të jetë sa më e përafërt me ëndrrat e tyre (më të bukura)? Kush duhet ta bëjë këtë? Përgatit një prezantim të shkurtër që do u përgjigjej pyetjeve: A ishte vështirë për ta bërë këtë anketë? Cilat janë rezultatet e anketës? Para së të anketosh njerëzit, përgatitu – si do t'u afrosh?
18. Gjeje personin me detyrën numër 16 dhe ndihmoi që ta kryeni detyrën në mënyrë kualitative.
19. Gjej sa më shumë persona në hotel jashtë këtij trajnimi (minimum 5) dhe anketoi: Çfarë duhet bërë, sipas mendimit të tyre, që të ndërpresim ndonjë luftë të radhës? Çfarë do t'i kish ndihmuar ata/çarë duhet të bëjnë nëse i godet një gjë e tillë ose diçka tjetër? Përgatit një prezantim të shkurtër që do u përgjigjej pyetjeve: A ishte vështirë për ta bërë anketën? Cilat janë rezultatet e anketës? Para së të anketosh njerëzit, përgatitu – si do t'u afrosh?
20. Gjeje personin me detyrën numër 18 dhe ndihmoi që ta kryeni detyrën në mënyrë kualitative.
21. Ndiqe procesin e këtij ushtrimi. Ti je mbikëqyrës/se. Çfarë ke vënë re? Çfarë të ka pëlqyer në mënyrën e kryerjes së ushtrimit nga kolegët/et tuaj/a. Çfarë nuk të pëlqen? Përgatit rekomandimet që të mund të kryhet më me sukses herën tjetër ky ushtrim. Mos u impono.
22. Ndiqe procesin e këtij ushtrimi. Ti je mbikëqyrës/se. Çfarë ke vënë re? Çfarë të ka pëlqyer në mënyrën e kryerjes së ushtrimit nga kolegët/et tuaj/a. Çfarë nuk të pëlqen? Përgatit rekomandimet që të mund të kryhet më me sukses herën tjetër ky ushtrim. Mos u impono.
23. Ndiqe procesin e këtij ushtrimi. Ti je mbikëqyrës/se. Çfarë ke vënë re? Çfarë të ka pëlqyer në mënyrën e kryerjes së ushtrimit nga kolegët/et tuaj/a. Çfarë nuk të pëlqen? Përgatit rekomandimet që të mund të kryhet më me sukses herën tjetër ky ushtrim. Mos u impono.

Kohëzgjatja: 90 minuta

Ushtrimi me detyrat rreth ndërtimit të paqes (2)

Në hapësirën e punës gjenden 18 detyra, aq sa ka edhe pjesëmarrës/e. Pjesëmarrësit/et duhet të gjejë detyrën e tyre dhe ta kryejnë. Koha është e kufizuar në 50 (60) minuta.

Kthimi në plenum dhe evaluim i shkurtër. Si u ndjetë gjatë ushtrimit?

Vijojnë prezantimet e përgatitura.

Detyrat:

1. Gjeje tekstin “Letër të hapur ndërtuesve të paqes”. Detyra jote është që të paraqesësh nocionet e qasjes transformuese dhe teknike të ndërtimit të paqes të përshkruara në atë libër, si dhe kapitullin “Krijimi i ndryshimeve politike”. Ke maksimalisht 5 minuta për ekspozimin tënd. Bëje interesant.
2. Gjej personin që ka lindur më 06.07. dhe me të kryej detyrën për të cilën ai person ka udhëzim.
3. Gjej në internet minimum dy video me shembuj të aksionit të padhunshëm ose të ndonjë fushate e cila u ka pëlqyer. Le të jenë video të cilat zgjasin maksimalisht 5 minuta.
4. Gjej personin... (karakteristikë personale/detaj) dhe me të kryej detyrën.
5. Imagjinoje ose gjej lojën me të cilën do të përfundojmë bllokun e mëngjesit.
6. Gjej personin... dhe me të kryej detyrën.
7. Anketo minimum 5 persona jashtë trajnimit në temën “Çfarë është pajtimi”. Shkurt, me shkronja të mëdha dhe të lexueshme paraqiti rezultatet e anketës tënde. Më së shumti ku përputhen/pajtohen? Ku qëndrojnë dallimet në deklaratat? Ke maksimum 5 minuta për ekspozim. Përpiku që ekzemplari/kampioni të jetë sa më reprezentativ. Bëje sa më interesant.
8. Gjej personin që ka për detyrë të bëjë anketën “Çfarë është pajtimi”, dhe bashkërisht kryeni detyrën.
9. Anketo minimum 5 persona jashtë trajnimit në temën “Principet themelore etike në ndërtimin e paqes”. Shkurt, me shkronja të mëdha dhe të lexueshme paraqiti rezultatet e anketës tënde. Më së shumti ku përputhen/pajtohen? Ku qëndrojnë dallimet në deklaratat? Ke maksimum 5 minuta për ekspozim. Përpiku që ekzemplari/kampioni të jetë sa më reprezentativ. Bëje sa më interesant.
10. Gjej personin që ka për detyrë të bëjë anketën me temë: “Principet themelore etike në ndërtimin e paqes” dhe bashkërisht kryeni detyrën për të cilën ai posedon udhëzime.
11. Gjej në internet më së paku tre shembuj të padëgjueshmërisë qytetare dhe aksioneve të padhunshme. Ke maksimalisht 5 minuta për ekspozim. Bëje interesant.

12. Gjej personin... dhe kryej detyrën me të.
13. Ndiq punën e grupit duke mos u imponuar. Gjen mënyrat që t'ua lehtësosh punën atyre që kanë vështirësi. Mbështeti në mënyrë sa më të përshtatshme.
14. Kujdesu që ato grupe që kanë për detyrë të përgatitin prezantime ta bëjnë këtë gjë në mënyrë interesante. Sa më pak imponohu duke kryer punën tënde. Qëllimi është që sa më shumë ekspozime të jenë interesante, të shkurtra dhe të qarta.
15. Zgjidhi tre libra dhe tre filma të cilët janë inspirues për ndikim shoqëror. Përgatit një prezentim të shkurtër për çdonjërin prej tyre, që duhet të zgjasë 5 minuta.
16. Gjej personin... dhe kryeni bashkërisht detyrën që e ka marrë ai/ajo.
17. Gjej dhe paraqit më së paku tre aktivitete të cilat kanë për qëllim afrimin e komuniteteve etnike që janë të ndara në Maqedoni. Prezantimi nuk duhet të zgjasë më shumë se 5 minuta.
18. Kryej detyrën me personin që...

E kaluara – e ardhmja

Zgjidhni dikë për të formuar çift. 1. Kujtoni më së paku 3 deri më 5 momente të rëndësishme në lidhjen e deritanishme me ndërtimin e paqes. Çdonjërin shkruaje në një letër të veçantë. 2. Mendoni/parashtroni 3 qëllime që doni t'i arrini në vitet e ardhme (personalisht). Çdonjërin shkruaje në një letër të veçantë. Pastaj vazhdon biseda/shkëmbimi në grupet e vogla. Pas kthimit në plenum fletët vendosen në vendet e caktuara në tokë: “e kaluara” (momentet) dhe “e ardhmja”(qëllimet). Pastaj duket të bëjmë një shqyrtim të shkurtër rreth asaj që është shkruar.

Karrigeja e fuqishme

Një karrige është e kthyer përballë gjithë grupit. Një nga një, personat ulen në të dhe thonë disa fjali duke i filluar me “Unë kam fuqi të...” Pa nxitim!

Kohëzgjatja: 20 minuta

Vërejtje: Ky ushtrim ka efektin e fuqizimit.



Ushtrime për shtjellimin e temës
“ballafaqimi me të kaluarën”

Qëllimet e këtij grupi të ushtrimeve:

Qëllimi i këtyre ushtrimeve është që të zbardhin mekanizmat që në shoqëritë tona përdoren kur bëhet fjalë për raportin ndaj dhunës nga e kaluara e luftës. Këto ushtrime gjithashtu përpiqen të kontribuojnë edhe kah vënia në pyetje rreth roleve dhe përgjegjësisë tona, si për të kaluarën, ashtu në masë më të madhe edhe për të ardhmen e shoqërive tona dhe të gjithë rajonit. Parakusht për punë në këtë temë është njohuria e fituar dhe sensibilizimi në aspektin e temave themelore siç janë dhuna; identiteti; paragjykimet; diskriminimi.

Grupi duhet të jetë i përbërë dhe i përgatitur dhe/ose fuqishëm i motivuar (siç ndodh me grupet e ish luftëtarëve, në të shumtën e rasteve) për punë intensive në temën ballafaqimi me të kaluarën, me motivim të shprehur që të punohet në këto tema. E rëndësishme është që të kemi parasysh se kjo temë nuk është shumë e popullarizuar në shoqëritë tona, dhe se shpesh shprehet (gabimisht) nevoja që të “të shohim kah ardhmëria dhe ta lëmë të kaluarën pas nesh”. Qëllimi i punës në këtë fushë është që të ndërtohet një e ardhme e cila nuk do jetë rob i shpirtit të së kaluarës, ndërsa ushtrimet e propozuara janë të konceptuara ashtu që të ndikojnë në më shumë nivele.

- Insistojnë në të kuptuarit e rëndësisë dhe relevancën e procesit të ballafaqimit me të kaluarën për shoqëritë tona;
- Ofrojnë mundësinë për të kuptuar nocionet themelore dhe proceset në korniza më të gjëra të procesit të ballafaqimit me të kaluarën;
- Nxisin vetreflektim – parashtrimin e pyetjeve dhe përpunimin e përvojave personale nga e kaluara;
- Parashtrojnë pyetje lidhur me përgjegjësinë individuale, qytetare për të kaluarën, për të tashmen dhe për të ardhmen;
- Hapin perspektivë për të ardhmen – çfarë duhet të bëjmë nëse duam të jetojmë në një mjedis paqedashës me shumë respekt ndaj identiteteve që i kemi zgjedhur me vet dëshirë.

Metodologjia që përdorim kur punojmë në temën e ballafaqimit me të kaluarën:

Ushtrimet e propozuara kryesisht përdorin metodologjinë e zakonshme të punës interaktive - kombinimin e diskutimeve në plenum, punën në grupe të vogla dhe punën individuale. Më shpesh aplikohen metodat në vijim: barometri, diskutimi/dialogu në grupet e vogla dhe të mëdha, përgatitja e prezantimit në temë të caktuar dhe ekspozimi i tij, shkëmbimi i tregimeve dhe përvojave personale, inputet e shkurtra teorike, etj. Këto janë metodat të cilat nënkuptojnë shumë diskutim dhe dëgjim të të tjerëve, që shumë shpesh shoqërohet me një ngarkesë të lartë emotive. Edhe sikur mos të ekzistojë ajo ngarkesë, ai diskutim i gjatë, e veçanërisht dëgjimi me vëmendje i rraskapit njerëzit, dhe rekomandohet, veçanërisht në raste të trajnimeve disa ditore, kohë pas kohe të freskohet qasja me ndonjë metodë tjetër: luajtja e roleve ose simulimi, analiza e gazetave të shtypura dhe e revistave, shikimi i filmave dokumentar dhe analizimi i tyre ose diskutim duke u bazuar në të, po edhe teatër, vizatim, bërja e kolazheve (sigurisht, duhet të merret parasysh se nuk ju shkon të gjithëve për dore të shprehurit përmes artit, ashtu siç nuk ju shkon të gjithëve të shprehurit e qartë dhe të artikuluar mirë verbalisht). Zgjedhja e metodave definitivisht varret nga përbërja e grupit dhe profilit të njerëzve në të, nga ajo se a kanë apo nuk kanë përvojë si aktivistë, sa kanë njohuri rreth temës, nga përvoja personale në luftë, etj.

Duhet të kemi ndërmend se puna në temën ballafaqimi me të kaluarën gjithsesi është një nga punët që është më kërkuese, e cila prek thellë në fushën e identiteteve personale, vlerave, traumave nga e kaluara. Prandaj është shumë e rëndësishme të jesh i përgatitur mirë për shtjellimin e këtyre temave, me koncept të qartë të punës dhe imazh të qartë si atë koncept ta sjellësh në vepër.

Zgjedhja e metodologjisë adekuate, që është në përputhje me nevojat dhe arritjet e grupit ndikon shumë në atmosferën e punës, prandaj këtij aspekti të punës duhet qasur me kujdes dhe me përgatitje të mirë.

Gazetat e murit hyrëse

Temën ballafaqimi me të kaluarën shpesh herë e fillojmë me pyetje të shkurtra se çka pjesëmarrësit/et nënkuptojnë me këtë nocion, ose çka ndërlidhin me këtë, ose çfarë qëndrimi kanë ndaj atij. Kjo mund t'i japë informata shumë të nevojshme ekipit trajnues se ku qëndron grupi me nocionin dhe proceset e ndryshme të lidhura me të, çka kanë tejkaluar pjesëmarrësit/et dhe në çka do të ishte mirë të punonin. Mënyre e thjeshtë dhe e shpejt që të bëhet një gjë e tillë janë “gazetat e murit”: fletë e madhe, hamer, ose tabelë në të cilat qëndron pyetja qendrore, pjesëmarrësit/et rastësisht (pa asnjë farë renditje) japin përgjigje, dikush nga ekipi trajnues ato përgjigje i shkruan në gazetat e murit, dhe eventualisht parashtron pyetjet për sqarim (pyetje të cilat nuk hapin diskutim por shërbejnë që sa më mirë të sqarohet ajo se çfarë ka dashur dikush të thotë). Shembujt e temave për gazetat e murit:

- Kur dëgjoj për ballafaqimin me të kaluarën mendoj për...
- Përse ballafaqimin me të kaluarën?

Barometri laraman (aka “Sytë laramane”)

Më shumë herë, radhazi, grupi i pjesëmarrësve/eve duhet të ndahet nëpër grupe, duke iu afruar fletës në të cilën ndodhet njëra nga deklaratat e mëposhtme në lidhje me procesin e ballafaqimit me të kaluarën në rajonin e ish Jugosllavisë. Pas çdo ndarjeje u parashtrohen disa pyetje individëve/eve që të shpjegojnë për zgjedhjen e grupit. Pastaj vazhdon evaluimi i shkurtër i ushtrimit me komentet dhe shqyrtimet e pjesëmarrësve/eve për gjërat që janë dëgjuar gjatë kryerjes së ushtrimit.

Deklaratat:

- “Kam jetuar në luftë”; “Lufta vetëm kaloi pranë meje”; “Lufta nuk ka ndikuar drejtpërdrejt në jetën time”; “Luftën e kam parë në TV.”
- “Ballafaqimi me të kaluarën është detyra më prioritare e shoqërive tona”; “Ballafaqimi me të kaluarën është diçka që nuk e kuptoj”; “Ballafaqimi me të kaluarën është i rëndësishëm por ka gjëra akoma më të rëndësishme”; “Ballafaqimi me të kaluarën është koncept i imponuar nga perëndimi”; “Të tjerët.”
- “Ballafaqimi me të kaluarën është punë e organizatave joqeveritare”; “Ballafaqimi me të kaluarën është punë e

Vërejtje: Është ushtrim i dobishëm në fillim të punës në këtë temë për shkak se në mënyrë relativisht të shpejtë dhe të thjeshtë vjen deri tek shkëmbimi me të cilën formohet pasqyrë më e mirë për përvojat e ndryshme të cilat ekzistojnë në grup, pastaj jep informacione në lidhje me atë se në çfarë mase jemi pozicionuar në lidhje me temën dhe cilat janë ato pozicione. Ky lloj i shkëmbimit kontribuon në të kuptuarit më të mirë të ndërsjellë, dhe kjo ka rëndësi thelbësore për qasjen konstruktive të çështjeve me rëndësi më të madhe nga kjo fushë. Në qoftë se deri tani nuk është formuar këmbim solid në grup (ose në qoftë se ushtrimi

shtetit”; “Ballafaqimi me të kaluarën nuk është punë e imja”; “Ballafaqimi me të kaluarën është punë e viktimave”

- “Më e rëndësishme është të gjykojen kriminelët”; “Më e rëndësishme është të përcaktohet e vërteta”; “Më e rëndësishme është t’u jepet kompensim viktimave”; “Më e rëndësishme është të jemi gjallë e shëndosh”; “Më e rëndësishme është që ana ime të pranojë se ka bërë krime.”
- “Shoqëria ime ka shkuar larg në procesin e ballafaqimit me të kaluarën”; “Shoqëria ime as nuk ka filluar me këtë proces”; “Shoqëria ime ka bërë hapa të vegjël në këtë proces”; “Shoqëria ime për çdo ditë ballafaqohet me të kaluarën.”

bëhet nga dita e parë ose e dytë e takimit), duhet të kemi parasysh se ky ushtrim mund të jetë i vështirë për disa persona për shkak se kërkon pozicionim të saktë në lidhje me disa tema të rënda.

Kohëzgjatja: 45-60 minuta

Edhe disa deklaratat mundshme:

- “Pajtimi është detyra më prioritare e shoqërive tona”; “Pajtimi është diçka që nuk e kuptoj”; “Pajtimi është i rëndësishëm, por ka gjëra shumë më të rëndësishme”; “Pajtimi është koncept i imponuar nga perëndimi”; “Pajtimi është koncept që e imponojnë religjionet”; “Të tjerët.”
- “Viktimat duhet të pajtohen”; “Duhet të pajtohen veteranët e luftës”; “Shtetet duhet të pajtohen”; “Duhet të pajtohem unë”; “Duhet të pajtohen serbët dhe kroatët.”

Ballafaqimi destruktiv dhe konstruktiv me të kaluarën

Punë në grupe të vogla (nga 5-7 persona). Kanë për detyrë të bisedojnë për atë se si e shohin ata ballafaqimin destruktiv me të kaluarën dhe të bëjnë gazeta të murit për këtë temë. Pas një kohe (15-20 minuta) marrin edhe detyrë plotësuese, pyetja është: Çfarë është ballafaqimi konstruktiv me të kaluarën?

Vazhdon prezantimi i asaj që kanë punuar dhe pyetjet për sqarim.

Barometri: Çfarë (nuk) kontribuon për ballafaqimin me të kaluarën

Në mes të dhomës së punës gjendet një barometër i paramenduar, me polet “Kontribuon në ballafaqimin me të kaluarën” dhe “Nuk kontribuon në ballafaqimin me të kaluarën”.

Metoda “Barometri i madh” është përshkruar në faqen 55.

Propozimi i deklaratave/koncepteve:

- Bashkëpunimi ekonomik në rajon.
- Pllakat përkujtimore në fushëbeteja dhe llogore.
- Përmendoret e luftëtarëve të rënë.
- Përkujtimi i përvjetorit të “Ollujës”.
- Deviktimizimi
- Ndikimi i bashkësive fetare.
- Tribunali i Hagës.
- Kërkimi i faljes nga burrështetasit/pushtetarët.
- Gjykimet për krime lufte në gjykatat e vendit.
- Filmat dokumentarë rreth luftës.
- Puna me traumat.
- Kampet ndëretnike për të rinj.
- Aktvendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të së Drejtës në Hagë.
- Përgjegjësia kolektive.
- Individualizimi i fajit.
- Shfuqizimi i partive nacionaliste.
- Amnistia në këmbim të pranimit të fajit.
- Ndalesa e segregimit nëpër shkolla.
- Ligë e përbashkët e futbollit.
- Qendër për komunikim të padhunshëm në Srebrenicë.
- Presioni i komunitetit ndërkombëtar.
- Të vërtetuarit e numrit të saktë të viktimave.

Kohëzgjatja: 90-120 minuta



“Hotelet”

Detyrë: “Ju keni rolin e pjesëmarrësit/es së trajnimit për ndërtimin e paqes. Duhet të merrni vendimin se ku do të mbahet faza e dytë e trajnimit. Ekipi trajnues nuk do ta moderojë këtë proces.”

Ekipi trajnues do të ofrojë tre vende/hotele (ekzistuese) dhe do të njoftojë pjesëmarrësit me specifikimet e çdonjërit prej tyre. Ne lidhje me çdonjërin vend ekziston ndonjë vështirësi, p.sh. tensionet e shprehura ndërnacionale me përleshjet e kohëpaskohshme, ose ekziston ndonjë përvojë e mëparshme e papëlqyeshme me vendasit për shkak të përbërjes së përzier të grupit të pjesëmarrësve, ose bëhet fjalë për ndonjë hapësirë që gjatë luftës ka shërbyer si llogor, e tani kjo gjë nuk është e shënuar në asnjë mënyrë, etj. Të tre vendet janë në vendet të ndryshme të ish Jugosllavisë dhe ekziston vetëm nga një person në grup që është nga ai vend.

Koha për të vendosur: 1 orë. Pastaj bëhet evaluimi dhe biseda në plenum (me moderimin e ekipit trajnues).

Kohëzgjatja: 90 minuta



Vërejtje: Ky ushtrim është i formuluar për ato trajnime të cilat përbëhen nga më së paku 2 faza, gjegjësisht kur është evidente se grupi në përbërje të njëjtë do të takohet përsëri. Kjo gjë e bën këtë situatë shumë reale, gjegjësisht ia jep rëndësinë ushtrimit, pasi që pjesëmarrësit/et janë të vetëdijshëm se nuk bëhet fjalë “vetëm për një ushtrim” dhe se vendimi i tyre mund të ketë pasoja të caktuara, dhe më rrallë përdorin taktika që të mos zihen në mes veti dhe ose mos të hapin tema të rënda. Bëhet fjalë për një ushtrim të ndërlikuar, i cili mund të shkaktojë ngarkesë emotive në grup, pasi që njerëzit shpesh ballafaqohen me frikat e tyre dhe kanë përgjegjësi ndaj të tjerëve të shpjegojnë përse nuk duan të shkojnë në ndonjë vend.


Ushtrimin kryesisht e kemi bërë në kornizat e temës “puna në ekip dhe marrja e vendimeve” në trajnimet e avancuara me qëllim që në fillim të trajnimit të parashtrijmë pyetje relevante për ballafaqimin me të kaluarën. Por, ky ushtrim mund të kryhet edhe me qëllim të njoftimit të konteksteve në të cilat jetojmë, dhe në kornizat e temave ndërtimi i paqes dhe ballafaqimi me të kaluarën, vetëm që atëherë në evaluimin e ushtrimit nuk potencohet aq shumë procesi i marrjes së vendimeve. Sidoqoftë, shumë e rëndësishme është që pas kryerjes së ushtrimit njerëzve t’u jepet hapësirë për evaluim emocional, gjegjësisht për shqyrtimin e asaj se si janë ndjerë ata, çfarë i ka goditur, ose çka ka qenë e vështirë. Thelbësore është që kjo hapësirë duhet të sigurohet menjëherë pas kryerjes së ushtrimit, qoftë edhe për një kohë të shkurtër, që të mos biem pre e nevojës së theksuar që menjëherë të shkohet në pauzë (veçanërisht për duhan pirësit).

Karriget e nxehta: Lufta dhe unë


Çdokujt nga grupi i jepet mundësia që para gjithë grupit të flasë për tregimin e tij rreth temës: Gjurmët që ka lënë lufta tek unë dhe jeta ime?

Punohet me metodën e “Karrigeve të nxehta”: Tre karrige të ndara. Të gjithë rrinë ulur në karrige të cilat janë të radhitura “në patkua” përball këtyre tre karrigeve, ashtu që t’i shohin mirë. Një vullnetar/e ulet në karrigen në mes (kjo është e vetmja karrige nga e cila flitet) dhe thërret dy persona nga grupi që të jenë mbështetje dhe të ulen tek karriget anash. Roli i tyre është vetëm të rrinë aty ulur afër personit i cili flet dhe t’i japin mbështetje me praninë e tyre fizike. Kur vullnetari/ja mbaron tregimin e vetë për temën e dhënë, kthehet në vendin e vet, dhe në karrigen që ngelen e zbrazur në mes duhet të ulet njëri nga ato që më herët e ka patur rolin e mbështetësit. Para se të fillojë me tregimin e vet, thërret edhe një person të caktuar nga grupi të cilin dëshiron ta ketë mbështetje që të ulet në vendin e zbrazur tek “karriget e nxehta”. Procesi vazhdon deri sa të gjithë (duke përfshirë edhe ekipin trajnues) të kenë mundësinë të ndajnë tregimin e tyre me të tjerët.

Kohëzgjatja: 90-120 minuta



Vërejtje: Përvoja e fituar duke marrë pjesë në këtë ushtrim jep mundësinë e vetme në trajnim që tregimet për të kaluarën të shihen nga këndi personal. Për të ndarë tregimet personale, dhe për të dëgjuar tregimet e tjerëve, nevojitet shumë energji dhe durim. Prandaj shumë e është rëndësishme është të gjendet momenti i duhur në trajnim për këtë ushtrim, gjithashtu mirë është që t’u jepet hyrje e mirë dhe inkurajim njerëzve që të dalin me tregimet e tyre personale. Mund të ndihmojë nëse personi që flet i pari të jetë dikush nga ekipi trajnues ose dikush që ka përvojë nga më herët me këtë lloj ushtrimi. Në raste të caktuara ky ushtrim mund të eskalojë nga koha e caktuar, por ajo formon atmosferë për kujdes dhe empati të ndërsjellë dhe në të cilën koha nuk është faktor dominant. “Karriget e nxehta” zakonisht kanë efekt fantastik në krijimin e lidhjeve, në të kuptuarit e ndërsjellë dhe krijimin e empatisë mes njerëzve.



Karriget e nxehta: Më vjen keq...

Çdokujt nga grupi i jepet mundësia që para gjithë grupit të flas për



Vërejtje: Në qoftë se në trajnim është përdorur metoda karriget e nxehta, ndoshta është më mirë ky ushtrim të mos përsëritet, ose nëse është vlerësuar se ndonjë çështje e caktuar është e rëndësishme për këtë grup pjesëmarrësish: të gjendet ndonjë metodë tjetër që ajo të përpunohet.

tregimin e tij rreth temës: “Më vjen keq...” (për atë që ka të bëjë me luftërat e mëparshme dhe gjendjen momentale sa i përket çështjes së ballafaqimit me të kaluarën).

Shihni përshkrimin e metodës në ushtrimin më sipër.

Çka më pengon në tregimet për luftën? Çka më mungon?

Pjesëmarrësit/et në grupe më të vogla flasin për atë se çka u pengon në tregimet për luftën, çka u mungon. Pas shkëmbimit në grupe të vogla, vazhdon shkëmbimi në plenum.

Mohimi – arsyetimi - kërkitimi i së vërtetës

Pjesëmarrësit/et ndahen në tre grupe dhe çdo njëri grup punon në gazetë e murit duke shtjelluar njërin nga format e dhëna të sjelljes në ballafaqimin me të kaluarën: mohimin, arsyetimin, kërkitimin e së vërtetës. Gjatë punës në grupet e vogla pjesëmarrësit/et duhet të japin përgjigje në pyetjet e në vijim: Kush janë mbajtësit e këtij procesi? Pse përdoret kjo qasje? Cilët janë pasojat e qasjes së tillë për shoqërinë?

Pasi të mbarojë puna në grupe të vogla prezantohen gazetë e murit për të tre proceset, pastaj vazhdohet me diskutim në plenum.

Kohëzgjatja: 45-60 minuta

Qasja e shoqërive tona ndaj të kaluarës

Bisedë në grupe të vogla (4-5 persona), të përziera sipas rajonave, nacionaliteteve dhe moshës lidhur me temën: Si reagon mjedisi juaj ndaj të kaluarës? Për cilat çështje nga e kaluara flitet/pëshpëritet/heshtet? Si reagojnë njerëzit ndaj tregimeve nga e kaluara? Si ndjeheni ju në lidhje me gjithë këtë? Çfarë u pengon/mungon/dhemb?

Kohëzgjatja: 45-60 minuta

Vërejtje: Ky është njëri nga ushtrimet më të mirë hyrës për punë në temën e ballafaqimit të së kaluarës. Nëpërmjet këtij ushtrimi pjesëmarrësve/eve u jepet mundësia që të reflektojnë gjendjen në shoqëritë e tyre, por edhe të njoftohen me mekanizmat dominant në mjediset tjera në aspektin e raportit me të kaluarën.

Çka do të ishte një raport i ndershëm ndaj së kaluarës?

Grupi ndahet në grupe më të vogla sipas përkatësisë nacionale (ose rajonale). Çdo grup ka për detyrë të bëjë një gazetë muri me temën: Çfarë është ajo që duhet të ndryshohet në rrethin ku populli im është shumicë, e që do të paraqiste raport të ndershëm ndaj së kaluarës dhe hap drejt pajtimit? Pasojnë prezantimet e bëra.

Pas kësaj të gjitha gazetatat e murit vendosen në vende të arritshme dhe atyre ju afrohen personat të cilët nuk kanë marrë pjesë në përpunimin e tyre (gjegjësisht, personat e shteteve tjera). Dhe me këtë formohen grupe tjera të vogla për hapin e dytë të ushtrimit. Ata shkruajnë në të njëjtat fletë, por me ngjyrë tjetër atë që mendojnë se duhet të shkruhet e që nuk është shkruar. Saktësisht, detyra e tyre është që të mbushin gazetatat e murit me atë që sipas mendimit të tyre është ende e nevojshme që të bëhet në ato mjedise.

Pason leximi i asaj që është shtuar, pastaj biseda në plenum për çështjet kyçe të cilat janë hapur. Krahاسimi i punës së grupit të parë dhe atij të dytë, njashtu, mund të jetë nxitëse.

Kohëzgjatja: 60 minuta

Vërejtje: Shumë me rëndësi është që këtë ushtrim ta prezantojmë me kujdes, e veçanërisht pjesën e dytë kur jepet udhëzim për të plotësuar më tej gazetatat e murit. Ndonjëherë njerëzve mund t'u duket e pakëndshme që të shkruajnë në gazetatat e murit të cilat i kanë bërë të tjerët, (shpesh për shkak se kujdesen për atë që të mos i prishin marrëdhëniet e ndërsjella). Për këtë shkak është e rëndësishme që të theksohet se qëllimi i këtij ushtrimi është që të fitohet informata kthyes (feedback), gjegjësisht kritika konstruktive nga njerëzit e vendeve tjera, pasi që gjatë përvojave dhe perceptimeve të ndryshme kemi edhe ide të ndryshme për atë që do të ishte e dobishme të bëhet.

Narrativet kolektive rreth luftërave të fundit

Pjesëmarrësit/et ndahen në grupe më të vogla, në bazë të shteteve nga vijnë. Detyra është që të bëhen gazeta e murit të cilat do të mbajnë elementet themelore të narrativeve dominante kolektive rreth luftërave të viteve të 90-ta të cilat ekzistojnë në shoqëritë e tyre.

Pastaj pason paraqitja në plenum, me pyetje eventuale për sqarim.

Kohëzgjatja: 60 minuta

Vërejtje: Para këtij ushtrimi e domosdoshme është që pjesëmarrësve/eve t'u sqarohet nocioni i narrativeve kolektive/historike, dhe si lidhen ata me ballafaqimin me të kaluarën. Ky ushtrim mund të jetë një mënyrë e mirë për njohjen e konteksteve të ndryshme, si dhe për njohjen e mënyrave se si kolektivet tona nacionale e trajtojnë dhe përshkruajnë veten ndaj kolektiveve "tjera" armiqësore.

Narrativet familjare

Të gjithë kanë nga 10 minuta të mendojnë dhe të shkruajnë (si shënim për të mbajtur mend) narrativet që kanë dëgjuar në familjet e tyre rreth Luftës së Dytë Botërore dhe rreth luftërave të fundit të viteve 90-ta. Pyetjet ndihmëse: Çfarë është folur në familjen tuaj për Luftën e Dytë Botërore dhe për luftërat e fundit? Prej kujt i keni dëgjuar ata tregime? A kanë ekzistuar dhe cilat kanë qenë dallimet mes narrativeve? Kush kanë qenë “të tonët” dhe kush kanë qenë “të tjerët”? Çfarë imazhesh kanë ekzistuar për të tjerët?

Pastaj pason këmbimi në grupe më të vogla (nga 4-5).

Diskutimi në plenum që pason fillon me një lloj të evaluimit emotiv, dhe pastaj bëhet lidhja ndërmjet narrativeve dominante kolektive dhe narrativeve të familjeve tona. Pyetjet për diskutim: A ekziston lidhje mes narrativeve nga Lufta e Dytë Botërore dhe luftërave të fundit? Në çfarë raporti janë narrativet familjare me narrativet dominante në shoqëri?

Vërejtje: Sikur në ushtrimin e mëparshëm, edhe këtu është e nevojshme një njohuri paraprake teorike rreth nocionit dhe rëndësisë së narrativeve kolektive. Të dy ushtrimet mund të kryhen njëri pas tjetrit, ose ndaras, varësisht nga nevoja.

Kohëzgjatja: 60-90 minuta



Kur arsyetohet lufta?

Çdokush për vete le të mendojë dhe le të shkruaj përgjigjet e veta në letër. Pas një kohe të caktuar, çdo person një nga një i afrohet tabelës, lexon se çfarë ka shkruar, dhe e ngjet letrën në tabelë.



Çfarë duhet të përkujtojmë ne si shoqëri?

Ndarja në grupe të vogla:

Hapi 1: përpunimi i gazetave të murit me temë: “Çfarë përkujtojmë ne si shoqëri (nga e kaluara e afërme)?”

Hapi 2: përpunimi i gazetave të murit me temë: “Çfarë duhet të përkujtojmë ne si shoqëri?”

Pasojnë prezantimet, pastaj diskutimi në plenum.

Vërejtje: *Plotësimi i këtij ushtrimi mund të bëhet duke shtuar edhe pyetjen: Në çfarë mënyre?*



Barometri rreth ballafaqimit me të kaluarën

Caktohen dy pole në dhomë, p.sh. njëri mur paraqet se pajtimin/dakordimin maksimal me deklaratën e caktuar, ndërsa muri i kundërt paraqet mospajtimin maksimal me deklaratën. Kur trajnuesi/ja lexon deklaratën, pjesëmarrësit/et vendosen në barometër me trupin e tyre, ashtu që çdokush do të vendoset në vendin që tregon pajtimin ose mospajtimin me deklaratën (të gjitha pozitat ndërmjet dy ekstremeve mund të shfrytëzohen). Pastaj një numër i pjesëmarrësve/eve sqaron se përse është pozicionuar në atë pozitë. Shkohet nga njëri skaj i barometrit në tjetrin. Udhëzim i rëndësishëm është që të mos i referohemi asaj që kanë thënë të tjerët, por të përpiqemi të artikulojmë mendimin tonë, duke mos treguar se a pajtohemi apo nuk pajtohemi me personat tjerë në barometër.

Disa nga deklaratat:

- Nuk ekziston përgjegjësi kolektive
- Më mirë do të ishte që gjykatat ndërkombëtare të procesuojnë krimet e luftës
- Nuk duhet t'i harrojmë viktimat tona
- Duhet falur
- E vërteta është një

Vërejtje: Në qoftë se dikush në barometër fillon të shpreh pajtimin/mospajtimin me diçka që është thënë më parë, duhet ta parandalojmë dhe ta përkujtojmë për rregullat se këtu shprehet vetëm mendimi personal, duke mos u thirrur në tjerët. Përndryshe barometri nuk moderohet dhe nuk parashtrohen pyetje shtesë për atë që flet.

Nuk duhet të teprohet me numrin e deklaratave, as edhe me numrin e personave që paraqiten me nga një fjalë në deklaratë, por duhet të përpiqemi që barometri të zgjasë më së shumti 30-40 minuta, që njerëzit të mos lodhen duke ndenjur në këmbë pasi që kështu nuk do të dëgjojnë të tjerët.



Akuariumi rreth ballafaqimit me të kaluarën


Në mes të dhomës vendosen katër karrige të cilat formojnë akuariumin e paramenduar. Në tre karrige ulen personat të cilët duan të diskutojnë në lidhje me temën e dhënë, ndërsa karriga e katërt është e rezervuar për ato persona që ndonjëri prej këtyre tre personave e thërret në akuarium. Gjatë ushtrimit mund të flasin vetëm personat që në atë moment gjenden brenda në “akuarium”. Kur dikush dëshiron të flasë, u afrohet karrigeve dhe prek shpatullën e personit në vend të cilit do hyjë në akuarium. Ai mund të përfundojë fjalinë, dhe pastaj ka për detyrë të çohet dhe t’ia lëshojë vendin personit të ri.

Jepet një temë, ndërsa pjesëmarrësit/et që janë të interesuar që të flasin në këtë temë, pozicionohen në akuarium. Kryesisht bisedohet prej tre deri në pesë tema, ndërsa temat përpunohen një nga një. Kur biseda rreth njërës temë përfundon (ose pas përfundimit të kohës), personat që kanë marrë pjesë në akuarium kthehen në vendet e tyre, dhe pastaj jepet tema e re...

Disa nga temat për akuarium:


- E vërteta është më e rëndësishme se pajtimi
- Ma ballafaqimin e të kaluarës duhet të merremi në oborrin tonë
- Ndjej përgjegjësi për atë që është bërë në emër të popullit tim
- Pajtimi është çështje e zgjedhjes personale
- Identitetet nacionale janë pengesa për pajtim
- Detyra kryesore e procesit të ballafaqimit me të kaluarën është që të gjykohen kriminelët e luftës
- Identiteti nacional përcakton raportin me të kaluarën
- Sikur të pyetej populli, luftë nuk do të kishte
- Çdokush duhet të kritikojë vetëm palën e vet
- Kush është fajtor për luftën?
- Më shumë më dhimbsen viktimat e popullit tim

Kohëzgjatja: 45 minuta



Vërejtje: Metoda e akuariumit është shumë e mirë për inkurajimin e diskutimeve të hapura gjatë të cilave përballen pikëpamje të ndryshme për probleme të caktuara. Në qoftë ekipi trajnues vlerëson se në grup ka shumë qëndrime kundërshtuese të cilat nuk artikulojnë mjaftueshëm qartë, akuariumi mund të jetë shumë i dobishëm në artikulimin e pozitave të ndryshme brenda grupit. Duhet të kemi parasysh se disa grupeve kjo metodë nuk u përshtatet, ashtu siç nuk i përshtatet çdo momenti të trajnimit.

Për çdo temë duhet të ndajmë minimum 10 minuta. Pasi që kjo bisedë nuk moderohet, mund të jetë e dobishme që me pjesëmarrësit paraprkishtë të merremi vesh që pas kalimit të kohës p.sh. pas 10 ose 15 minuta ushtrimi të ndërpritet. Që ky kufizim mos të shkaktojë frustrim, e rëndësishme është që njerëzve tu bëhet e qartë se qëllimi i këtij ushtrimi është këmbimi dhe kuptimi i mendimeve të ndryshme, dhe jo definimi i përgjigjes së saktë ose të caktohet se kush ka të drejtë ose kush nuk ka të drejtë.



Pro dhe kundër

Ndarja në tre grupe të vogla të përziera.

Hapi 1. Pyetje. Çfarë do të na thoshin ata që janë kundër takimeve të këtilla? Të numërohen dhe të shkruhen në fletë të mëdha, pa diskutim.

Hapi2. Çdo grupi i jepet nga një temë dhe ka për detyrë të shënojë arsyet pro dhe kundër asaj teze. Temat janë:

- Falni, por mos harroni asnjëherë.
- Populli është fajtor për luftën.
- Ata që kanë luftuar sot punojnë për pajtim.

Pason prezantimi i gazetave të murit nga hapi i parë (të tre grupet), pastaj prezantimi i gazetave e murit nga hapi i dytë, dhe në bazë të kësaj bëhet diskutim në plenum.

Kohëzgjatja: 120 minuta

Vërejtje: Ky ushtrim është projektuar gjatë trajnimit me pjesëmarrësit e luftës për të cilët pyetja "Çfarë do të na thoshin ata që janë kundër takimeve të këtilla?" është shumë relevante, pasi që ndaj atyre takimeve, shpesh, nuk shikohet me dashamirësi. Gjatë përfundimit të trajnimit është inspiruese që të parashtrësh pyetjen: Çfarë do t'u thoshit atyre që janë kundër takimeve të këtilla?

Ballafaqimi me të kaluarën në shoqërinë time

Pjesëmarrësit ndahen në grupe sipas vendeve nga vijnë. Kanë për detyrë që të përgatitin prezantim rreth gjendjes së procesit të ballafaqimit me të kaluarën në shoqërinë e tyre, kështu që do të përgjigjen në pyetjet në vijim që janë relevante për atë shoqëri.

Pyetjet ndihmëse:

- Narrativi dominant rreth luftës së fundit (luftërave të fundit) me pesë fjali.
 - Qëndrimi juaj ndaj narrativit dominant
 - Cili është qëllimi i procesit të ballafaqimit me të kaluarën në shoqërinë tuaj?
 - Cilët janë rezultatet e atij procesi?
 - Kush e “shtyn” atë proces (kush e merr iniciativën)?
 - Kush kundërshton? Përse?
 - Mekanizmat më të rëndësishëm të ballafaqimit me të kaluarën dhe ngjarjet të cilat kanë pasur efekt të rëndësishëm.
 - Çfarë ka qenë e dhimbshme për shoqërinë në atë proces?
 - A ekziston lidhja mes procesit të ballafaqimit me të kaluarën dhe pajtimit? (kush me kë është dashtë të pajtohet?)
 - Sipas mendimit tuaj, çfarë i mungon procesit të ballafaqimit me të kaluarën?
 - Çka do të mund të mësonin të tjerët nga ajo se si kryhet procesi i ballafaqimit me të kaluarën në shoqërinë tuaj?
- Pasojnë prezantimet në plenum dhe pyetjet për sqarim.

Unë dhe pajtimi

Në tokë gjenden disa fletë të mëdha, dhe në çdonjërin prej tyre gjendet njëra nga pyetjet në vijim:

- Cila është sfida më e madhe për pajtimin?
- Me kë dhe me çfarë duhet të pajtohem unë/të ndërtoj raport?
- Kush dhe me kë duhet të pajtohet?
- Çfarë dhe kujt mund/dëshiroj/duhet t'ia fal?
- Prej kujt dua dhe më duhet falja?

Të gjithë afrohen dhe shkruajnë njëkohësisht përgjigjet ose lexojnë atë që është shkruar. Pas kësaj ndahet kohë në qoftë se dikush dëshiron të shikojë gjithë atë që është shkruar në ato fletë.

Vërejtje: *Ushtrimi është veçanërisht i vlefshëm atëherë kur është e nevojshme që t'i kthehemi vetes dhe rolit tonë në shoqëri, e veçanërisht nëse në grup ekziston gatishmëri e madhe që të diskutohet rreth proceseve shoqërore-politike, por jo edhe të reflektohet roli dhe përgjegjësitë personale në to. Gjithsesi, rreth këtyre çështjeve mund të bisedojmë edhe në plenum ose në grupe më të vogla, por ndonjëherë është më e dobishme që të mbylлим hapësirën për diskutim, ndërsa të hapim hapësirën që të mendojmë pak dhe të pyesim vetveten në lidhje me këtë.*

Çfarë mund të bëj unë?

Në tokë gjenden disa fletë të mëdha, dhe në çdonjërin prej tyre gjendet një nga pyetjet/titujt në vijim:

- Çfarë mund të bëj unë që të kontribuoj për ballafaqimin me të kaluarën?
- Çfarë dilemash kam, dhe çfarë frikash?
- Kush janë kundërshtarët e mi?
- Ku e gjej mbështetjen?

Të gjithë afrohen dhe shkruajnë njëkohësisht përgjigjet e tyre ose lexojnë atë që është shkruar në qetësi. Pas kësaj ndahet pak kohë për ata që duan të shohin gjithë atë që gjendet nëpër fletë.

Heronjtë

Pjesëmarrësit/et luten që të ndahen në grupe të vogla në bazë të përkatësisë nacionale: shqiptarët/et, serbët/et, kroatët/et, boshnjakët/et, maqedonasit/et... secili grup duhet të shkruaj dhe të numërojë heronjtë nacional nga komuniteti i tyre (pa marre parasysh se a i ndjenjë ata personalisht si heronj). Pas përfundimit të punës në grupe të vogla, çdonjëri grup duhet të lexojë heronjtë e “tyre”, të japin shpjegime eventuale në lidhje me emrat që i kanë shkruar, dhe pastaj pason diskutimi plenar.

Disa nga pyetjet e mundshme për diskutim:

- Si e komentoni listën tuaj, dhe si i komentoni listat tjera?
- “Si ndjeheni me emrat e përmendur, sa janë ata “heronj” tuaj personal”?
- A ekziston ndonjë formular sipas të cilit njerëzit bëhen heronj nacional në vendet tona?
- Si është e lidhur kjo me mënyrën në të cilën shoqëritë tona janë të lidhura me të kaluarën?
- Përse ka aq pak gra në ato lista?

Kohëzgjatja: 45 minuta

Versioni tjetër i ushtrimit:

Hapi 1. Heronjtë personal. Çdokush për vete të mendojë dhe të shkruaj se kush janë heronjtë e tij/saj nga fëmijëria, ndërsa cilët janë heronjtë e tanishëm për to.

Vërejtje: Ky ushtrim është shumë i dobishëm në të kuptuarit e raportit dominant ndaj të kaluarës, historive nacionale dhe përkujtimit kolektiv në trojet tona dhe jep imazhin se çfarë vlerësohet në këto shoqëri. Mund të na shërbejë shumë edhe gjatë përpunimit të temës “Identiteti Nacional”

Hapi 2. Ndarja në grupe të vogla (që përbëhen nga njerëz të trojeve të ndryshme). Këmbimi lidhur me heronjtë për të cilët kemi shkruar.

Hapi 3. Grupi i vogël në fletë të madhe (në gazetë të murit) le të shkruaj listën e atyre të cilët janë heronj në shoqëritë tona.

Hapi 4. Diskutimi në plenum, përshtypjet, komentet.

Tabutë

I gjithë grupi bashkërisht përpunon një gazetë muri me temë: Cilat janë tabutë të cilat janë të pranishme në shoqëritë tona, por që kanë të bëjnë me të kaluarën e dhunshme.

Pasi që të shkruhen të gjitha këto gjëra pason diskutimi në plenum me pyetjet: Përse heshtet për këto çështje? Përse është aq vështirë të flitet për këtë? Kush dhe çfarë i bën që të jenë këto tema aq tabu?

Variacioni: ushtrimi në të njëjtin princip mund të kryhet edhe në grupet e vogla të përziera; kësaj mund t'i paraprijë edhe puna individuale ku së pari çdokush duhet të mendojë dhe të shkruaj përgjigjet e tyre në fletë të vogla, dhe pas kësaj shkohet në grupe të vogla.

Kohëzgjatja: 60 minuta

Memorializimi: përmendoret

Hapi 1. Krijimi i gazetave e murit në plenum: Për çfarë shërbejnë përmendoret, cili është qëllimi i tyre? Për kë i bëjmë?

Hapi 2. Në tabelë janë fotografitë e përmendoreve nga luftërat e fundit. Ekspozitë e shkurtër, që të gjithë të kenë rastin të shohin.

Hapi 3. Biseda në plenum: si i përjetoni këto përmendore dhe përmendoret tjera të cilat i dini se ekzistojnë? Çfarë mesazhesh na dërgojnë? Çfarë lloji të simboleve përmbajnë? Sa kontribuojnë në përkujtimin e viktimave? Sa (nuk) kontribuojnë për pajtimin?

Vërejtje: Në qoftë se në fotografitë mbishkrimet në përmendoret nuk duken mirë, mund të shkruhen në fletë të tjera ose duhet t'i shënojmë në ndonjë mënyrë tjetër.

Kohëzgjatja: 60 minuta

Versioni tjetër i ushtrimit

Hapi 1. Në grupe të vogla bisedohet rreth funksionit të formave ekzistuese të memorialëve. Krijimi i gazetave të murit në temën: Cilat nevoja i përmbushin? Kujt ("neve", "atyre", luftëtarëve, familjeve të viktimave...) çfarë mesazhesh dërgojnë? Pastaj

prezantimet dhe biseda në plenum.

Hapi 2. Në tabelë janë fotografitë e përmendoreve nga luftërat fundit. Ekspozitë e shkurtër, që të gjithë të kenë rastin t'i shikojnë.

Hapi 3. Bisedë dhe krijim i gazetave të murit në plenum. Vështirësitë që i kemi me mënyrat ekzistuese të shënimit? Përse? Pastaj: Çfarë u pëlqen në lidhje me përmendoret ekzistuese? Përse?

Kultura e përkujtimit para dhe pas viteve nëntëdhjeta

Bisedë në plenum rreth karakteristikave të kulturës së kujtimit para viteve të nëntëdhjeta dhe pas luftërave. Një person nga ekipi trajnues shkruan vendet e shënuara kyçe në tabelë/gazetën e murit. Pastaj bëhet këmbimi i dilemave që kemi në lidhje me to.

Lajme nga e ardhmja

Lexohen tre “lajmet nga e ardhmja”:

1. Shoqata e luftëtarëve të Armatës së B dhe H ka përshëndetur aktdënimin e Gjykatës së B dhe H për Krime Luftë, për komandantin e Armatës së B dhe H. Shoqata njëkohësisht gjykon deklaratën e anëtarit kroat të Presidencës së B dhe H që vendimin përfundimtar e kishte komentuar duke thënë: “Ky aktvendim është dënim për viktimat, ndërsa shpërblim për agresorët”.

2. Sot delegacioni i VRS dhe UBR nga Serbia ka vendosur kurora në Beograd në përmendoren e viktimave të gjenocidit në Srebrenicë dhe Prijedor, pastaj kanë ftuar përfaqësuesit e qeverisë që të mbështesin programet e këmbimit ndërkuftar të të rinjve dhe kampeve paqësore që organizojnë Organizatat e Veteranëve, Organizata për të Drejtat e Njeriut, Organizata e Historianëve të Bashkuar të Ballkanit Perëndimor. Ftesës i janë bashkuar një numër i madh i personaliteteve nga kultura dhe sporti, në mesin e të cilëve janë edhe A. D., Dejan Stanković, Edin Xheko, Novak Gjković, Danis Tnoviq, Jasmina Zhbaniq, A. D., Ljubisha Samarxhiq, dhe A. H. (në vend të inicialeve të japim disa nga emrat e njerëzve nga grupi dhe/ose ekipi trajnues).

3. Shoqata HVIDR nga Mostari ka dërguar kumtesë për shtyp ku kanë shkruar se bashkë me Shoqatën e të Arrestuarve nëpër

Vërejtje: Lajmet duhet të jenë të përgatitura në atë mënyrë që të kenë lidhje me grupin e pjesëmarrësve/eve. (Ky ushtrim është i përgatitur për një grup të caktuar dhe shumë specifik të veteranëve të luftës). Qëllimi është që të reflektojmë se çfarë është pengesë për disa veprime njerëzore që do të kishin kontribuar për përparimin e procesit të pajtimit dhe ndërtimit të paqes në rajon, por ndoshta edhe të provojmë të shohim se çfarë mund të bëjmë ne që lajmet e tilla të bëhen të mundshme.



Llogore nga Mostari, me sukses e kanë përfunduar fushatën për mbledhjen e mjeteve për të pajisur dhomën përkujtimore në shenjë të përkujtimit të viktimave të arrestuara në kampin Helidrom në vendin ku ka qenë ai kamp.

Pas të lexuarit bisedë në plenum: Si i keni përjetuar këto lajme? Si u tingëllon kjo dhe pse?

Kohëzgjatja: 30-45 minuta

Drejtësia – falja – e vërteta – pajtimi¹

Pjesëmarrësit/et ndahen në katër grupe të vogla: drejtësia – falja – e vërteta – pajtimi. Kanë për detyrë që të bisedojnë në grup dhe të përgatitin prezantimin në temën: Përse ju si drejtësi (e vërteta, falja ose pajtimi) jeni më kryesorët për procesin e ballafaqimit me të kaluarën? Pastaj grupet një nga një prezantojnë shkaqet dhe pikëpamjet në plenum, ndërsa pjesa tjetër e grupit ka mundësinë t'u parashtojë pyetje njerëzve nga grupi i vogël që kanë të bëjnë me prezantimin e tyre. Pas realizimit të ushtrimit i dobishëm është diskutimi plenar gjatë së cilit janë të mundshme edhe rishikimet e çdonjërit prej nocioneve individuale dhe lidhja e tyre me kontekstet tona shoqërore.

Kohëzgjatja: 60 minuta

¹ Këtë ushtrim e kemi mësuar nga Amela dhe Randy Puljek-Shank.

Drejtësia – falja – e vërteta – paqja

Nga dy pjesëmarrës/e do të formojnë çift të cilët do të marrin për detyrë të theksojnë njërin nga nocionet: drejtësia, falja (mëshira), e vërteta dhe paqja. Këto janë katër elementet e procesit të pajtimit sipas Lederach-ut. Ata kanë dhjetë minuta që të përgatiten dhe të gjejnë argumente se përse nocioni i tyre (drejtësia, falja, e vërteta dhe paqja) është më i rëndësishmi për pajtim.

Pastaj një vullnetar/vullnetare nga grupi ka për detyrë që në mes të dhomës të renditë sipas rëndësisë nga një përfaqësues/e të këtyre elementeve (duke u bazuar në vlerësimin e tij prioritar, se cilin nga elementet e sheh si më të rëndësishëm, deri tek më pak i rëndësishmi). Kur i renditë, pastaj të gjithëve u sqaron se përse e ka bërë atë renditje. Pas kësaj përfaqësuesit me elementeve të pajtimit kanë mundësinë të tregojnë se si e shohin pozitën e tyre, në cilin vend mendojnë se është dashtë të jenë dhe përse?

Në qoftë se, ka kohë të mjaftueshme, mund të jetë interesante që edhe një vullnetar/e të ketë rastin të renditë këto elemente sipas dëshirës, gjegjësisht që procesi të përsëritet, këtë radhë me përfaqësues të tjerë të elementeve.

Në fund pason diskutim i shkurtër në plenum ku duhet t'u kthehemi konteksteve tona (në cilën shkallë kanë arritur këto procese tek ne, çfarë mungon, për çfarë insistohet...)

Kohëzgjatja: 60 minuta



Vërejtje: *Ushtrimi mund të kontribuojë në të kuptuarit më të mirë të këtyre nocioneve, domethënien dhe rëndësinë e tyre, që është veçanërisht e rëndësishme për kontekstet tona, ku këto nocione përzihen ose identifikohen ose shihen si të kundërta. Si që ndodh edhe gjatë realizimit të ushtrimit në një nivel abstrakt, konceptual, e rëndësishme është që të jepet pak kohë për bisedë në plenum dhe rikthim në kontekstin tonë, pasi që me kontekstualizim arrihet të kuptuarit më të mirë të këtyre nocioneve.*

Rekomandohet që nga dy njerëz të përfaqësojnë një nocion nga shkaku se e kanë më lehtë që në procesin e këmbimit të ndërsjellë të përgatiten për realizimin e ushtrimit (në disa grupe detyra mund të jetë shumë e rëndë për një person). Mund të jetë e dobishme që të ofrohet ndonjë kornizë teorike (p.sh. një input i shkurtër rreth të kuptuarit e këtyre elementeve sipas Lederach-ut dhe interpretimet e tij për rolet e tyre në proceset shoqërore), veçanërisht në qoftë se bëhet fjalë për grupim në të cilin ekziston konfuzion i mjaftueshëm rreth këtyre nocioneve.

Kolazh i së kaluarës

Grupi ndahet në tre grupe të vogla. Çdonjëri grup i vogël merr disa mostra të gazetave ditore dhe revistave politike nga vendet në rajon. Kanë për detyrë që të shënojnë titujt, tekstet, fotografitë të cilat në çfarë do mënyre merren me të kaluarën e luftës. Pyetje ndihmëse janë: Cilat janë temat që janë të lidhura me të kaluarën dhe në çfarë mënyre flitet për to (Tribunali i Hagës, krimet e luftës, përkujtimoret...)? Çfarë qëndrimesh dalin në shesh? Si duket imazhi i “tjetrit”?

Pas punës me grupe të vogla prezantohen kolazhet dhe pason diskutimi plenar për imazhet që ofrojnë mediat në lidhje me të kaluarën në vendet e ish Jugosllavisë.

Kohëzgjatja: 60 minuta

Vërejtje: *Ushtrimi është i përshtatshëm kur dëshirojmë të përpunojmë rolin dhe përgjegjësinë e mediave në procesin e ballafaqimit me të kaluarën, por mund të shërbejë edhe si ushtrim hyrës për detektimin e gjendjes në shoqëritë tona sa i përket kësaj çështjeje. Ky ushtrim ka një dinamikë dhe metodë të ndryshme nga shumica e ushtrimeve tjera në këtë temë, dhe mund të jetë i mirë për punë me grupet e të rinjve, ose në momentet kur është e nevojshme që të ndryshohet dinamika e trajnimit, pasi, për shembull, të ketë ardhur deri te lodhja nga diskutimet ose nga këmbimet emotive.*

Thuaje²

Udhëheqësi/ja lut pjesëmarrësit/et të ulen në rreth. Kur ulen të gjithë, vendosen procedurat dhe rregullat e ushtrimit. Udhëheqësi/ja pastaj lexon pyetjen e parë dhe jep përgjigjen për të (jo më të gjatë se 2 minuta). Pastaj kësaj pyetjeje i përgjigjet personi i radhës dhe kështu në rreth. Çdokush ka të drejtë të thotë “tutje”, gjegjësisht nuk është e domosdoshme t’i përgjigjet pyetjes.

Rregullat themelore:

- a) Fol në bazë të ndjenjave dhe përvojave të tua, jo në bazë të teorive dhe qëndrimeve
- b) Përgjigjet duhet të jepen në rreth, jo me paraqitje vullnetare
- c) Vendimi për të mos u përgjigjur në ndonjë pyetje, respektohet plotësisht
- d) Gjithçka që është folur këtu mbetet këtu

Pyetjet e mundshme (në shumicën e rasteve janë të mjaftueshme tre ose katër pyetje për një sesion, në varshmëri nga numri i i pjesëmarrësve/eve, përbërjes së grupit etj.):

Vërejtje: *Qëllimi është që t’u mundësohet pjesëmarrësve/eve që në hapësirë të sigurt të ndajnë njëri me tjetrin disa nga ndjenjat përvojat e mëparshme që kanë të bëjnë me jetën në rajonin e ish Jugosllavisë. Shumë e rëndësishme është të kemi kujdes për kohën gjatë realizimit të këtij ushtrimi – duhet t’u lëmë njerëzve hapësirë për t’u shprehur, por edhe të kemi kujdes që koha mos të tejkalohet shumë.*

² Në bazë të ushtrimit “Telling it” në Mary Fitzduff. Community Conflicts Skills. A handbook for Group Work in Northern Ireland, Botimi i tretë, 1997 fq.20

1. Kur jeni bërë të vetëdijshëm për të parën herë se ekzistojnë dallime mes popujve të cilët jetojnë në ish Jugosllavi?
2. Çfarë ju kanë treguar prindërit që t'ua sqarojnë problemet në lidhje me këtë çështje?
3. Si jeni ndjejë kur është shpërbërë ish Jugosllavia?
4. Kur jeni bërë të vetëdijshëm se ka filluar lufta?
5. A keni qenë ndonjëherë të diskriminuar për shkak identitetit tuaj fetar ose nacional?
6. A jeni ndjejë ndonjëherë të turpëruar ose fajtorë për shkak të identitetit tuaj nacional/fetar?

Pyetjet për diskutim:

- Si jeni ndjerë gjatë ushtrimit?
- Sa vështirë e patët që vetëm të dëgjoni pa të drejtën për të ndërhyrë ose për replikë?
- A u kanë nervozuar ose u kanë bërë konfuz ndonjëra nga deklaratat?

Variacionet: Ky ushtrim mund të realizohet edhe në çifte (pjesëmarrësit/et marrin listën e pyetjeve dhe në to përgjigjen në çifte brenda 10 minutave). Pastaj formohen çifte të me reja dhe bisedojnë njëra me tjetrën 10 minutat e ardhshme. Gjithashtu një listë krejtësisht e re mund të propozohet dhe të shfrytëzohet për dialog grupor nga ana e pjesëmarrësve/eve.

Kohëzgjatja: 90 minuta

Luajtja e roleve – aktorët/et e ballafaqimit me të kaluarën

Me ndihmën e ekipit trajnues, grupi numëron të gjitha grupet shoqërore të cilat janë relevante në jetën publike dhe politike (politikanë/e, gazetarë/e, të rinj, OJQ, bashkësitë fetare, veteranët e luftës, edukatorë/e etj.). Duhet numëruar sa më shumë grupe shoqërore, kështu që çdonjërin ta përfaqësojë një ose dy pjesëmarrës/e. Pastaj pjesëmarrësit/et zgjedhin se cilin grup do ta përfaqësojnë gjatë ushtrimit, duke mbajtur në gjoks letrën me emrin e grupit që “përfaqësojnë”.

Pason pozicionimi në hapsirën e punës edhe atë në raport me qendrën e vendosur e cila paraqet qendrën e të marrurit me ballafaqim me të kaluarën në shoqëritë tona. Pjesëmarrësit/et buhet të pozicionohen në raport me atë qendër varësisht nga ajo se sa mendojnë se grupi i “tyre” merret dhe kontribuon në procesin

ballafaqimit me të kaluarën.]

Çdokush shkurt sqaron se përse e merr mu atë pozicion të caktuar, e pastaj hapet diskutimi rreth asaj se kush çfarë roli ka (ose do të duhet të ketë) në atë proces.

Kohëzgjatja: 45-60 minuta

F j a l o r t h

Përpjekje për të shpjeguar disa nga nocionet të cilat
më së shpeshti shfaqen gjatë ballafaqimit me të kaluarën

Amnistia

Amnistia (nga fjala greke Amnestia, që do të thotë harresë) paraqet akt juridik me të cilin shteti përjashton autorët e veprave penale nga përgjegjësia e mëtejshme ligjore dhe ndjekjes gjyqësore dhe u jep statusin ligjor të personave të pafajshëm. Më së shpeshti është kolektive: i referohet një grupi të caktuar të njerëzve. Në kontekstin e ballafaqimit me të kaluarën bëhet fjalë për mekanizëm që është shumë i kritikuar, veçanërisht nga ana e viktimave dhe aktivistëve/eve për të drejtat e njeriut. Kjo është e çuditshme duke marrë parasysh se shteti u garanton atyre që kanë bërë krime që mos të përgjigjen para gjyqit për atë që e kanë bërë, pikërisht në njëfarë mënyre u falet krimi që e kanë bërë.

Amnistia më shpesh aplikohet në situatat në të cilat është e domosdoshme të ndërpritet dhuna e armatosur e cila një kohë të gjatë kërcënon ndonjë shoqëri, kur bëhet fjalë për një numër të madh të njerëzve (që nuk është e mundshme, e as mençur që të procesohet pasi që një numër i madh i shoqërisë do të përfundojë në gjyq) ose në situatat kur një shoqëri e caktuar domosdo e ka të lë të kaluarën pas dhe të angazhohen për një të ardhme paqësore.¹

Në Afrikën e Jugut është aplikuar një formë specifike e amnistisë: nuk ka qenë kolektive, por për këtë kanë aplikuar individë, dhe ka qenë e kushtëzuar – do ta fitonin ata që do të tregonin gjithçka që dijnë për krimet në të cilët kanë marrë pjesë dhe që do të tregojnë se ato krime kanë qenë të motivuara politikisht. Gjithashtu, organi i cili ka marrë vendimet për amnisti ka qenë Komisioni për të vërtetën dhe pajtimin, dhe ky është shembull i vetëm që një komision i tillë ka pasur aq kompetenca të mëdha. Paralelisht me Komisionin, ka funksionuar edhe prokuroria e shtetit e cila ka udhëhequr hetimin e mizorive. Shumë kryerës të krimeve kundër të cilëve janë kryer hetimet intensive kanë aplikuar për amnisti që të shpëtojnë nga gjykimi. Në qoftë se kryerësi i veprës para Komisionit nuk do tregojë të drejtën e plotë, amnistia nuk do të vlejë për ato krime që nuk i ka pranuar dhe për to do të gjykohej. Edhe pse kjo qasje është kritikuar shumë dhe shpesh dhënia e amnistisë është perceptuar si e padrejtë, ajo që është arritur me ato amnisti është

¹ Gjithashtu, amnistia aplikohet edhe kur ekziston nevoja që të korrigjohet ndonjë dhunë juridike nga e kaluara. Sa i përket rajonit të ish Jugosllavisë, në Serbi në të shumtën e rasteve në mënyrë të përsëritur është deklaruar amnisti për dezertërit dhe kundërshtarët e ndërgjegjshëm (1996-2010). Në Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci dhe Maqedoni janë amnistuar pjesëmarrësit e luftërave, mirëpo ato amnisti nuk kanë përfshirë edhe kriminelët e luftës.

zbulimi i të vërtetës rreth asaj se çfarë dhe si ka ndodhur, ndërsa shumë familje më në fund kanë kuptuar se si kanë përfunduar të afërmit e tyre, ose kanë arritur të marrin informatë rreth eshtrave të tyre.

Pas luftës gjashtëmbëdhjetë vjeçare në Mozambik, e cila është shënuar me torturat e tmerrshme dhe me mizoritë tjera, por edhe me keqpërdorimin e fëmijëve të cilët kanë përfunduar si luftëtarë, është shpallur amnisti e përgjithshme për të gjithë që gjatë luftës kanë bërë vepra jonjerëzore. Mundësia e gjykimit për krime lufte nuk është konsideruar. Ndërsa, mendohet se amnistia është pranuar gjerësisht në vendin ku njerëzit kanë qenë aq shumë të torturuar gjatë luftës, sa që ata më të rëndësishme e kanë patur që të angazhohen për një ardhmëri të re. Një lider fetar kështu e ka shpjeguar raportin ndaj kryerësve të veprave para të cilëve ka qenë kthimi në komunitetin ku kanë bërë krime:

Të treguarit me gisht nuk do të na ndihmojë. Kryerësit e krimeve janë pjesë e jona. Ndërsa ne besojmë se ata nuk kanë dashur të shkojnë në luftë. Ata janë djemtë tanë dhe duam që të na kthehen. Të gjykosh ata do të thotë që ata të vazhdojnë të mbeten banditë.²

Amnistimi i krimit nuk është koncept i famshëm, veçanërisht jo në mesin e atyre që punojnë me të drejtat e njeriut, ndërsa principi i dënimit të kryerësve të krimeve ka mbështetje të gjerë. Por, ka edhe zëra siç është Helena Cobban e cila pretendon se me interesat afatgjata të këtyre shoqërive të rrezikuara më shumë kanë shërbyer politikat e bazuara të amnistisë, pajtimit dhe ri-integrimit të kryerësve.³

T.SH, I.F.

Spastrimi etnik

Spastrimi etnik është term i cili gjatë viteve të nëntëdhjeta të shekullit të kaluar ka hyrë në të folurit politik dhe publik, pikërisht gjatë luftërave në ish Jugosllavi dhe në lidhje me to. Më shpesh në definicionet e lartpërmendura të këtij termi qëndron se spastrimi etnik është politikë e një grupi etnik ose religjioz e krijuar që në mënyrë të dhunshme dhe frikësuese të largojë një grup tjetër etnik ose religjioz. Gjithashtu, përmendet edhe kuptimi tjetër: realizimi i homogjenitetit etnik të ndonjë zone ashtu që me dhunë dhe me frikësim të largojnë pjesëmarrësit e ndonjë grupi nga ajo zonë⁴. Spastrimin etnik përdhunuesit ballkanik e kanë përdorur duke i shfrytëzuar: vrasjet masovike të civilëve, përdhunimet dhe abuzimet seksuale, torturat, bombardimet/granatimet e qyteteve, persekutimet, shkatërrimet e xhamive dhe kishave, konfiskimet e pasurive, dërgimin e njerëzve nëpër llogore dhe krime tjera.

Në literaturë mund të gjendet që ky term të ketë gjenezën nga gjuha serbo-kroate. Megjithatë, përdhunuesit ballkanik nuk janë krijuesit e kësaj praktike. Për fat të keq, ky term ekziston me shekuj, ndërsa pretendohet se daton para erës sonë. Në shekullin 19 si aktorë kryesorë të këtyre krimeve paraqiten shtetet. Statistikat e radhës rreth spastrimit etnik janë

² Afiado Zunguza, cituar në Helena Cobban. *Amnesty After Atrocity. Healing Nations After Genocide and War Crimes* (Boulder, London: Paradigm Publishers, 2007), fq.218.

³ Helena Cobban *Amnesty After Atrocity*.

⁴ Final Report of the United Nations Commission of Experts Established Pursuant to Security Council Resolution 780 (1992), S/1994/674, str.33.

ilustrative: vetëm në Evropë ndërmjet dy luftërave botërore janë “pastruar” 1,5 milion grekë nga Turqia, 400.000 grekë dhe 100.000 bullgarë nga Greqia, 35.000 grekë dhe 67.000 turq nga Bullgaria. Gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj janë “pastruar” 6 milionë hebrenj nga Evropa, 110.000 rumunë nga Bullgaria, 62.000 bullgarë nga Rumunia, 1,2 milionë polakë nga regjioni nën kontrollin e Rajhut Gjerman, 600.000 njerëz të përkatësisë etnike të “dyshimtë” nga regjionet që kanë jetuar në Bashkimin Sovjetik, 14 deri 15 milionë gjermanë nga Evropa Lindore (duke përfshirë edhe Jugosllavinë), 140.000 italianë nga Jugosllavia, 31.000 hungarezë nga Çekosllovakia, 33.000 sllovakë nga Hungaria, 45.000 turq nga Qiproja nga pjesa greke e Qipros, 160.000 grekë nga Qiproja nga pjesa turke e Qipros, më shumë se 300.000 bullgarë nga Turqia⁵. Dhe kjo listë nuk është përfundimtare.

Jennifer Jackson Preece pohon se qëllimi i spastrimit etnik është krijimi i shtetit mono etnik, homogjen ose “të pastër”⁶.

Edhe në aspektin diskursiv ky term është indikativ nëse e kemi parasysh se “spastrimi” është proces i pastrimit nga fëlliqësitat. Nga kjo gjë, ai korrespondon me atë duke i parë pjesëmarrësit e grupeve tjera etnike dhe/ose fetare si diçka të pista dhe diçka që ndotin.

I.F.

Gjenocidi

Gjenocidi nënkupton vepër/krim-e me të cilin një grup (etnik, religjioz, racor ose nacional) duhet shkatërruar. Konventa për ndalimin dhe dënimin e krimit të gjenocidit është miratuar me Rezolutën 260 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara më 09.12.1948, ndërsa ka hyrë në fuqi 12.01.1951. Konventa⁷ i jep definicionin ndërkombëtar juridik nocionit gjenocid, sipas të cilës në gjenocid hynë të gjitha krimet që do të përmendim që kryhen me qëllim që plotësisht ose pjesërisht të shkatërrohet një grup nacional, etnik, racor ose fetar njerëzish: a) vrasja e anëtarëve/eve të atij grupi; b) shkaktimi lëndimeve të rënda fizike ose mentale tek anëtarët e atij grupi; c) kushte jetësore qëllimisht të shkaktuara për atë grup që do të çojnë deri tek shkatërrimi plotë ose i pjesshëm të atij grupi; d) futja e masave në përdorim me të cilat ndërpritet lindja e fëmijëve në atë grup; e) zhvendosja e dhunshme e fëmijëve të atij grupi në një grup tjetër.

Nënshkruesit e kësaj Konvente obligohen që të parandalojnë dhe të dënojnë gjenocidin.

Në tekstin zyrtar të Konventës në mesin e grupeve që mund të jenë viktimat të gjenocidit nuk marrin pjesë grupet politike, dhe pse ka pasur propozim që të përfshihen edhe ato.

Gjenocidi parasëgjithash është krim i planifikuar, i organizuar dhe i koordinuar, ai asnjëherë nuk është i rastësishëm, e as spontan. Karakterizohet me një asimetri të shprehur të fuqisë dhe me një pafuqi të shprehur të viktimave. Një përcaktues i rëndësishëm që një gjë e tillë të klasifikohet si gjenocid është ekzistimi i qëllimit gjenocidal dhe njëkohësisht shumë vështirë është që ligjërisht të dëshmohet. Si formë e shkatërrimit ekstrem ai është vetëm hapi i fundit i kontinuitetit të shkatërrimit. Siç pohon Gregory Stanton bëhet fjalë për një proces i cili zhvillohet në tetë faza: klasifikimi, simbolizimi, dehumanizimi, organizimi, polarizimi, persekutimi, asgjësimi dhe

⁵ Jennifer Jackson Preece. “Ethnic cleansing as an Instrument of Nation-State Creation: Changing State Practices and Evolving Legal Norms.” Në: Human Rights Quarterly 20, 1998: fq. 818-819

⁶ Ibid.

⁷ General Assembly of the United Nations. Convention on the Prevention and Punishment of the Crime of Genocide. Resolution 260 A (III) of 9 December 1948. Në dispozicion në: <http://www2.ohchr.org/english/law/genocide.htm>.

mohimi⁸. Fazat janë të parashikueshme, por nuk janë të pashmangshme. Në çdonjërin prej tyre procesi mund të ndërpritet me masa preventive. Procesi nuk është linear, edhe pse fazave të mëvonshme u paraprijnë domosdoshmërisht fazat e mëparshme. Të gjitha fazat vazhdojnë të veprojnë gjatë gjithë procesit. Vetë aktit të shfarosjes i paraprin propaganda e urrejtjes me të cilën dehumanizohen grupe të caktuara, mobilizohet publiku i përgjithshëm kundër “armikut të përbashkët” dhe arsyetohen masat drastike siç janë shkelja e të drejtave të njeriut, persekutimi dhe vrasjet. Funkcioni i tij është që viktimat e ardhshme të shfarosjes ti shënojë si mbeturina shoqërore për të cilët nuk vlejnë normat e zakonshme morale, duke i paraqitur ata si qenie inferiore ndaj të cilëve nuk duhet pasur parasysh asgjë dhe duke i privuar nga përcaktimet e tyre themelore – nga natyra njerëzore.

Shembujt e gjenocideve në histori janë të numërta, nga gjenocidi ndaj armenëve në fillim të shekullit 20, nga më i famshmi në mesin e tyre, Holokausti, krimet koloniale, e deri tek gjenocidet e fundit të shekullit 20, në Ruandë dhe Srebrenicë.

Termi gjenocidi kulturor nuk është i miratuar me ligj, ndërsa nënkupton tentim për shkatërrim të të gjithë kulturës së një grupi njerëzish. Në histori ekzistojnë një numër i madh i shembujve të gjenocidit kulturor, kur shenjat e një kulture në një vend të caktuar kanë qenë sistematikisht të shkatërruara. Ky term nuk përmendet në Konventën e KB nga viti 1948, edhe pse është mbuluar në vet definicionin ku përmendet transferim i detyrueshëm i fëmijëve në një grup tjetër. Në kohën më të re ky term shpesh ka të bëjë me Tibetin dhe politikën e kolonizimit sistematik dhe shtypjen e popullatës vendase që e zbatojnë autoritete kineze, ka të bëjë edhe me Turqinë juglindore ku shumica janë kurdë dhe atyre u shkurtohen një numër i madh i të drejtave kolektive, nga e drejta për të përdorur gjuhën e kështu me radhë. Për ne një shembull i afërt është edhe ai nga lufta në B dhe H, ku gjatë luftës në territorin që ishte nën kontrollin e Armatës së Republika Serpskës shkatërrohej sistematikisht kultura e boshnjakëve, kështu që sistematikisht minonin xhamitë bile edhe jashtë territoreve të luftës, për të cilën dëshmon fakti se në fund të luftës vetëm një xhami e vetme ka mbetur e pa shkatërruar.⁹

N.V.

Kujtesa kolektive dhe narrativet nacionale

Kujtesa e një individi, gjegjësisht kujtesat individuale nuk janë të izoluar: gjithmonë janë nën ndikimin e rrethit/shoqërisë në të cilin individi jeton¹⁰, por edhe nën ndikimin e “kujtesave kolektive”. Maurice Halbwachs mendon se kujtesa individuale nuk është e mundshme pa fjalë dhe ide, ndërsa këto janë instrumente të huazuara nga shoqëria.¹¹ Kështu që pa rrethin, gjegjësisht shoqërinë, nuk do të kishte as kujtesa kolektive. Gjithashtu, të mbajturit mend është pjesë e identitetit personal, por edhe atij kolektiv.

Kujtesa kolektive është versioni i së kaluarës: që anëtarët e ndonjë shoqërie e kujtojnë. Domosdo përmban simbole, narrative dhe mite. Disa nga kujtesat kolektive kanë kohë të kufizuar dhe ndryshojnë ose ndonjëherë edhe zhduken me ndërrimin e gjeneratave. Por, kjo gjë nuk ndodh

⁸ Gregory H. Stanton. “The 8 Stages of Genocide”. Genocide Watch, 1998. Në dispozicion në: <http://www.genocidewatch.org/genocide/8stagesofgenocide.html>.

⁹ Xhamia në fshatin Baljvine, komuna e Mërkonjiq Grad-it.

¹⁰ Shikoni Maurice Halbwachs. On Collective Memory (Çikago: The University of Chicago Press, 1992).

¹¹ Maurice Halbwachs. “Kujtesa kolektive dhe historike”. Në: Fjala: revista për letërsi dhe kulturë, dhe ç'shtjet shoqërore, nr.56.2, fq.63.

edhe me kujtesën nacionale: ajo zgjat një kohë të gjatë, “është ankoruar në institucionet politike dhe nga “lartë” ndikon në shoqëri”.¹²

Në fakt, në kundërshtim me këndvështrimin e famshëm për kombin si diçka e natyrshme, organike, e mirëqenë dhe e lashtë, kombet janë fenomen socio-kulturor dhe politik. Benedict Anderson kombin e determinon si një “shoqëri të imagjinuar”.¹³ Anthony D. Smith e konsideron si një konstrukt kompleks të cilin e përbëjnë komponentet e ndërlidhura: etnike, kulturore, territoriale, ekonomike, dhe juridiko-politike. Lidhja me të kaluarën, sidomos me të kaluarën etnike për kombin është vendimtare - solidariteti i ndërsjellë i anëtarëve të një kombi të caktuar përcaktohet me përkujtimet, mitet, dhe traditat e përbashkëta, pa marrë parasysh a kanë ose nuk kanë ata shtetin e “tyre”.¹⁴ Vetëdija ideologjike rreth përkatësisë kombëtare përfshin “... një grup kompleks temash për “ne”, “atdheun tonë”, “kombet”, (“tonë” dhe “të atyre”), botën, si dhe moralin e detyrës dhe nderit kombëtar”.¹⁵ Vetëdija ideologjike rreth përkatësisë kombëtare përfshin “... një grup kompleks temash për “ne”, “atdheun tonë”, “kombet”, (“tonë” dhe “të atyre”), botën, si dhe moralin e detyrës dhe nderit kombëtar”.¹⁶ Duke ndjekur shembullin e “rritjes” së kombit gjerman pas gati pesëdhjetë vjetësh të ndarjes në dy shtete, Peter Sloterdijk pohon se kombet, kështu siç i dijmë sot, nuk janë asgjë përveç se efekt i një inskenimi psiko-akustik të përgjithshëm, përmes të cilit rritet ajo që bashkë dëgjohet, që bashkë lexohet, që bashkë shikohet në TV, që bashkë informohet dhe bashkë eksitohet.¹⁷

Sa i përket territorit të ish Jugosllavisë, duhet të kemi parasysh se termi komb parasëgjithash përdoret për grup etnik, dhe jo për shtetas të një shteti të cilët kanë pasaportë të njëjtë; pjesë të grupit të tillë mund të jetojnë në shtete të ndryshme.

Në ligjëratën e tij të lavdishme “Çfarë është kombi?” të mbajtur në vitin 1882, Ernest Renan kombin e definon si princip shpirtëror të cilin e paraqesin trashëgimia e pasur e përbashkët e kujtimeve dhe miratimi i sotëm dhe dëshira për të jetuar së bashku, vullneti për të ruajtur vlerën e trashëgimisë. Ideja kombëtare sipas tij bazohet në të kaluarën heroike, në njerëzit e mëdhenj dhe në lavdinë. Konsideron se kombi është “solidariteti i përmasave të mëdha të cilin e përbëjnë ndjenja e viktimës që e ka përjetuar njeriu në të kaluarën dhe asaj që është i gatshëm të përjetojë në të ardhmen,” dhe se për kujtesën kombëtare shumë më me vlerë është pikëllimi sesa triumfi, ngaqë ai përcakton detyrime dhe kërkon përpjekje të përbashkët.¹⁸ Dubravka Ugrešić vëren se metoda e krijimit të identitetit kombëtar është: terror përmes kujtesës, i cili nuk ka frikë të përdorë megalomaninë nacionale, heroizmin, mitizimin, absurdin, “pra gënjeshtat”.¹⁹

Kujtimet me predikim marrin formën dhe strukturën që e bëjnë atë më stabile.²⁰ Kështu që kujtimi nacional është ndërtuar nga narrativet nacionale, tregimet që janë vazhdimisht të

¹² Aleida Assmann, *Duga senka prošlosti*: „Kultura sećanja i politika povesti“ (Beograd: Biblioteka XX vek, 2011)

¹³ Shiko Benedict Anderson. *Imagined Communities: Reflections on the Origin and Spread of Nationalism* (London, Verso: 1983). Anderson sqaron se komuniteti politik është imagjinuar për shkak se në asnjë rast nacionalitetet më të vogla dhe pjesëtarët e tyre asnjëherë nuk do të njoftohen, takohen, bile as që do të dëgjojnë për shumicën e pjesëtarëve tjerë, fq. 5-7.

¹⁴ Anthony D. Smith. *National Identity* (London: Penguin Books, 1991), fq. 15-16.

¹⁵ Michael Billig. *Banalni nacionalizam* (Beograd: Biblioteka XX vek, 2009), fq.19

¹⁶ Assman pohon se përkujtimi nacional arrihet me pjesëmarrjen në rituale. Assman. *Duga senka prošlosti*, fq.268-269.

¹⁷ Peter Sloterdijk. *Der starke Grund zusammen zu sein Sonderdruck: Erinnerungen an die Erfindung des Volkes*, 2. Auflage (Frankfurt am Main: Suhrkamp, 1998), fq. 27.

¹⁸ Ernest Renan. “What is nation?” Në: Homi Bhabha, ur. *Nation and Narration* (London: Routledge, 1990), fq.19.

¹⁹ Dubravka Ugrešić. *Kultura laži: antipolitički eseji* (Beograd: Fabrika knjiga, 2008), fq. 114.

²⁰ Assman. *Duga senka prošlosti*, fq.24.

pranishme, që sipas rregullave çdo anëtarë i kombit i di, të cilat transferohen nga brezi në brez, nëse është e nevojshme me kohë ndryshojnë (por sipas nevojës edhe harrohen), të cilat e përshkruajnë atë komb, raportin e tij me ndonjë ngjarje të rëndësishme historike, por edhe emocionet e tij. Këto janë tregime të cilat veprojnë si ind lidhor për individë të pa numëruar të cilën ndoshta asnjëherë nuk do to njihen mes veti. Pikërisht, siç thotë Sabrina Ramet:

I përbashkët është narracioni historik, i cili përfshin mitet e përbashkëta, heronjtë e përbashkët, sfidat e përbashkëta dhe urrejtjen e përbashkët, ajo që e lidh një komunitet. Për më tepër, ai është një parakusht për gjendjen e bashkimit kombëtar.²¹

Çdo grup ka narrativet e veta të cilat afirmojnë ndjenjën e unitetit dhe fatet e veçanta të atij grupi. Identitetet nacionale dhe narrativet nacionale krijojnë lidhje të pathyeshme pasi që identiteti ndërtohet, afrohet dhe mirëmbahet përmes narrativeve, ndërsa bashkimi i tyre ndihmon në definimin e kufijve dhe dallimeve mes anëtarëve/eve të një grupi nacional dhe “tjerëve” të cilët perceptohen si të huaj, armiqësor dhe si rrezik për tërë grupin. Narrativet janë të fokusuar në vuajtjet nacionale, në heronjtë nacional dhe në definimin e vlerave dhe normave kyçe me të cilat kombi identifikohet dhe të cilat i promovon.

Njohja e narrativeve nacionale dhe etnike mund të jetë me rëndësi thelbësore për kuptimin e shkaqeve të së kaluarës së dhunshme, por edhe ndërtimin e ardhmërisë në paqe. Sipas Julie Chaitin, në periudhat e konflikteve të gjata, kombet tentojnë që fëmijëve të tyre t’ua mësojnë narrativet e tyre si të vetmet të sakta. Narrativet armiqësore kështu injorohen krejtësisht, ose prezantohen si të gabuara dhe të paarsyetueshme.²²

Narrativet e kundërshtueshme janë veçanërisht problematike dhe potencialisht të rrezikshme në shoqëritë të cilat shërohen nga e kaluara e luftës. Tensioni mes tyre rrezikon në mënyrë serioze përpjekjet për ballafaqimin me të kaluarën dhe ndërtimin e paqes së qëndrueshme. Sa i përket kontekstit, Assman ka krejtësisht të drejtë kur thotë se deri sa zgjat asimetria e kujtimeve dhe të dy palët kanë perspektiva të kundërshtueshme – zgjat edhe lufta²³. Gjegjësisht, të citojmë Ramet:

Kjo nuk do të thotë se në një shtet multinacional narracionet e nacionaliteteve përbërëse duhet të harmonizohen deri në pikën në të cilën bëhen praktikisht identike. Kjo do të thotë se, që të jetë një shtet multi-etnik afatgjatë e stabil, e domosdoshme është që narrativet historike të nacionaliteteve përbërëse të jenë të pastruara nga urrejtja e ndërsjellë, akuzimi dhe fajësimi i ndërsjellë, kështu që nacionalitetet përbërëse nuk miratojnë narrative në të cilat mes veti definojnë si kundërshtarë.²⁴

I.F, T.SH.

Komisionet për të Vërtetën

Komisionet për të Vërtetën janë trupa të cilat i krijojnë qeveritë e atyre shteteve që në të kaluarën e afërt ose të largët janë ballafaquar me: regjime diktatoriale dhe represive; konflikte të armatosura; luftëra qytetare dhe raste të tjera të shkeljes së rëndë dhe masovike të të drejtave të

²¹ Sabrina P. Ramet. “Srpska i hrvatska povijesna naracija”. Në: Anali Hrvatskog politološkog društva, Vol. 3, nr.1, Maj 2007, fq. 300.

²² Julie Chaitin. “Narratives and storytelling in conflicts and conflict resolution”. Intractable Conflict Knowledge Base Website, fq. 8.

²³ Assman. Duga senka prošlosti, fq. 85.

²⁴ Sabrina P. Ramet. “Srpska i hrvatska povijesna naracija”, fq. 302.

njeriut. Komisionet e para për të vërtetën janë krijuar gjatë viteve të 80-ta të shekullit XX në shtetet e Amerikës Latine, ndërsa komisioni më i njohur dhe më me ndikim konsiderohet Komisioni Jugo-afrikan për të Vërtetën dhe për Pajtimin (Truth and Reconciliation Commission - TRC), i krijuar në korrik të vitit 1995. Në disa nga dekadat e mëparshme në të gjithë botën janë krijuar më shumë se 20 Komisione për të Vërtetën, me qëllime, mandate dhe ndikime të caktuara shoqërore. Në kushtet ideale, Komisionet për të Vërtetën duhet të gëzojnë mbështetjen e plotë të autoriteteve ekzekutive, legjislativë dhe gjyqësore që lirshëm të mund të përmbushin mandatin e tyre. Megjithatë, në realitet Komisionet janë nën ndikimin e presioneve të llojeve të ndryshme dhe rrethanave të pafavorshme shoqërore dhe politike të cilat ua vështirësojnë punën, dhe shpesh e bëjnë edhe të pakuptimtë kontributin thelbësor të këtyre Komisioneve, pra punën për të kuptuarit dhe të pranuarit e të vërtetës rreth dhunës nga e kaluara.

Komisionet për të Vërtetën konsiderohen si një nga mekanizmat kryesorë të të drejtës së tranzicionit, ndërsa qëllimet e tyre janë të shumfishta dhe komplekse. Pricilla B. Hayner paraqet pesë detyra/qëllime themelore të Komisionit për të Vërtetën: a) të zbulojë, të zbardh dhe zyrtarisht të pranojë shkeljet e të drejtave në të kaluarën; b) të përgjigjet në nevojat e posaçme të viktimave; c) të kontribuojë për të drejtën dhe përgjegjësinë; d) në pika kryesore të paraqesë përgjegjësinë institucionale dhe të rekomandojë reforma; e) të inkurajojë pajtimin dhe të zvogëlojë mosmarrëveshjet rreth të kaluarës.

Martha Minow, nga ana tjetër, paraqet më shumë qëllime që Komisionet për të Vërtetën janë përprjekur të përmbushin në masë të madhe ose në masë të vogël: tejkalimin e mohimit dhe pranimin publik të krimit; mbledhjen e fakteve dhe sigurimin e minimumit të pranimit të përgjegjësisë dhe dukshmërinë e kryerësve të krimeve; parandalimin dhe transformimin e dhunës; forcimin e bazës së rendit demokratik; mbështetjen e legjitimitetit dhe stabilitetit të regjimit të ri; promovimin e të pajtuarit përgjatë linjave të ndarjes; promovimin e të shëruarit psikologjik; rikthimin e dinjitetit të viktimave; dënimin, përjashtimin dhe turpërimin e autorëve të krimeve; sigurinë që eskalimi i situatës të mos përsëritet asnjëherë; kontributin për ndërtimin e rendit ndërkombëtarë i cili duhet të ndalojë dhe të reagojë ndaj agresionit, torturës dhe krimeve²⁵.

Shumë shpesh krijimi i Komisioneve për të Vërtetën shihet në raport me mundësitë dhe arritjet e të drejtës ndëshkuese në kontekstin e caktuar shoqëro-politik, ndërsa arritjet dhe vlefshmëria e tyre krahasohen dhe vlerësohen në raport me arritjet që i kanë (ose mund t'i kenë) mekanizmat e të drejtës ndëshkuese në atë shoqëri. Për këtë shkak është e rëndësishme të theksohet se Komisionet për të Vërtetën kanë fokus, mekanizma, metodologji dhe procedurë të ndryshme nga ato që përdoren gjatë proceseve gjyqësore të të dyshuarve për krime dhe dhunë nga e kaluara. Dallimi më i madh është fokusimi në viktimat (për dallim nga gjykimet të cilat janë të fokusuara në autorët e krimeve) dhe dëshmia e tyre në punën e Komisioneve për të Vërtetën. Këto Komisione kryesisht marrin dëshmitë e një numri të madh të viktimave dhe të mbijetuarve, të cilat pastaj analizohen me qëllim të identifikimit të modelit themelor në bazë të të cilit kriminelët e luftës janë krijuar, janë urdhëruar, kanë kryer ekzekutimet dhe janë mbuluar. Një element shumë i rëndësishëm i punës së tyre përbëhet nga publikimi i fakteve të mbledhura, qoftë me publikimin e raporteve të vëllimshme siç ka qenë rasti në Brazil dhe Argjentinë, ose me dëshmi publike, si në rastin e Republikës Jugoafrikane. Me këtë viktimat marrin njohje publike për vuajtjet që i kanë përjetuar dhe me këtë parandalohet mohimi i krimeve dhe i të kaluarës, ndërsa në rastet e caktuara zbulimet e Komisioneve shërbejnë si nxitje për të filluar procedurat gjyqësore kundër përgjegjësve të krimeve.

²⁵ Martha Minow. *Between Vengeance and Forgiveness. Facing History after Genocide and Mass Violence* (Boston: Beacon Press, 1998), fq. 88.

Si të gjitha mekanizmat e ballafaqimit me të kaluarën, ashtu edhe krijimi dhe punën e Komisioneve për të Vërtetën e ndjekin një numër i madh i dilemave dhe polemikave prej të cilave më të shpeshtat janë – Në çfarë raporti janë zbulimi dhe pajtimi, gjegjësisht, a çon e vërteta drejt pajtimit? Sa është i arsyeshëm supozimi se “gërmimi i së vërtetës dhe ofrimi i mundësive që viktimat të flasin sjell një përvojë shëruese dhe “purgative”²⁶? Sigurisht, kontroversi më i madh që ka ndjekur punën e shumë Komisioneve për të Vërtetën ka të bëjë me lidhjet e këtyre trupave me ndarjen e *amnistisë* përgjegjësve për krimet dhe llojeve të ndryshme të dhunës nga e kaluara.

Në rajonin e ish Jugosllavisë ekziston iniciativa për krijimin e komisionit rajonal e cili do të kishte për qëllim përcaktimin e fakteve për krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut të bëra nga viti 1991 e deri në vitin 2001. Pas këtij qëndron koalicioni të cilin e përbëjnë një numër i madh i organizatave të shoqërisë civile në rajon.²⁷ Aktualisht duket e pamundshme që shtetet në rajon të mbështetin këtë iniciativë dhe të krijojnë një komision të tillë, mirëpo, koha do të tregojë të veten.

T.SH.

Faji dhe përgjegjësia

Faji dhe përgjegjësia janë nocione, që në botën post-jugosllave shumë, shumë shpesh barazohen, pjesërisht për shkak se njerëzit jo shumë rrallë janë konfuz, por edhe për shkak se turbullimi i këtyre nocioneve është shumë i dobishëm për shumë narrative dhe mite nacionaliste, dhe ne jemi edhe dëshmitarë të fajësimit të të gjithë kombeve për luftë dhe krime. Shembull më plastik janë parullat: “Ne të gjithë jemi Ratko Mlladiq”, në versionin serb, gjegjësisht, “Ne të gjithë jemi Mirko Norac” në versionin kroat, ku grupe të caktuara njerëzish kanë shprehur solidaritet me gjeneralët e akuzuar për krime lufte në Tribunalin Penal Ndërkombëtar për Krime Lufte në Hagë. Kjo shprehje e solidaritetit dhe ky ekzaltim i të akuzuarve shkon paralel me mohimin e krimeve të bëra dhe arsyetimin e tyre. Ndërsa, një qasje e tillë kontribuon në ruajtjen dhe të ushqyerit e mëtejshëm të paragjykimëve dhe imazheve të armiqve në të gjitha anët, si dhe të atmosferës së mosbesimit dhe frikës. Dhe definitivisht kontribuon në krijimin e një atmosfere, siç tha Hannah Arendt: “Nëse të gjithë jemi fajtor, atëherë askush nuk është fajtor”²⁸.

Në vitet e dyzeta të shekullit të kaluar, pas Luftës së Dytë Botërore, filozofi gjerman Karl Jaspers duke e shqyrtuar çështjen e fajit dhe duke u ballafaquar me përgjegjësinë personale për regjimin nazist dhe krimet e tyre, ka theksuar se duhet të dallojmë katër nocione për fajin²⁹:

1. Përgjegjësinë penale, që bartin kryerësit e krimit.
2. Fajin politik, që e bartin qytetarët e një shteti, pasi që “çdo njeri bart një pjesë të përgjegjësisë për pushtetin”³⁰, vetëm për shkak se kanë lejuar që ai regjim të ekzistojë.
3. Fajin moral, që e bart çdo individ për veprimet e tij, madje edhe kur bëhet fjalë për zbatimin e urdhrave. Ai varet nga të ekzistuarit e ndërgjegjes dhe pendimit. Jaspers thotë

²⁶ Pricilla B. Hayner. Neizrečive istine: Suočavanje sa državnim terorom i zverstvima (Beograd: Semizdat B92, 2003), fq. 21.

²⁷ Për më shumë informata shikoni internet faqen Koalicije za REKOM: www.zarekom.org.

²⁸ Hannah Arendt. “Kolektivna odgovornost” në: Daša Duhaček dhe Obrad Saviq (ur.), Zatočnici zla: Zaveštanje Hane Arent (Beograd: Beogradski krug, 2002), fq. 19.

²⁹ Shih Karl Jaspers, Pitanje krivice (Beograd: SamizdatFreeB92, 1999).

³⁰ Ibid, fq. 21.

se moralisht kanë faj “ata të cilët janë të aftë për pendim, ata të cilët e kanë ditur ose kanë mundur të dijnë, por përsëri kanë ecur rrugës të cilën gjatë vetreflektimit e shohin si një lajthitje të gabuar – qoftë të kenë mbyllur sytë lehtëazi përpara asaj që ndodh; ose ia kanë lejuar vetes që të jenë të dehur dhe të mashtruar; ose kanë qenë të blerë me privilegjet që ua ka sjellë kjo gjë; qoftë t'i jenë nënshtruar frikës”³¹.

4. Fajin metafizik, që është krijuar me ekzistimin e solidaritetit mes njerëzve për shkak të së cilës jemi me përgjegjësi për ekzistimin e padrejtësisë në botë. Jaspers sqaron: “Në qoftë se nuk bëj gjithçka me fuqinë që kam që t'i ndal ata, atëherë edhe vet jam pjesërisht fajtor.”³²

Në fushën e ndërtimit të paqes, nocioni faj më shpesh ka të bëjë me llojin e parë të ndarjes sipas Jaspers: fajtor mund të jetë vetëm ai i cili ka bërë ndonjë punë të keqe/krim (ku merr pjesë edhe dhënia e urdhrave që një krim të bëhet, bashkëpunimi, fshehja e kryerësit, edhe veprat tjera të definuara me ligj). Nuk ekziston faji kolektiv. Mirëpo, përgjegjësia kolektive ekziston: përgjegjësia e një shoqërie/komuniteti për ndodhitë në atë shoqëri. Pikërisht, siç ka shkruar shkrimtari izraelit Amos Oz: *Asnjëherë nuk kam besuar në fajin kolektiv, dhe këtë e konsideroj si koncept monstruoz, por besoj në përgjegjësinë kolektive. Faji dhe përgjegjësia sigurisht që janë dy koncepte të ndryshme. Faji kërkon shpagim, ndërsa ndonjëherë edhe dënim. Përgjegjësi do të thotë nevojë për korrigjim, ndreqje ose kompensim të dëmit të shkaktuar ndaj viktimave të krimit që e kanë bërë grupet ose kolektivet.*³³

Si individë përgjegjës jemi për atë se kush na përfaqëson në jetën politike, çfarë ligjesh kemi, cilat vlera janë të përfaqësuara, cili është raporti ndaj minoriteteve dhe grupeve të marginalizuara, sa është shkollimi i kapshëm, etj. Dhe sigurisht që bartim përgjegjësi edhe për luftën (çfarë kemi bërë që ta ndalojmë?) dhe për paqen (çfarë bëjmë që vetes dhe fqinjëve t'u sigurojmë jetë në paqe?).

I.F.

Kultura dhe politika e përkujtimit

Politika e përkujtimit përcakton një kornizë vlerash dhe kornizë ideologjike të të kujtuarit kolektiv, ajo më së shpeshti është prodhim i linjës dominante brenda diskursit të të kujtuarit kolektiv të një grupi të caktuar, që është “imazhi hegjemon të cilin e imponon grupi në pushtet”.³⁴ Në rajonin tonë, në raste të rralla, ka edhe shembuj të vendosjes së formave alternative të politikës së të kujtuarit të cilat, kryesisht konfrontohen me atë dominanten në nivel vlerash. Politika e të kujtuarit ka për qëllim të shkruaj horizontet e të kujtuarit, të caktojë dhe të emërojë ngjarjet qendrore të epokës së tyre dhe të definojë në bazë vlerash dhe si pasojë e kësaj të artikulojë mësimin për të ardhmen të cilën shoqëria duhet ta mbajë mend. Deri më tani nuk është e pazakontë të ekzistojnë politika të ndryshme të të kujtuarit: në shoqërinë në të cilën ekziston mundësia e të shprehurit të lirë ekzistojnë përcaktime të ndryshme ideologjike dhe vlerësore të shprehura publikisht. Në kundërshtim me këtë, regjimet autoritare nuk durojnë ekzistimin e

³¹ Ibid, fq. 50.

³² Ibid, fq. 22.

³³ Amos Oz, „Krivica i odgovornost“, u: Reč, 9 qershor 1999. Në dispozicion në: www.b92.net/casopis_rec/arhiva/oz.html.

³⁴ Todor Kuljić. Kultura sećanja: teorijska objašnjenja upotrebe prošlosti (Beograd: Čigoja štampa, 2006), fq. 9.

diskurseve të ndryshme. “E kaluara është instrument i qeverisjes, pasi që tregimet forcojnë autoritetet dhe formojnë kuptimin social.”³⁵

Ekzistojnë më së paku dy mënyra të mundshme të të kuptuarit të kulturës së përkujtimit. Mënyra e parë do të ishte ajo e cila nënkupton se kultura e përkujtimit është e mbushur dhe e caktuar me përmbajtjet ideologjike dhe sipas tyre mund edhe të kategorizohet. Mënyra e përdorimit të përkujtimit për krijimin e të tashmes përcaktohet prej interesave me të cilat udhëhiqen grupet të cilat janë aktorët e përkujtimit. Ky kuptim i kulturës së përkujtimit është shumë i afërt me nocionin “politikat zyrtare të përkujtimit”.

Mënyra tjetër e të konceptuarit nënkupton një largim më të madh nga vet përmbajtja e politikës së përkujtimit dhe përshkruan mënyrat që i mbajmë mend si shoqëri, kolektiv. Grupet e ndryshme kanë narrative të ndryshme dominante, si përmbajtje të thjeshtësuara dhe të përgjithsuara të kujtimeve dhe me këtë edhe politika të ndryshme të përkujtimit, edhe pse mund t'i takojnë matricës së njëjtë kulturore, d.t.th. kulturës së njëjtë të përkujtimit. Ata modele mund të jenë marrë në mënyrë jo kritike nga koha e dominimit të ideologjisë e cila është mposhtur dhe të cilën politika në kohën e sodit e definon si të dëmshme dhe armiqësore. Deri më tani kultura e përkujtimit është e pavarur nga politika e përkujtimit, ajo është një përmbledhje e formave përmes të cilave zbatohet politika e përkujtimit dhe në sajë të së cilës mund të ekzistojnë përmbajtje konfliktuoze reciproke. Një shembull për këtë mund të jenë përmendoret e heronjve kombëtar nga luftërat e viteve të nëntëdhjeta, ku në anë të ndryshme festohen dhe u bëhet lavd individëve të cilët në anën tjetër përjetohen si kriminelë lufte. Forma është e njëjtë, modeli kulturor është identik, rrethi folklorit është i përgatitur në të njëjtën mënyrë, por vetëm përmbajtja ka ndryshuar pak, kështu që kriminelin e luftës të një përkatësie etnike, në një hapësirë tjetër e zëvendëson kriminelin tjetër i luftës, sipas origjinës së përshtatshme. Në korniza të tilla mund të thuhet se në shtetet e ish Jugosllavisë kultura e përkujtimit është automat shtetërorë që duke shtypur butonat e ndryshëm nxjerr kartelat e pikturuara me motive të ndryshme, nga autorë të ndryshëm, mirëpo të autorëve të cilët janë shkolluar në të njëjtin vend, kartelën e shtypur në të njëjtën mënyrë, në materialin e njëjtë, madhësinë e njëjtë, me të njëjtin afat të përdorimit dhe që konsumohet në të njëjtën mënyrë.

Kultura e përkujtimit, vetvetiu, ka ndikim të kufizuar në politikën e përkujtimit, dhe kështu disa modele alternative kulturore të cilat devijojnë nga ajo dominantja, si p.sh. aksionet e komemoracioneve në vendet e ndaluara³⁶ ose poezi të cilat tematizojnë vuajtjet e luftës, mund të jenë të marra edhe nga ana e atyre që ushqejnë urrejtjen. Vet modeli kulturor i cili përdoret nuk e përcakton përmbajtjen e përkujtimit kolektiv.

N.V.

Lustrimi

Fjala lustrim rrjedh nga gjuha latine *lustratio*, që do të thotë pastrim.

Kuptimi modern politik i nocionit lustrim lidhet me njërën nga mënyrat me të cilat shoqëritë të cilat kanë pësuar shkelje brutale dhe afatgjate të të drejtave të njeriut, krime lufte masovike dhe ngjashëm, mund të ballafaqohen me të kaluarën e tyre dhe të tejkalojnë trashëgiminë e saj të rëndë. Është përcaktim i përhapur se lustrimi nënkupton mohimin e të drejtës civile që si

³⁵ Ibid, fq. 10.

³⁶ Vende në të cilat autoritetet lokale nuk lejojnë ngritjen e përkujtimeve të viktimave.

përfaqësues politik të zgjidhen dhe/ose të marrin funksion shtetëror ata persona të cilët kanë mbështetur ose me veprimet e tyre kanë shkaktuar krime dhe shkelje të të drejtave të njeriut. Si shembuj të shteteve të cilat kanë zbatuar lustrimin në funksion të shkëputjes nga regjimet e mëparshme, më së shpeshti përmenden shtetet e të aq. Bllokut Lindor: Republika Demokratike e Gjermanisë, Çekia, Sllovakia, Polonia.

Stevan Lilliq, profesor i Fakultetit të Drejtësisë, konsideron se lustrimi është “kategori etike, që ka të bëjë me përcaktimin e përgjegjësisë për mbështetjen e politikës represive të ndonjë regjimi. Lustrimi as nuk nënkupton e as nuk përjashton format e tjera të përgjegjësisë”.³⁷ Sipas fjalëve të Zharko Puhovskit:

*Lustrimi nuk është dënim në aspektin gjyqësor të fjalës pasi që ai, sipas supozimit, duhet bërë në vende të tjera. Lustrimi duhet të nënkuptojë diskualifikim moral dhe publik të njerëzve të cilët kanë përkrahur, por në të njëjtën kohë nuk u është kërcënuar jeta, regjime që kanë sjellë të keqen.*³⁸

Si përparësi për lustrimin shpesh vendoset dimensionin e tij etnik dhe psikologjik që ndihmon të formohet një linjë kufizuese në bazë të periudhës paraprake historike që shënon shkeljen e rëndë të të drejtave të njeriut. Lustrimi mund të ndihmojë qeverinë e re të fitojë kredibilitet dhe legjitimitet, të bëjë një distancë të qartë në raport me regjimin paraprak dhe të fillojë një periudhë të re të bazuar në sundimin e ligjit dhe demokracisë.

Ankesa më e rëndësishme në procesin e lustrimit ka të bëjë me pamundësinë e verifikimit dhe zbatimit të kriterëve të qarta³⁹ në bazë të të cilave dikush duhet t'i nënshtrohet lustrimit. Vështirësia në zbatimin e lustrimit është domosdoshmëri për t'u mbështetur në informatat e grumbulluara në periudhën e regjimit totalitar, besueshmërinë dhe saktësinë e të cilit është vështirë për ta konfirmuar qartë. Si mekanizëm i thirrjes kolektive për përgjegjësi mund të jetë mjet revanshimi i projektuar nga informatat e pakontrolluara dhe të paverifikuara, të kap njerëz të pafajshëm dhe të thellojë humnerën ndërmjet grupeve antagoniste që mund të jetë fatale për ardhmërinë e asaj shoqërie/komuniteti.

T.SH.

Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë (TPNJ)

TPNJ është themeluar në vitin 1993 nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara si përgjigje ndaj shkeljes masovike të të drejtave të njeriut dhe krimeve masovike gjatë luftërave të zhvilluara në territorin e ish Jugosllavisë. Selia e gjykatës gjendet në Holandë, në Hagë, dhe është themeluar si gjykatë *ad hoc*, e cila është planifikuar që të ndërpresë punën në fund të vitit 2014.

Nën juridiksionin e kësaj gjykate gjenden personat më të përgjegjshëm për projektimin, urdhërimin dhe zbatimin e krimeve të luftës të kryera gjatë periudhës së viteve 1991-2001 në territorin e Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë, Kosovës dhe Maqedonisë. Aktakuzat janë ngritur kundër më shumë se 160 personave, ndërsa fokusi kryesor ka qenë në procesimin e personave që kanë gëzuar pozicionet më të larta ushtarake dhe shtetërore. Deri më tani janë gjykuar më shumë se 60 persona për krimet që i kanë kryer, ndërsa kundër 30 personave ende

³⁷ Stevan Lilliq, “Lustracija da ili ne?”. Nē: Danas, 06.11.2001.

³⁸ Cituar në Sabina Çabaravdiq, “Lustracija izostala na Balkanu.” Radio Evropa e Lirë, 25.10.2010, në dispozicion në: www.slobodnaevropa.org/content/tema_sedmice_lustracija/2050239.html.

³⁹ Në Serbi ekziston ligj i cili asnjëherë nuk është zbatuar vetëm për këtë shkak.

zhvillohen procese të cilat janë në faza të ndryshme.⁴⁰ Aktakuza kundër personave të aq. të rangut të mesën pas ndërprerjes së punës së Tribunalit do të trajtohen në gjykatat shtetërore për krime lufte në rajonin e ish Jugosllavisë.

Nga vet themelimi, Tribunali ka provokuar reagime kontradiktore në opinionin publik të shteteve në rajonin e ish Jugosllavisë. Mbështetja e punës së tij nga qeveritë e shteteve ka qenë shpesh e dobët ose jo aq e hapur dhe transparente. Nga ana tjetër, kritikën kanë ardhur nga burime të ndryshme – nga ato nacionaliste, të cilat punën e Gjykatës e kanë shikuar vetëm si kanosje ndaj popullit të vet, e deri tek ato nga qarqet e ekspertëve juridik dhe të tjerë të cilët kanë konsideruar se në realizimin e detyrave të TPNJ janë bërë shumë lëshime dhe vendime të këqija që nuk falen.

Në Tribunalin e Hagës si arritje shihen: thirrja e udhëheqësve në përgjegjësi (në lidhje me këtë edhe ndërprerja e traditës së mosndëshkimit për krimet e luftës); insistimi në realizimin e drejtësisë për viktimat dhe krijimi i hapësirës që të dëgjohet zëri i viktimave; mbledhja e fakteve për krimet e bëra; zhvillimi i të drejtës ndërkombëtare; forcimi i sundimit të drejtësisë.⁴¹ Gjithashtu si sukses shënohet edhe fakti se janë kryer të gjitha urdhrat për arrestim që janë lëshuar ndonjëherë nga TPNJ. Tribunali gjithsesi ka bërë një hap përpara në të drejtën ndërkombëtare duke pranuar përdhunimin dhe dhunën seksuale në luftë si një formë torture, gjegjësisht krim lufte.

Kritikën e punës së Tribunalit kanë të bëjnë me: pëlqimin e perceptuar politik në bazë të paragjytimeve etnike, komunikimin e vonuar dhe të pamjaftueshëm me publikun e shteteve post-jugosllave, mos kënaqësia me politikën penale (veçanërisht të shprehur ndërmjet viktimave të mbijetuara të luftës që shumë dënime i konsiderojnë si joadekuate dhe të shkurtra); mungesa e kontributit të transformimit demokratik të shoqërive në rajonin e ish Jugosllavisë; ngecja në punën dhe ndjeshmërinë e ndikimeve të ndryshme politike.

T.SH.

Vendet e përkujtimit dhe memorializimi

Vendet e përkujtimit nënkuptojnë edhe ata vende në të cilat ka ardhur deri tek vuajtja, si dhe ata vende të cilat janë ndërtuar dhe/ose rregulluar me qëllim të ruajtjes së kujtimit për ndodhitë e vështira nga e kaluara.

Memorializimi, në kuptimin e ngushtë të fjalës, ka të bëjë me shënimin e një hapësirë publike me materiale të cilat do të na përkujtojnë (përmendore, muze, pllaka përkujtimi etj) ngjarje të rëndësishme nga e kaluara, gjegjësisht ndodhitë kryesore historike ose figura të rëndësishme në kontekst të hapësirës gjeografike në të cilën ndodhen. Në kuptimin e gjerë të fjalës, ajo përfshin edhe format tjera të materializimit të përkujtimit publik: krijimtaritë kulturore (literaturë, film, art, muzikë etj.), shënimin e ditës së përkujtimit, etj. Memorializimi ka për qëllim materializimin e përkujtimit kolektiv të kohës në të cilën ndodh, dhe ndërtimin e përkujtimit të përhershëm kolektiv të ngjarjes dhe periudhës së caktuar historike në të ardhmen.

Memorializimi është formë e institucionalizuar e përkujtimit, i cili reflektohet si diskurs historik dominant, dhe kështu me formën e tij cakton edhe përkatësinë e kulturës së përkujtimit dhe kohës që i takon.

⁴⁰ Infomata nga faqet zyrtare të GJPNJ: www.icty.org/sections/OMKSJ

⁴¹ Sipas të dhënave nga faqja e internetit GJPNJ, www.icty.org/sid/324.

Përmendoret paraqesin një shenjë, rezultat të politikës së përkujtimit, ato janë fryt i diskursit dominant dhe rezultojnë me vullnetin politik, duke u angazhuar dhe/ose duke u konsultuar në procesin e projektimit, me dëshmitarë, viktimë, artistë/e, politikanë/e dhe me publikun.

Për dallim nga gjuhët tona, në gjuhën gjermane ekzistojnë nocione të ndryshme për përmendoret të cilat janë ngritur në emër të përkujtimit të arritjeve të caktuara dhe/ose personave me meritë - *Denkmal*⁴² dhe përmendoreve roli i të cilave është të na përkujtojnë dhe të na paralajmërojnë ngjarjet e këqija – *Mahnmal* (pralajmëruese).

N.V.

Falja

Falja është termi i cili mbase shkakton më së shumti polemikë/kontroversitet, veçanërisht në rastet kur bëhet fjalë për dhunë në përmasa të mëdha ose për gjenocid. Bëhet fjalë për një koncept rreth të cilit edhe në të aq. opinion profesional nuk ekziston konsensus se çfarë kuptimi ka saktësisht dhe çka nënkupton. Shpesh e njësojnë me pajtimin. Disa thonë se pa falje nuk ka pajtim dhe paqe të qëndrueshme, disa thonë se është jo morale që të pritët të falin ata të cilët kanë përjetuar vuajtje të mëdha ose kjo gjë është e pamundshme, disa faljen e konsiderojnë si koncept religjioz i cili është i zbatueshëm vetëm në komunitetet religjioze, etj.

Është interesante se falja si koncept nuk është i përpunuar, edhe pse ekziston në religjionet e shumta me traditë shumë shekullore, ndërsa tek disa është edhe njëra nga vlerat themelore; në ato monoteiste: judaizëm, islam dhe krishterizëm. Edhe atë duke filluar nga të kuptuarit e Zotit i cili është i mëshirshëm dhe i cili fal. Në Kur'an, falja përmendet në shumë ajete, në krishterizëm ekziston besim se falja ne na afron afër Zotit, ndërsa në judaizëm aftësia për të falur hyn në kualitetet hyjnore. Prandaj, këto religjione kanë një potencial të madh për promovimin e konceptit të faljes. Mirëpo, në religjionet mund të arrihet përshtypja se koncepti i pranishëm i faljes padyshim që shpesh zbatohet në mënyrë selektive kur bëhet fjalë për ata që ndjehen si armiq, gjegjësisht për ata që nuk besojnë ose për jobesimtarët. Edhe një kritikë e këtij koncepti religjioz është se falja, nga ana tjetër, shumë lehtë mund të bëhet mjet me të cilin sipas nevojës qetësohen dhe pacifikohen besimtarët të cilët mund të ankohen për shkak të ndonjë padrejtësie⁴³.

Kërkimi i faljes dhe pendimi shpesh njësohen dhe vihen në shenjë e barazimit. Johan Galtung në mënyrë të thjeshtë përshkruan se ku është dallimi.

“Kërkoj falje.” = “Do të doja që të mos e kisha bërë këtë dhe premtoj: nuk e bëj më.”

“E pranoj faljen tënde.” = “Të besoj, shkojmë tutje.”

“Të lutem, më fal.” = “Të lutem çliromë nga ndjenja e fajit që kam ndaj teje.”

“Të fal.” = “Me këtë të çliroj nga ndjenja e fajit që ke ndaj meje.”⁴⁴

Galtung pastaj shënon se është e domosdoshme që kryerësi në ndonjë mënyrë të meritojë që t'i falet. Minow konsideron se falja pa ndonjë arsye të mirë do të thotë pranim të deliktit mbi veten dhe devalvim të vetes⁴⁵. Shpesh pendimi i singertë është ajo që konsiderohet si parakusht.

⁴² Në përkthimin e thjeshtë *denk-mal*, do të thotë “mendime” (*denken* = të mendosh)

⁴³ Shiko Mark Gopin. “Forgiveness as an Element of Conflict Resolution in Religious Cultures: Walking the Tightrope of Reconciliation and Justice.” Në: Mohammed Abu-Nimer, ur. *Reconciliation, Justice and Coexistence: Theory and Practice* (Lanham: Lexington Books, 2001): fq. 87-89. Sipas të dhënave nga faqja e internetit GJPNJ, www.icty.org/sid/324.

⁴⁴ Johan Galtung. “After Violence, Reconstruction, Reconciliation, and Resolution: Coping with Visible and invisible Effects Of War and Violence.” Në: Mohammed Abu-Nimer, ur. *Reconciliation, Justice and Coexistence*, fq. 7.

⁴⁵ Martha Minow. *Between Vengeance and Forgiveness*, fq. 17.

Ndoshta është rëndë që t'ia falish dikujt që nuk pendohet për krimin e vet, ndërsa falja është më se e kuptueshme në qoftë se kryerësi pendohet. Kjo vlen për situatat bardh e zi, gjegjësisht kur vet e perceptojmë si bardh e zi: viktima është viktimë, ndërsa kryerësi është kryerës (ndarja e tillë do ta bënte jetën dhe gjykimin më të thjeshtë). Mirëpo, shpesh konteksti është pak më, ose shumë më kompleks, dhe mund të ndodh që kryerësi paraprakisht të ketë qenë viktimë e viktimës së tanishme, ose ka perceptimin se ka qenë viktimë pasi që anëtarët e grupit të cilit i takon, kanë qenë viktima, ose ka qenë i detyruar të bëjë krim, ose nuk ka qenë i vetëdijshëm se akti i tij caktuar do të ketë pasoja të tilla, gjegjësisht nuk ka pasur qëllimin të bëjë krim, por rrethanat kanë qenë të tilla, etj. Bile edhe në këto situata, kur bëhet fjalë për dhunë të tmerrshme dhe/ose humbje të madhe, mund të jetë mjaft e kuptueshme që viktima nuk mund të fal.

Shumica faljen e kuptojnë si proces i cili ndodh ndërmjet viktimave të dhunës dhe kryerësit. Mirëpo, Andrew Rigby pohon se bëhet fjalë për një proces individual i cili nuk kërkon pjesëmarrje të atyre që kanë bërë krim, gjegjësisht kryerësit nuk ka nevojë as të dijnë për të⁴⁶. Në fakt, të kuptuarit e tij për faljen është pak më “i çlirët”, për të ky është proces i cili ndodh kur njerëzit për shkak të paqes gjejnë mënyrën të dalin në krye me humbjen e tyre, kur bëhen të gatshëm të vazhdojnë jetën, të lënë të kaluarën dhe të harrojnë dëshirën për hakmarrje. Ai konsideron se është e nevojshme që të kalojë një kohë që njerëzit të fillojnë të zhvillojnë kapacitet për falje, edhe atë pikë së pari “t'ia falin të kaluarës” në kuptimin e tejkalimit të urrejtjeve të vjetra dhe dëshirës “për të pastruar hesapet”, dhe si rritet kapaciteti që t'ia falin “tjetrit”, do të zbulojnë shenjat njerëzore tek ata të cilët i kanë urreyer dhe përbuzur. Përkatesisht, Rigby pohon:

Në mesin e këtij procesi të rëndë shtrihet aftësia që të bëhet dallimi ndërmjet kryerësit dhe veprave të tij, ndërsa kjo përsëri kërkon njohjen e njerëzisë së tjetrit, sado e vështirë të jetë ajo. Por, në të njohurit e vetes dhe të tjetrit i qenie njerëzore qëndron fara e ardhmërisë së përbashkët⁴⁷.

Me këtë falja është proces i cili shkon paralelisht me pajtimin, gjegjësisht me disa pjesë të tij janë të ngjashme, siç thotë Ugo Vlasisavljeviq: “pajtimi nuk do të thotë asgjë tjetër përveç se përbindëshit t'i japësh formën e njeriut.”⁴⁸

I.F.

Pajtimi

Pajtimi është njëri nga termet themelore që përdoren në kontekst të punës me ballafaqimin me të kaluarën. Gjithashtu, bëhet fjalë edhe për termin që shkakton mospajtim dhe polemikë, si në mesin e teoricienëve/eve, ashtu edhe në mesin e praktikantëve/eve, d.m.th. aktivistëve/eve në mbarë botën që veprojnë në shoqëritë të cilat shërohen nga shkelja masovike e të drejtave të njeriut nga e kaluara. Siç vëren David Bloomfield, rëndësia e këtij koncepti është e njohur përgjithësisht, ndërsa në të njëjtën kohë ekzistojnë mospajtueshmëri të shumta rreth asaj se çfarë kuptimi ka në fakt pajtimi, dhe në çfarë mënyre është i lidhur me konceptet dhe proceset tjera siç janë drejtësia, ndërtimi i paqes, demokratizimi dhe zhvillimi politik.⁴⁹

⁴⁶ Andrew Rigby. “Forgiving the Past: paths towards a culture of reconciliation.” Paper presented at the IPRA Conference. Tampere, Finland: August, 2000.

⁴⁷ *Ibid.*

⁴⁸ Ugo Vlasisavljeviq. “Pomirenje kao najveća opasnost.” Ligjeratë e mbajtur në Bllagaj, BdeH, 19.06.2011 në korniza programiot “Korak dalje u izgradnji mira. Vrednosti i prakse”. Shiko dokumentacionin e modulit “Triba li nam pomirenje? Mogućnosti, prepreke, izazovi.” Qendra për Aksion të Padhunshëm, 2011.

⁴⁹ David Bloomfield. “On Goods Terms: Clarifying Reconciliation”. Në: *Berghof Report* nr. 14, tetor 2006, fq. 3.

Dilema e parë ka të bëjë me thelbin e konceptit të pajtimit – a bëhet fjalë për procesin, ose për rezultatin përfundimtar të proceseve të ndryshme në shoqëri? Në qoftë se pajtimin e kuptojmë si një proces, pyetja tjetër është se çfarë tjetër përfshin ai proces dhe në cilën kornizë kohore? Duke e kuptuar si rezultat ose si gjendje përfundimtare pas disa proceseve, çështja e pajtimit hap dilema të reja rreth asaj se si duket një “shoqëri e pajtuar”, si e dimë se e kemi arritur atë qëllim, si mund ta matim nivelin e pajtimit, dhe sa është reale që të vendosim një qëllim të tillë?

Grupi i dytë i pyetjeve lidhet me të kuptuarit e konceptit dhe procesit të pajtimit në nivel vlerash – a është ai njëri nga parakushtet e domosdoshme të shërimit politik dhe zhvillimit demokratik të shoqërive të ndara? A mundet me të njëjtin sukses të zbatohet edhe në nivelin interpersonal edhe në atë kolektiv? A është e domosdoshme që si element të patjetërsueshëm të ngërthejë edhe termin kontrovers *faljen*? A ndodh pajtimi në bazë të kuptuarit të së vërtetës dhe arritjes së nivelit të kënaqshëm të drejtësisë për viktimat e llojeve të ndryshme dhunës nga e kaluara?

Të kuptuarit e konceptit të pajtimit, që janë të përafërta me kontekstin e ndërtimit të paqes, theksin e vendosin në ndërtimin e marrëdhënieve në shoqëritë në të cilat ekzistojnë linja të mprehta të ndarjeve. John Paul Lederach, pajtimin e kupton si proces i cili ndërton dhe tenton të shërojë “fijet e shkëputura dhe marrëdhëniet mes individëve edhe në komunitetin e gjerë”⁵⁰. Procesi i pajtimit është i drejtuar kah e ardhmja. Sipas Lederach, detyra dhe kontributi kryesor i pajtimit është “të kërkuarit e mënyrave inovative për të krijuar kohë dhe vend në suazat e niveleve të ndryshme të popullatës së prekur, për të arritur integrimin, pranimin dhe trajtimin e së kaluarës së dhimbshme dhe ardhmërinë e domosdoshme të përbashkët, si mjete për ballafaqim me të tashmen.”⁵¹ Ai gjithashtu konsideron se procesi i pajtimit përmban katër elemente themelore, të cilat janë të ndërlidhura mes veti dhe ndikojnë tek njëri-tjetri: paqja, drejtësia, e vërteta dhe mëshira/falja.⁵²

Pajtimi shpesh kuptohet si proces kompleks i cili përfshin katër instrumente kryesore të ndërlidhura mes veti: procesi i shërimit të plagëve të mbijetuarve, ndonjë formë e *drejtësisë ndëshkuese* ose *restauruese*, hulumtimi i të vërtetës dhe njohja e publike e saj dhe *reparacionet*.⁵³ Edhe pse në shqyrtimin dhe conceptualizimin e nocionit pajtim mbizotëron mendimi se është e domosdoshme që këto elemente të jenë të lidhura mirë dhe në përputhje njëri me tjetrin, dhe se pajtimi që promovon qëndrimin “çfarë ka ndodhur – ka ndodhur” në asnjë mënyrë nuk mund të jetë qasje e mirë për shoqëritë e lënduara rëndë, megjithatë, shembujt nga pjesë të ndryshme të botës tregojnë se ekzistojnë tensione të përhershme mes këtyre elementeve. Në shumë shoqëri duke përfshirë edhe Bosnjën dhe Hercegovinën, në opinion mbahen diskutime të ashpra rreth asaj se çka është më e rëndësishme për atë shoqëri, e vërteta ose pajtimi; a duhet të ketë përparësi drejtësia ose paqja; a duhet që pajtimi të iniciohet nga shteti apo nga institucionet shtetërore (e aq. qasje “nga poshtë lart”) ose kjo duhet të fillojë nga vet qytetarët/et si aktorë kryesorë të këtij procesi (e aq. “nga poshtë lart”). Reaksione posaçërisht të ashpra, veçanërisht në mesin e disa viktimave, shkakton proklamimi publik për pajtimin si proces i cili ka tendencë për harmoni ndërmjet grupeve të kundërshtarë dhe/ose i cili insiston për falje si parakusht i të gjitha kushteve

⁵⁰ John Paul Lederach. “Civil Society and Conciliation”. Në: C. A. Crocker etj., ur. *Turbulent Peace: The Challenges of Managing International Conflict* (Washington: U.S. Institute of Peace, 1997), fq. 35.

⁵¹ John Paul Lederach. *Building peace: Sustainable Reconciliation in Divided Societies* (Washington: U.S. Institute of Peace, 1997), fq. 35.

⁵² Shiko Lederach. “Civil Society and Reconciliation”.

⁵³ Shiko David Bloomfield, Teresa Barnes dhe Luc Huyse, ur. *Reconciliation After Violent Conflict: A Handbook* (Stockholm: International Institute for Democracy and Electoral Assistance, 2003).

për koekzistencë paqedashëse në të ardhmen.

Duke parë se këto pohime mund të paraqesin vështirësi të këtij procesi shumë të rëndësishëm, Bloomfield sugjeron dallimin e pajtimit si *proces të rindërtimit të marrëdhënieve* që ndodh në nivelin interpersonal dhe i cili përfshin mekanizma kompleks psikologjik, nga pajtimi politik të cilin e përcakton si “një proces më pragmatik dhe më pak ambicioz i cili përfshin zhvillimin e marrëdhënieve efektive dhe politike.”⁵⁴ Pajtimi politik nuk kërkon falje e as dashuri të ndërsjellë mes armiqve të mëparshëm, por fillon me minimumin e bashkëjetesës dhe “gradualisht duke kultivuar respektin themelor si për institucionet e reja ashtu edhe për armiqtë e mëparshëm, ka për qëllim zhvillimin e shprehisë së drejtimit të përbashkët të proceseve shoqërore dhe politike dhe institucioneve.”⁵⁵

Sipas Dan Bar-On, koncepti pajtimit bazohet në bindjen se përveç marrëveshjes juridike dhe politike e cila vjen nga lart poshtë, është i domosdoshëm edhe procesi edukativ dhe socio-psikologjik nga poshtë lart gjatë të cilit do të vijë deri tek ajo që armiqtë e deridjeshëm të heqin dorë nga urrejtja, nga dëshira për hakmarrje, mosbesimi dhe dhimbja, si dhe prej identitetit që është paraqitur gjatë konfliktit. Pritet që identitetet e reja do të formohen së bashku me lidhjet e reja të ish armiqve dhe se ata do të kthehen në rrënjët e konfliktit, e jo vetëm në rezultatet e pakëndshme. Me këtë zvogëlohet edhe rreziku për përsëritjen e dhunës. Bar-On tërheq vëmendjen, gjithashtu, se çdo konflikt ka biografinë e tij dhe se shumë vështirë është për të përkthyer përvojën post-konfliktuale nga njëri kontekst në tjetrin. Kjo paraqet nevojën për rishikimin e vazhdueshëm të asaj se në çfarë mase ajo që i referohet një konteksti është relevante në një kontekst tjetër.

T.SH.

Mohimi

Sipas fjalëve të Stanley Cohen, autorit të librit *Gjendja e Mohimit: Të dish për Krimet dhe Vuajtjet*, nocioni më i shpeshtë i mohimit “ka të bëjë me ruajtjen e botëve shoqërore në të cilat ndonjë situatë e palakmueshme (ngjarje, gjendje, fenomen) nuk pranohet, injorohet ose paraqitet si normale”⁵⁶. Autorët tjerë, si Eviatar Zerubavela, përdorin nocione siç është “komploti heshtjes” që të përshkruajnë situatat në të cilat “njerëzit kolektivisht injorojnë diçka për të cilën secili veç e veç është i vetëdijshëm.”⁵⁷ Ajo heshtje dhe qetësi pas krimeve masovike ka aktorë dhe interese të llojllojshme. Edhe viktimat edhe kryerësit duan të normalizojnë jetët e tyre pas këtyre krimeve masovike për shkak të shkaqeve të ndryshme. Kryerësit qëllimisht mbështesin, krijojnë dhe mirëmbajnë heshtjen që nga njëra anë, t’u shmangen pasojave (juridike dhe të tjerave) të asaj që e kanë bërë; nga ana tjetër, që të ruajnë figurën njerëzore pavarësisht brutalitetit që kanë bërë. Viktimat duan të ruajnë njerëzinë pavarësisht vuajtjeve, poshtërimeve dhe dehumanizimit që e kanë përjetuar. Ndërsa vëzhguesit heshtin pasi që ajo i çliron nga pyetjet e pakëndshme rreth përgjegjësisë personale për mos reagimin në procesin e përgatitjes dhe realizimit të krimit.⁵⁸

⁵⁴ David Bloomfield, “On Good Terms: Claryfying Reconciliation”, fq. 29.

⁵⁵ *Ibid.*

⁵⁶ Stanley Cohen. *Stanje poricanja: Znati za zlodela i patnje*. (Beograd: Semizdat B92, 2003), fq. 89.

⁵⁷ Eviatar Zarubavel. “The Social Sound of Silence: Toward a Sociology of Denial”. Në: Efrat Ben-Ze'ev, Ruth Ginio and Jay Winter, *ur. Shadows of War: A Hocial History of Silence in the Twentieth Century* (Cambridge: Cmabridge Univ. Press, 2011), fq. 32.

⁵⁸ Shiko: Dan Bar-On. *The Incredible and the Indiscussable. Reconstructin Human Discourse after Trauma* (Central European University Press, Budapest, 1999).

Individë, grupe ose shoqëri dhe shtete të tëra ndodhen në gjendje të mohimit atëherë kur u mundësohen “informatat të cilat janë aq të pakëndshme, kanosëse dhe anomale sa që nuk është e mundshme që t’i pranojnë krejtësisht ose t’i pranojnë hapur si të sakta. Për këtë arsye ato shtypen, mohohen, hiqen mënjane ose interpretohen përsëri. Ndonjëherë informatat për veprat e mira “regjistrohen”, por implikimet – konjitive, emocionale, morale – anashkalohen, neutralizohen ose racionalizohen”.⁵⁹ Në qoftë se për diçka jemi njëkohësisht të vetëdijshëm dhe të pavetëdijshëm, kjo nënkupton një dozë të caktuar të mohimit⁶⁰, ndërsa individë dhe shoqëri të tëra mund të jenë në gjendje “në të cilën njëkohësisht dimë dhe nuk dimë”.⁶¹

Varësisht nga ajo që mohohet, Cohen definon tre lloje të mohimit. *Mohimi fjalë për fjalë* është ai mohim kur nuk pranojmë faktet, kur pohojmë se diçka nuk ka ndodhur, pavarësisht nëse vërtetë nuk dimë asgjë rreth asaj ngjarje, gënjejmë me qëllim ose bëhet fjalë për ndonjë mekanizëm mbrojtës të pavetëdijshëm. *Mohimi i interpretimit* është kur pranojmë fakte të caktuara por të njejtave ju mvëshim kuptim ndryshe ose përdorim eufemizma, për shembull, themi se nuk ka pasur spastrim etnik, por që njerëzit kanë ikur vet, askush nuk i ka detyruar të ikin; ose kur vuajtjen e njerëzve e emërojmë si dëm kolateral. Me *mohimin e implikimeve* pranojmë fakte të caktuara se diçka ka ndodhur, pranojmë edhe interpretimin e asaj që ka ndodhur, por refuzojmë të pranojmë se ajo ka të bëjë me ne duke përdorur pretekste “Njeriu i thjeshtë nuk mund të ndikojë në të”, “Dikush tjetër do të kujdeset për të” dhe ngjashëm, si për shembull, kur jemi të njoftuar se në prodhimtarinë e atleteve të cilat i blejmë dhe të cilat i veshim shfrytëzohen fëmijë, të cilët kanë pagë ditore jo humane, nuk kanë sigurim shëndetësor adekuat dhe nuk kanë mundësinë për t’u shkolluar, por ne vazhdojmë ti blejmë ato atlete dhe të mbështesim atë kompani, pasi që ajo nuk ka të bëjë me ne, ose ne “assesi nuk mund të ndikojmë që gjërat të ndryshojnë”.⁶²

Me rëndësi është të kuptojmë se mohimin kolektiv gjithmonë e *ndërton shoqëria*. Përkrahja e heshtjes kolektive është gjeneruar me përhapjen e ndjenjës së turp, dhimbjes ose frikës, ndërsa shtypja grupore që ndodh nga situata e pjesëmarrjes së përbashkët në “komplotin e heshtjes” është një mjet shumë efikas në shuarjen e çështjeve të papërshtatshme dhe të padëshirueshme. Është paradoks që sa më shumë njerëz të marrin pjesë në atë komplot të heshtjes (gjegjësisht bëhen se nuk dinë diçka që është shumë e njohur), mundësia është më e madhe që ajo heshtje të jetë më e “ashpër” ndërsa gjendja e të mohuarit më e gjatë. Cohen thekson se intervenimi, gjegjësisht prishja e gjendjes së të mohuarit është më pak e mundësuar në qoftë se: përgjegjësia është e shpërndarë (gjegjësisht nëse shumë njerëz direkt ose indirekt dëshmojnë për ndonjë ngjarje, dhe përgjegjësia për reagim zhvendoset nga njëri person tek tjetri); kur nuk jemi në gjendje të identifikohemi me viktimën (pasi që viktima është e nacionalitetit tjetër, racës tjetër, fesë tjetër; gjegjësisht kur viktima është e perceptuar si me më pak vlerë ose në procesin e dehumanizimit i janë marrë tiparet e tij njerëzore); kur nuk jemi në gjendje të imagjinojmë intervenim të suksesshëm (gjegjësisht kur çdo mund që japim në atë aspekt duket i kotë dhe i pakuptimtë).⁶³

Por, siç thekson Jay Winter, heshtja rreth ndonjë ngjarjeje asnjëherë nuk zgjat përgjithmonë, ndërsa “e pashprehura dhe e pa thëna rrallë herë mbeten të fiksuara”.⁶⁴ Heshtja kolektive është

⁵⁹ Cohen, fq. 23.

⁶⁰ Zerubavel, fq. 32.

⁶¹ Cohen, fq. 27.

⁶² *Ibid*, fq. 30-33.

⁶³ Shiko, Cohenm fq. 40.

⁶⁴ Jay Winter, “Thinkin about silence”. Në: Efrat Ben-Ze’ev, Ruth Ginio and Jay Winter, ur. *Shadows of War: A Socia History of Silence in the Twentieth Century* (Cambridge Univ. Press, 2011), fq. 23.

pashmangshëm në rritje për shkak të ndikimit të faktorëve të ndryshëm siç janë rrjedhja e thjeshtë e kohës, ndryshimi i marrëdhënieve shoqërore-politike, por edhe ndikimi i të aq. “agjentëve të kujtesës” të cilët në sferën publike insistojnë në lëvizjen e çështjeve të ndërlikuara dhe vazhdueshmërinë e tyre, ndonjëherë edhe me dekada.

Reparacionet

Reparacionet⁶⁴ në kontekstin e drejtësisë tranzicionale, gjegjësisht ballafaqimit me të kaluarën janë mekanizma me të cilat u bëhet kompensim viktimave civile të drejtat e të cilëve janë shkelur rëndë nga ana e pushtetit. Qëllimi i tyre është arritja e një lloji drejtësie për viktimat.

Në rajonin tonë ky mekanizëm nuk zuri rrënjë. Për shembull, në Serbi ku nuk ekziston programi i reparacionit, viktimat përpiqen të realizojnë të drejtat e tyre për kompensim në procedurat gjyqësore kundër Republikës së Serbisë, “duke u thirrur në përgjegjësinë e shtetit për aktet e anëtarëve të forcave të armatosura.”⁶⁵ Këto procese i nisin organizatat për të drejtat e njeriut në emër të viktimave, ndërsa viktimat rrallë herë bëjnë padi – “për shkak të frikës, mos besimit të gjykatave dhe për shkak se shërbimet e avokatëve janë të shtrenjta”.⁶⁶

E drejta viktimës për dëmshpërblim është e caktuar me Rezolutën e KB nr. 60/147, në të cilën, mes tjerash, janë definuar format e dëmshpërblimit, por edhe vet termi “viktimë” me të cilin ka të bëjë kompensimi. Sipas kësaj, viktimat janë persona të cilët:

...kanë pësuar dëm në mënyrë individuale ose kolektive, duke përfshirë lëndimin fizik ose dëmin mental, dhimbjen shpirtërore, humbjen ekonomike ose zvogëlimin e ndjeshëm e të drejtave themelore të tij/saj për shkak të punës ose lëshimeve, që paraqesin shkelje të rëndë të së drejtës penale ndërkombëtare ose shkelje të rëndë të së drejtës ndërkombëtare humanitare. Atje ku kjo është zbatuar dhe është në përputhshmëri me ligjin vendor, termi “viktimë” gjithashtu nënkupton familjen më të afërt, anëtarët që varen drejtpërdrejt nga familja e viktimës dhe personat të cilët kanë përjetuar diçka gjatë përpjekjes për të mbrojtur viktimat në rrezik ose për të parandaluar viktimizimin.”⁶⁷

Format për dëmshpërblim të viktimave janë:

- *restituimi* – që do të duhej të bëjë, kurdo që të jetë e mundshme, kthimin në situatën e cila i ka paraprirë shkeljes së të drejtave: kthimin e lirisë, gëzimin e të drejtave të njeriut, identitetin, jetën familjare dhe shtetësinë, kthimin në vendin e banimit, kthimin në punë dhe kthimin e pasurisë;
- *kompensimi* (dëmshpërblimi) – që do të duhet të sigurohet për çdo dëm ekonomik të vlerësuar, ku marrin pjesë: dëmet fizike dhe mentale, humbja e mundësive për punësim, shkollimi dhe përfitimet sociale, për dëmin material dhe humbjen e përfitimit, duke përfshirë edhe humbjen e aftësisë për punë, dëmin moral, shpenzimet për përfaqësim ligjor, shërimin, ndihmat psiko-sociale;

⁶⁴ Nga fjala angleze *reparation*=kompensim, dëm shpërblim.

⁶⁵ Natasha Kandiq, ur. *Materijalne reparacije za povrede ljudskih prava u prošlosti: Praksa sudova u Republici Srbiji* (Beograd: Fond za humanitarno pravo, 2011), fq. 3.

⁶⁶ *Ibid.*

⁶⁷ *Basic Principles and Guidelines on the Right to a Remedy and Reparation for Victims of Gross Violations of International Human Rights Law and Serious Violations of International Humanitarian Law*. Un General Assembly Resolution 60/47 of 16th December 2005.

- *rehabilitimi* – që do të duhet të përfshijë ndihmën shëndetësore dhe psikologjike, si dhe ndihmën juridike dhe sociale;
- *satisfakcioni* – që duhet ta përbëjnë normat me të cilat në mënyrë efektive ndërpriten lëndime të vazhdueshme, verifikimi i fakteve dhe publikimi i së vërtetës së plotë, kërkimi i të humburve, deklarata zyrtare me të cilën viktimës dhe të afërmeve të tij i kthehet dinjiteti, reputacioni dhe të drejtat, kërkimi publik i faljes që përfshin njohjen e fakteve dhe pranimin e përgjegjësisë, dënimi gjyqësor dhe administrativ i kryerësit, përkujtimet dhe homazhet e viktimave, etj;
- *garancë për mos përsëritje* – që e përbëjnë ato masa të cilat gjithashtu do të kontribuojnë për preventivë.

Drejtësia restauruese

Drejtësia restauruese⁶⁸ është koncept në sistemin juridik-penal i cili zhvillohet në mënyrë të përshpejtuar që nga fillimi i viteve të 70-ta të shekullit XX. Bazohet në traditat e fiseve dhe komuniteteve vendase Afrikane, Amerikës Veriore, Australisë dhe Zelandës së Re, ndërsa elementet e konceptit të së drejtës restauruese janë me siguri aq të vjetra sa janë të vjetra edhe komunitetet shoqërore-politike njerëzore. Koncepti është themeluar në bazë të kritikës së modelit klasik të drejtësisë *retributive/ndëshkuese*⁶⁹ në të cilën kryerja e veprave penale para së gjithash paraqet lëndimin e normës së dhënë juridike, dhe shteti, gjegjësisht sistemi juridik-penal, kanë për detyrë që këtë normë ta mbrojnë duke dënuar kryerësin. Procesi i drejtësisë restauruese në krahasim me të, bazohet në bindjen se vepra penale është lëndim, jo vetëm i rregullave ligjore, por para së gjithash i të drejtave themelore të viktimës dhe vlerave të komunitetit/shoqërisë. Për këtë arsye vëmendje e madhe i jepet nevojës që viktima në mënyrë aktive të marrë pjesë në procesimin e veprës penale, që në mënyrë më humane të veprohet ndaj kryerësve dhe t'i jepet mundësia komunitetit që të marrë pjesë në procesin e riparimit të dëmit, rehabilitimit dhe risocializimit të kryerësit, por edhe të viktimave të tyre.

Nocioni i drejtësisë restauruese kuptohet në mënyra të ndryshme, kështu që ekzistojnë më shumë definicione rreth këtij nocioni. Për shembull, Tony Marshall thekson se drejtësia restauruese është “proces në të cilin palët të cilët kanë marrë pjesë në procesin e caktuar penal bashkërisht gjejnë zgjidhje se si do të merren me pasojat e asaj veprë dhe me implikimet e saj në të ardhmen”.⁷⁰

Drejtësia restauruese bazohet në katër parime themelore: “1) parimi i personalizimit, d.m.th. të kuptuarit e veprës penale para së gjithash si lëndim të njerëzve dhe marrëdhënieve ndërnjerëzore; 2) parimi i riparimit të dëmit të shkaktuar me veprën penale; 3) parimi i pjesëmarrjes (kryerësve, viktimave dhe komunitetit më të gjerë; 4) parimi i riintegritit.”⁷¹

Sot, parimet e drejtësisë restauruese zbatohen në një numër të madh të shteteve të botës, në kontekste të ndryshme dhe deri diku kanë të kuptuarit e ndryshëm sa u përket prioritetëve brenda atij koncepti (a është më i rëndësishëm vet procesi restaurues, ose vëmendjen duhet t'ia përkushtojmë rezultateve të procesit). Edhe OKB-ja edhe organizatat tjera ndërkombëtare

⁶⁸ Nga fjala angleze *restore*=për të restauruar, rinovuar, shëruar, ringjallur.

⁶⁹ Nga fjala angleze *retribute*=për të kthyer, dënuar.

⁷⁰ Tony Marshall, *Restorative Justice: An Overview* (London: Home Office Research Development and Statistics Directorate, 1999), fq. 5.

⁷¹ Sanja Čopić, “Pojam i osnovni principi restorativne pravde”. Në: Temida, maj 2007, fq. 31.

rekomandojnë përdorimin e këtij koncepti i cili mund të gjejë zbatim në spektrin e gjerë të problemeve shoqërore – nga problemet e delikuençës së të miturve e deri tek shërimi dhe ndërtimi i paqes në shoqëritë e ndara të cilat kanë përjetuar luftëra, krime masovike dhe gjenocid. Në kontekstin e shoqërive të tilla zbatimi i drejtësisë restauruese mund të jetë me rëndësi të madhe, veçanërisht kur e kemi ndër mend se ky koncept ka të bëjë jo me konstatimin ose refuzimin, por pranimin e përgjegjësisë nga ana e kryerësit për krimet të cilat i ka bërë si dhe për përpjekjen e riparimit të dëmit për viktimën dhe shoqërinë në tërësi. Drejtësia restauruese, gjithashtu, rrit mundësinë për pjesëmarrje aktive të të gjithë të interesuarve dhe të kuptuarit e ndërsjellë të viktimave dhe kryerësve.

Ky koncept shpesh është i kritikuar si proces i cili në fakt çon drejt shmangies së dënimit për kryerësin e krimit, që prijësit e drejtësisë restauruese e mohojnë këtë duke shprehur ndikim konstruktiv ndaj komuniteteve në të cilat janë zbatuar disa nga modelet e drejtësisë restauruese. Njeri nga modelet e tilla që më shpesh përmendet në literaturë janë *Gacaca* gjykatat në Ruandë të cilat kanë luajtur rol të rëndësishëm në procesin e drejtësisë tranzicionale në shtetin i cili e ka përjetuar gjenocid.

T.SH.

Drejtësia retributive/ndëshkuese

Drejtësia retributive/ndëshkuese është koncept i cili bazohet në bindjen se personat përgjegjës për shkeljen e ligjeve duhet të marrin atë që meritojnë, gjegjësisht të dënohen për veprat e tyre. Logjika e dënimit që qëndron në vet themelin e këtij koncepti nënkupton se me dënim, përsëri vendoset baraspesha në rendin juridik dhe moral, e cila është shkelur me kryerjen e veprës kriminale.

Drejtësia retributive në kontekstin e ballafaqimit me të kaluarën nënkupton emërtimin, arrestimin, organizimin e proceseve gjyqësore, gjykimin dhe vuajtjes së dënimeve për personat përgjegjës për kryerje, projektim ose mbështetje të krimeve dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut. Gjithsesi shembull më të njohur dhe më të hulumtuar të drejtësisë retributive në historinë e re paraqesin proceset e famshme të Nyrnbergut që janë mbajtur gjatë viteve 1945 dhe 1946, gjatë të cilave procese janë gjykuar zyrtarët më përgjegjës të Gjermanisë naziste edhe atë për: krime kundër njerëzimit; krime lufte dhe krime kundër paqes. Në dy dekadat e fundit janë krijuar edhe dy gjykata ndërkombëtare me qëllim të procesuimit të krimeve të luftës në ish Jugosllavi (gjykata me seli në Hagë është themeluar në vitin 1993) dhe në Ruandë (gjykata me seli në Arusha, Tanzania është themeluar në fund të vitit 1994).

Përfaqësuesit e kësaj qasjeje të ballafaqimit me të kaluarën më së shpeshti i japin arsytet e radhës në favor të gjykrimeve të përgjegjësve për krime lufte: a) dekurajimi i kryerësve të ardhshëm potencial nga kryerja e krimit; b) individualizimi i fajit; c) parandalimi dhe preventiva e akteve hakmarrëse të mundshme private dhe marrja e drejtësisë në duart e veta; d) rrëzimi i kulturës së mosndëshkimit dhe mbështetja e vendosjes së rendit moral dhe juridik përsëri. Sipas fjalëve të Martha Minow: “Theximi i përgjegjësisë individuale jep zgjidhje për shmangien e ciklit të fajësimit e cila çon drejt hakmarrjes, kundër akuzave dhe konflikteve nacionale dhe etnike”.⁷²

Kritikat ndaj kësaj qasjeje, gjithashtu, janë të shumta dhe të ndryshme, dhe lëvizin nga

⁷² Minow, *Between Vengeance and Forgiveness*

kritikat ndaj disa pohimeve themelore të vlerave të drejtësisë retributive, përmes mënyrës së organizimit të proceseve gjyqësore, e deri te analiza kritike e ndikimit të tyre në shoqërinë e gjerë dhe procesin e gjerë të ballafaqimit me të kaluarën, kërkit të së vërtetës ose pajtimit. Disa nga vërejtjet e cituara më së shpeshti janë: kufiri jo i qartë ndërmjet gjykimit dhe tentimit për aktet hakmarrëse të cilët mund të kapin edhe personat e pafajshëm; politizimi i proceseve gjyqësore, por edhe i gjykatave (gjegjësisht ekspozimi ndaj ndikimeve politike dhe presioneve, veçanërisht nga ana e shteteve më të fuqishme dhe më të pasura të cilat janë edhe financierët kryesorë të këtyre gjykatave); seleksionimi në zgjedhjen e kryerësve të cilët do të gjykohen (dhe me këtë edhe fakti që lidhet me atë se një përqindje e madhe e kryerësve mbeten jashtë fushëveprimit të këtij lloji të drejtësisë); retroaktiviteti në proceset (të pandehurit gjykohen në bazë të normave dhe me procedura të cilat nuk kanë ekzistuar më herët). Gjithashtu, ka edhe kritika të cilat kanë të bëjnë me shpenzimet e larta të proceseve gjyqësore, të trajtuarit problematik me viktimat dhe ata që kanë mbijetuar gjatë këtyre proceseve gjyqësore; mundësitë e kufizuara për krijimin e të vërtetës së plotë rreth ngjarjeve nga e kaluara. Kritikat e kësaj qasjeje e veçanërisht ata të cilët fokusohen me të madhe tek kryerësit të cilët as që e mendojnë palën e prekur kanë sjellur deri tek zhvillimi i konceptit të drejtësisë restauruese.

Pavarësisht mangësive të shumta, proceset gjyqësore për krime lufte janë një kontribut i rëndësishëm për procesin e ballafaqimit me të kaluarën. Edhe pse në fokusin e tyre nuk kanë rindërtimin e marrëdhënieve, tentim për shërimin e individëve ose kolektivit, e pajtimi as që është qëllimi i tyre primar, proceset gjyqësore mund të japin më së paku verifikimin e fakteve. Për tu arritur proceset tjera të cekura nevojitet që të përdoren mekanizma dhe instrumente tjera në dispozicion.

T.SH.

Imazhet e armikut

Imazhet e armikut janë ato veti, shenja, sjellje, por edhe anekdota dhe barsoleta të cilat ia përshkruajmë "atij tjetrit", kolektivisht, armikut tonë të përbashkët. Ato imazhe janë të domosdoshme që të ekzistojë ndjenja që dikush (gjegjësisht ndonjë grup) është armiku jonë dhe ato shërbejnë vetëm për krijimin dhe mbajtjen e armiqësisë. Me këtë krijohet armiqësia, por edhe armiku, ata janë konstrukt shoqëror që më vonë mund të rritet në një kërcënim real. Siç thotë Sam Keen, "Në fillim ne krijojmë armikun. Përpara armës vjen imagjinata."⁷³ Armiku nuk do të ishte armik sikur mos të zgjojë ndonjë lloj të frikës tek ne, dhe për këtë shkak është e nevojshme që t'i përshkruhen tipare dhe sjellje të tilla të cilat janë të tmerrshme për kontekstin tonë kulturor të cilat janë të papranueshme për shoqërinë. Është e nevojshme që ta dehumanizojnë atë, ta shohin atë si jo njeri. Pasi që, në luftë asnjëherë nuk niset "kundër njerëzve", por "kundër armikut" që është personifikim i të keqes. Shpesh është e mjaftueshme që ndjenja e kërcënimit dhe frikës të rritet mjaftueshëm, që njëra nga palët të sulmojë e para nga nevoja për t'u mbrojtur. Dhe qarku i dhunës fillon të shkoj rreth e rrotull.

Propaganda e luftës merret saktësisht me prodhimin e tepërt të imazheve të armikut. Megjithatë, këto imazhe nuk e luajnë rolin e vet vetëm në kohën e luftës. Për shumë sundimtarë, por edhe ideologjitë e jo lirisë, është e dobishme që të kultivohet armiku kolektiv, pasi që kjo lehtëson punën e sundimit, gjegjësisht manipulimin e masës: Jo, nuk mund të mendojmë për kushtet e këqija sociale (papunësinë/mjerimin/urinë) tani kur armiku bëhet gati të sulmojë ose të

⁷³ Sam Keen, *Faces of the Enemy: Reflections of the Hostile Imagination* (Cambridge: Harper & Row, 1986), fq. 10.

kërcënojnë rendin tonë/identitetin/lirinë/çfarë do qoftë, tani duhet të bëhemi një, atdheu thërret, e kështu me radhë, të marr vetëm shembujt më të qartë.

Shumë imazhe jetojnë në bazë të përvojës së caktuar tragjike, konfliktit, luftës. Dhe për to nuk mund të thuhet se janë të imagjinuara, se janë konstrukt. Ajo që është konstrukt është “armiku” që krijohet dhe kultivohet në bazë të atyre imazheve: atribuiimi i sjelljeve dhe tipare të frikshme ndaj gjithë grupit ose grupeve të njerëzve të cilët me krimet e vërteta kanë vetëm një lidhje – përkatësi në një grup etnik, nacional, politik. Imazhet e tilla është vështirë për t’i thyer pasi që janë të bazuara në përvojën e dhimbshme konkrete, pa marrë parasysh se kanë të bëjnë me njerëz të cilët nuk janë pjesë e asaj përvoje.

Të investosh mund në thyerjen dhe degradimin e imazheve të armikut, sipas përkufizimit, është punë në ndërtimin e paqes. Ndërsa Keen do të thoshte se përpjekja jonë që të kuptojmë arketipet e imazheve të armikut dhe psikologjinë e armiqësisë mund të na kursejë një numër të madh të iluzioneve dhe të na mbrojë nga gabimet e dhimbshme. Mund të na shpëtojë nga ajo që të dehumanizojmë veten duke dehumanizuar armiqtë tanë.⁷⁴

I.F.

Drejtësia tranzicionale

Me nocionin drejtësi tranzicionale⁷⁵ shënohet një set instrumentesh dhe mekanizmash (gjyqësor dhe jashtëgjyqësor) me ndihmën e të cilëve shoqëritë që i kanë kapluar luftërat, ku janë shkelur të drejtat e njeriut rëndë dhe për një kohë të gjatë, ku janë bërë krime të organizuara nga ana e regjimit të mëparshëm, përpiqen të luftojnë me trashëgiminë e rëndë të së kaluarës, përpiqen të realizojnë qeverisjen demokratike të së drejtës dhe të ndalojnë dhunën që mund të përsëritet. Parimet themelore me të cilat është krijuar kjo qasje janë insistimet në përgjegjësinë individuale për krimet e kryera dhe dëmshpërblimin e viktimave të këtyre krimeve të cilat gjenden në fokusin e kësaj qasjeje. Në definicionin e drejtësisë tranzicionale të cilin e jep *Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale (ICTJ)* thekson se “viktimat kanë të drejta të bazuara që: të shohin kriminelët e dënuar, të kuptojnë të drejtën dhe të marrin dëmshpërblim”⁷⁶.

Bazat e konceptit të drejtësisë tranzicionale mund të ndiqen nga fundi i Luftës së Dytë Botërore dhe krijimi i gjykatave të para ndërkombëtare për krime lufte (gjykatat e themeluara në Nyrnberg dhe Tokio). Ky koncept zhvillimin e hovshëm e përjeton duke filluar nga vitet e 70-ta të shekullit XX, ndërsa në vitet e 90-vjen deri tek afirmimi i plotë i kësaj qasjeje, modelet e llojllojshme të së cilës mund të ndiqen në shtetet e Amerikës Jugore, Afrikës, Evropës Lindore, Ballkanit etj.

Struktura ligjore e konceptit të drejtësisë tranzicionale nënkupton “pesë obligimet themelore të shtetit që të sigurohet lufta kundër mos ndëshkimit dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut:

1. Shteti e ka për detyrë të ndërmerr të gjitha masat e domosdoshme që të ndalojë shkeljen e të drejtave të njeriut.
2. Në qoftë se bëhet ndonjë lëshim në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, shteti e ka për detyrë që me efikasitet të hetojë të gjitha akuzat rreth krimeve.

⁷⁴ *Ibid*, fq. 181.

⁷⁵ Në këtë rast nocioni tranzicion nënkupton procesin e kalimit dhe transformimit të sistemit shoqëror nga koha e qeverisjes autoritare ose kohës së luftës drejt sistemit demokratik.

⁷⁶ The Internacional Center for Transitional Justice, ictj.org/about/transitional-justice.

3. Shteti e ka për detyrë të emërojë se kush janë viktimat, dhe kush janë kriminelët.
4. Shteti e ka për detyrë të ndjekë penalisht të gjithë ata për të cilët ekziston dyshim themelor se kanë dhënë urdhër ose personalisht kanë kryer krim, dhe të organizojë procedurë penale të drejtë dhe efikase.
5. Shteti ka për detyrë të zhvillojë programe riparimi për viktimat për shkak të vuajtjeve që i kanë kaluar, që të zvogëlohen pasojat e krimeve dhe që të realizohet ndjenja e plotë e drejtësisë⁷⁷.

Përkufizimi tradicional i drejtësisë tranzicionale njeh katër mekanizma themelorë me ndihmën e të cilëve shteti përpiqet të përmbush detyrat e më poshtme:

- Ndjekjen penale të të akuzuarve për krime
- Reparacionet/dëmshpërblimet viktimave
- Reformat institucionale
- Kërkimi i së vërtetës dhe verifikimi (ose të treguarit e të njëjtës)

Mirëpo, zhvillimi i drejtësisë tranzicionale më shumë se gjysmë shekulli tregon se tejkalimi i pasojave të regjimeve autoritare dhe/ose totalitare kërkon atë që mund të quhet shoqërizimi i procedurave ligjore⁷⁸. Disa masa siç janë kërkimi i faljeve në publik i përfaqësuesve/eve të legjitimuar politik, krijimi i institucioneve të përkujtimit, futja e drejtësisë gjinore, puna e komisioneve për të vërtetën dhe për pajtim... kanë pasur një kontekst të gjerë shoqëror. Ato kërkojnë veprim të përbashkët jo vetëm të institucioneve juridike, por edhe të pjesës tjetër të shoqërisë: mediave, arsimit, strukturave akademike, caktimin publik të elitës politike dhe ngjashëm.

Shumica e përkrahësve/eve të drejtësisë tranzicionale shumë rëndësi i japin qasjes holistike të këtij koncepti multi-disiplinar, me theks të veçantë se me asnjërin mekanizëm “nuk mund të arrihen vetvetiu qëllimet e të drejtës tranzicionale. Të gjithë mekanizmat e përmendur kanë përparësitë dhe mangësitë e tyre dhe asnjëri vetvetiu nuk është i mjaftueshëm që me ndihmën e tij tërësisht të fshihen pasojat e krimit, e as të arrihen të gjitha qëllimet e parashikuara. Është e nevojshme të vendoset qasje e integruar dhe të sigurohet që aktivitetet të zbatohen në mënyrë simultane”.⁷⁹

T.SH.

Viktimizimi

Kuptimi themelor i nocionit *viktimizim* nënkupton procesin në të cilin një individ ose grup bëhet viktimë e dhunës direkte ose strukturore (diskriminimit, poshtërimit dhe shkatërrimit të të drejtave themelore të njeriut). Këtu bëhet fjalë për viktimizimin *primar*. Deri tek viktimizimi *sekondar* arrihet në qoftë se viktimat pas përvojës së dhunës përjeton dhunë të mëtejshme dhe ndikim negativ nga ana e rrethit shoqëror, për shembull, nga policia të cilës i është drejtuar ose sistemit gjyqësor, familjes së saj dhe rrethit, etj. Pastaj, ekzistojnë viktimat *direkte* dhe *indirekte*.

⁷⁷ Draman M. Popoviq. *Vodič kroz tranzicijsku pravdu u Bosni i Hercegovini* (Sarajevo: UNDP BiH, 2009), fq. 16.

⁷⁸ Shiko: Vesna Rakitiq-Vodinelq. “Uvod u tranzicionu pravdu: osnovni pojmovi.” Në: *Genero: Časopis za feminističku teoriju*, nr. 10/11, 2007.

⁷⁹ Draman M. Popoviq. *Vodič kroz tanzicijsku pravdu*, fq. 16.

Viktima direkte janë ata persona të cilët kanë qenë të ekspozuar ndaj dhunës, ndërsa viktimat indirekte mund të jenë pjesëtarët e tyre të familjes ose shokët, dëshmitarë të ngjarjes, bile edhe familjet e kryerësve të krimeve, të cilët bartin traumën ose vuajnë pasoja të tjera të dhunës së shkaktuar.

Pas luftës dhe dhunës në përmasa të mëdha, për procesin e ballafaqimit të kaluarës së dhunshme dhe ndërtimin e paqes së qëndrueshme me rëndësi është të njohësh viktimat, të pranosh dhe të vlerësosh vuajtjet dhe humbjet e tyre, dhe të ofrosh mundësinë e kompensimit, gjegjësisht dëmshpërblimin për dhimbjen e vuajtur. Veçanërisht e rëndësishme është që viktimat të individualizohen, dhe të sigurohet rehabilitimi i domosdoshëm psikik dhe social.

Kuptimi tjetër i termit të viktimizimit ka të bëjë me procesin në të cilin i gjithë grupi pranon identitetin e viktimës në bazë të dhunës që kanë përjetuar disa përfaqësues të grupit, por jo edhe i gjithë grupi. Ky proces emërohet edhe si *viktimizim kolektiv* ose *vetviktimizimi kolektiv*. Kjo dukuri është pasojë e shpeshtë e konflikteve të gjata të dhunshme ose dhunës në përmasa të mëdha. Kur grupi fokusohet në të keqen, padrejtësinë, vuajtjen dhe krimet që ka bërë kundërshtari, ndërsa njëkohësisht veten e sheh si të drejtë, me moral dhe human, shumë lehtë vjen deri tek përfundimi se ata vet janë viktima. Të kuptuarit e tillë me vete tërheq edhe bindjen se konfliktin e ka imponuar kundërshtari i cili jo vetëm që ka qëllime të padrejta, por edhe shërbehet me mjete të pamoralshme.⁸⁰ Sipas rregullave duke u futur në rolin e viktimës e hedhim rolin e përgjegjësisë edhe për fillimin e konfliktit edhe për dhunën e bërë ndaj kundërshtarit, kjo na fut në pozitën e superioritetit moral dhe na jep arsytet për vazhdimin e luftës kundër kundërshtarit. Të shumta në numër janë funksionet dhe pasojat e marrjes së rolit të viktimës.⁸¹ Vjen deri tek rritja e ndjenjave nacionaliste dhe patriotike, deri tek potenciali për mobilizim dhe gatitshmëria për sakrificë për shkak të qëllimit më të lartë, por edhe deri te sulmet “preventive” ndaj kundërshtarit, madje edhe deri tek krimet kundër atyre të cilët përjetojnë si armiq. Këto janë kushtet ideale që ata të cilët ndjehen si viktima të bëhen kryerës të krimeve. Kur janë të bindur se janë moralisht superior, gjegjësisht se janë të drejtë, njerëzit janë në gjendje të bëjnë krime të pabesueshme.⁸²

Roli i viktimës bëhet pjesë përbërëse e identitetit grupor, gjegjësisht siç vëren Ian Buruma, identiteti gjithnjë e më shumë mbështetet në pseudoreligjionin e viktimizimit.⁸³ Ai bëhet ind lidhës i shoqërisë. Njëra nga pasojat e këtij imazhi për veten, e krijuar në “rolin e tepruar mitik të viktimës”, është ajo se grupi mbetet i pandjeshëm për vuajtjen e tjerëve.⁸⁴ Viktimizimi kolektiv më së shpeshti i pason procesi i konkurrencës mes viktimave për statusin e viktimës “më të madhe”. Kjo është veçanërisht e dukshme në shoqëritë në të cilat ndarjet armiqësore, gjeografike dhe mentale, mbijetojnë edhe pas përfundimit të ndodhive luftarake. Në kontekstin tonë post-jugosllav të pas luftës, e dukshme është se ekziston pandjeshmëri e madhe për viktimat direkte, përveç se në rastet kur ato për ndonjë arsye janë të nevojshme për komunitetin. Diane Enns mirë vëren se “atje ku të gjithë janë viktima, askush nuk është viktimë”.⁸⁵ Kështu që, insistimi në vetviktimizim si pasojë mund të ketë mosnjohje ose minimizim të vuajtjes që e kanë përjetuar viktimat direkte të dhunës, që mund të sjellë deri tek viktimizimi i mëtejshëm (viktimizimi

⁸⁰ Daniel Bar-Tal. “Social beliefs in times of intractable conflict: The Israeli case”. Në: *International Journal of Conflicts Management*, 9, 1998: 22-50.

⁸¹ Shiko: Daniel Bar-Tal dhe tjerë. “A sense of self-perceived collective victimhood in intractable conflicts”. Në: *International Red Cross Review*, Vol. 91, No. 877, qershor 2009: 229-277.

⁸² Diane Enns. *The Violence of Victimhood* (University Park: Pennsylvania State University Press, 2012), fq. 37-62.

⁸³ Ian Buruma. “The Joys and Perils of Victimhood”. Në: *New York Review*, Vol. 46, Nr. 6, 1999, fq. 6.

⁸⁴ Assmann. *Duga senka prošlosti*, fq. 97.

⁸⁵ Diane Enns. “Identity and Victimhood. Questions for Conflict Management Practice” in *Berghof Occasional Paper* No.28, maj 2007, fq. 3.

sekondar), gjegjësisht siç thotë Kenak Efendiq:

Është e qartë se produkti më i dhimbshëm i luftës është viktimat dhe trauma e tij, mirëpo, trauma është gjithmonë individuale dhe viktimat është gjithmonë individuale, por qendrat e fuqisë etnonacionaliste traumën e ngrisin në nivelin e komunitetit/kolektivit, gjatë së cilës viktimat e caktuar është e depersonalizuar dhe e pafuqishme, pasi që për të është i nevojshëm rehabilitimi psikik dhe ekzistencial dhe kënaqësia juridike dhe e drejtë. Paralelisht me procesin e ngritjes së traumës dhe dhimbjes nga individit në kolektiv dhe përgjegjësia për krimin ngritet nga niveli i individit dhe institucionit politik-ushtarak në nivelin tjetër, të kolektivit, ndërsa kjo nuk është asgjë tjetër vetëm se vazhdimi i luftës në paqen formale.⁸⁶

Ky vetviktimizim kolektiv i gërshetuar në identitetin e grupit mund të transferohet nga gjenerata në gjeneratë. Gjegjësisht, grupi mund të bartë traumë jo për shkak të përvojës së vështirë të cilën ka përjetuar i gjithë grupi ose vetëm njëri nga anëtarët e tij, por për shkak të ngjarjeve traumatike që kanë përjetuar paraardhësit e tyre. Vamik Volkan këtë dukuri e emërton si *traumë të zgjedhur*.⁸⁷ Bëhet fjalë për një fenomen i cili nuk është thjeshtë përkujtim i vuajtjeve nga e kaluara, por shfaqje e përbashkët mentale e ndonjë ngjarjeje të kaluar tragjike e cila përfshin edhe informatat reale rreth asaj ngjarjeje, si dhe ndjenjat që janë shumë intensive.⁸⁸ Ndjenja e nënçmimit të madh ose padrejtësisë që mund të ndajë grupi mund të jetë e rrezikshme, pasi që parandalon edhe individët/et edhe gjithë grupin që në mënyrë konstruktive të mbaj zi për humbjet dhe të transformojë konfliktet të cilat kanë të bëjnë me atë traumë. Atëherë në nivelin individual, personi i traumatizuar bëhet i fiksuar me viktimizimin e tij pa katarsë dhe pa tejkalimin e përvojës së kaluar. Ndërsa, kur viktimizimi në të kaluarën bëhet temë qendrore e narrativeve shoviniste për terrorin nacional dhe për viktimizimet e kaluara, ai mund të shërbejë si arsytim për dhunën në ditën e sodit ndaj anëtarëve të grupit të cilët ndjehen përgjegjës për viktimizimin nga e kaluara dhe me këtë të vazhdojnë rrethin e viktimizimit, frikës dhe hakmarrjes së “drejtë”.

Volkan vëren se liderët kanë intuitë dhe e dinë se si të riaktivizojnë traumën e zgjedhur, veçanërisht kur grupi është në konflikt ose kur ka ardhur deri tek ndonjë ndryshim drastik dhe është e nevojshme që përsëri të verifikohet dhe të përforcohet identiteti grupor.⁸⁹

Prandaj, viktimizimi kolektiv është një bombë e kurdisur, në qoftë se, me të manipulohet ose në qoftë se ndikimi i saj nënvlerësohet dhe anashkalohet, gjegjësisht në qoftë se nuk punohet në deviktimizim. Definitivisht, kjo është njëra nga detyrat me prioritet të lartë në punën për ndërtimin e paqes.

I.F, T.SH.

⁸⁶ Kenan Efendiq. “Tri skice za tekući Potop.” Në: (sic!) časopis za po-etička istraživanja i djelovanja, 25.06.2010, fq. 54.

⁸⁷ Shiko p.sh. Vamik Volkan. *Bloodlines: From Ethnic Pride to Ethnic Terrorism* (New York: Farrar, Straus and Giroux, 1997).

⁸⁸ Njëra nga ngjarjet më të njohura të traumës së zgjedhur katë bëjë me Betejën e Kosovës të vitit 1389 dhe rëndësia e gjithë mitit të Kosovës në konstruimin e identitetit serb.

⁸⁹ Vamik Volkan. “Transgenerational Transmissions and Chosen Traumas: An Aspect of Large-Group Identity.” Në: *Group Analysis*, Vol. 34, No. 1, 2001, fq. 88.

Bibliografija:

- Abu-Nimer, Mohammed, ur. *Reconciliation, Justice and Coexistence: Theory and Practice* (Lanham: Lexington Books, 2001).
- Aleida Assmann. *Duga senka prošlosti: Kultura sećanja i politika povesti*. Prevod s nemačkog: Drinka Gojković (Beograd: Biblioteka XX vek, 2011).
- Anderson, Benedict. *Imagined Communities: Reflections on the Origin and Spread of Nationalism* (London, Verso: 1983).
- Bar-On, Dan. *Tell Your Life Story. Creating Dialogue among Jews and Germans, Israelis and Palestinians* (Budapest: CEU Press, 2006).
- Dan Bar-On. *Reconciliation revisited: For more conceptual and empirical clarity*. Predavanje u Centru za interdisciplinarne postdiplomske studije Univerziteta u Sarajevu, 2005. Dostupno na: www.war-crimes-genocide-memories.org/fajlovi/lectures/02_lectures__danBarOn.pdf.
- Bar-On, Dan. *The Indescribable and the Indiscussable. Reconstructing Human Discourse after Trauma* (Budapest: Central European University Press, 1999).
- Bar-Tal, Daniel. "Societal beliefs in times of intractable conflict: The Israeli case". U: *International Journal of Conflict Management*, 9, 1998: 22-50.
- Bar-Tal, Daniel i dr. "A sense of self-perceived collective victimhood in intractable conflicts." U: *International Red Cross Review*, Vol. 91, No. 877, jun 2009: 229-240.
- Bell-Fialkoff, Andrew. "A Brief History of Ethnic Cleansing." U: *Foreign Affairs* 72/3, 1993: 110-121.
- Billig, Michael. *Banalni nacionalizam*. Prevod s engleskog: Veselin Kostić (Beograd: Biblioteka XX vek, 2009).
- Bloomfield, David. "On Good Terms: Clarifying Reconciliation". U: *Berghof Report* br. 14, oktobar 2006.
- Bloomfield, David, Teresa Barnes i Luc Huyse, ur. *Reconciliation After Violent Conflict: A Handbook* (Stockholm: International Institute for Democracy and Electoral Assistance, 2003).
- Brahm, Eric. "Lustration." U: Burgess, Guy i Heidi Burgess, ur. *Beyond Intractability*. Conflict Information Consortium, University of Colorado, Boulder, June 2004 <<http://www.beyondintractability.org/biessay/lustration>>.
- Buruma, Ian. "The Joys and Perils of Victimhood." U: *The New York Review*, Vol. 46, No. 6, 1999: 4-8.
- Cobban, Helena. *Amnesty After Atrocity. Healing Nations After Genocide and war Crimes* (Boulder, London: Paradigm Publishers, 2007).
- Cohen, Stanley. *Stanje poricanja: Znati za zlodela i patnje*. Prevod: S. Glišić (Beograd: Samizdat B92, 2003).
- Čabaravdić, Sabina. "Lustracija izostala na Balkanu". *Radio Slobodna Evropa*, 23.05.2010, <www.slobodnaevropa.org/content/tema_sedmice_lustracija/2050239.html>.
- Čopić, Sanja. "Pojam i osnovni principi restorativne pravde". U: *Temida*, maj 2007: 25-35.
- Dudouet, Véronique, Martina Fischer i Beatrix Schmelzle. *Dealing with the Past in Israel-Palestine and in the Western Balkans. Story-telling in Conflict: Developing Practice and Research*. Workshop Report. Berghof Working Paper 5, 2008.
- Duhaček, Daša i Obrad Savić, ur. *Zatočenici zla: Zaveštanje Hane Arent*. Prevod: Aleksandra Kostić (Beograd: Beogradski krug, 2002).
- Đerić, Gordana. "Postkomunistička izgradnja sećanja: između 'velike priče' i (dnevno)političkog mita." U: *Etnoantropološki problemi*, n.s. god. 5. sv. 3, 2010: 99-116.

- Efendić, Kenan. "Tri skice za tekući Potop." U: (sic!) časopis za po-etička istraživanja i djelovanja, 25.06.2010: 51-55.
- Enns, Diane. *The Violence of Victimhood* (University Park: Pennsylvania State University Press, 2012).
- Enns, Diane. "Identity and Victimhood. Questions for Conflict Management Practice". *Berghof Occasional Paper* No. 28, maj 2007
- Franović, Ivana. "Mirovno obrazovanje kao pokretač društvenih promena". U: Rill, H., T. Šmidling, A. Bitoljanu, ur. *20 poticajaza buđenje i promenu* (Beograd-Sarajevo: Centar za nenasilnu akciju, 2007): 90-102.
- Franović, Ivana. "Dealing with the Past in the Context of Ethnonationalism. The Case of Bosnia-Herzegovina, Croatia and Serbia". *Berghof Occasional Paper* No. 29, oktobar 2008.
- Galtung, Johan. "After Violence, Reconstruction, Reconciliation, and Resolution: Coping with Visible and Invisible Effects of War and Violence." U: Abu-Nimer, Mohammed, ur. *Reconciliation, Justice and Coexistence: Theory and Practice* (Lanham: Lexington Books, 2001): 3-23.
- Halbwachs, Maurice. *On Collective Memory*. Translated by Lewis A. Coser. (Chicago: The University of Chicago Press, 1992).
- Halbwachs, Maurice. "Kolektivno i istorijsko pamćenje". Prevod s francuskog: Aljoša Mimica. U: *Reč: časopis za književnost i kulturu, i društvena pitanja*, br. 56.2: 63-82.
- Hayner, Priscilla B. *Neizrecive istine: Suočavanje s državnim terorom i zverstvima*. Prevod: G. Vučićević (Beograd: Samizdat B92, 2003).
- Helmick, Raymond G. and Rodney L. Petersen and S.J. Petersen. *Forgiveness and reconciliation: Religion, public policy, and conflict transformation* (Philadelphia: Templeton Foundation Press: 2002).
- Japers, Karl. *Pitanje krivice*. Prevod: Vanja Savić (Beograd: SamizdatFreeB92, 1999).
- Kandić, Nataša, ur. *Materijalne reparacije za povrede ljudskih prava u prošlosti: Praksa sudova u Republici Srbiji* (Beograd : Fond za humanitarno pravo, 2011).
- Keen, Sam. *Faces of the Enemy: Reflections of the Hostile Imagination* (Cambridge: Harper & Row, 1986).
- Kuljić, Todor. *Kultura sećanja: Teorijska objašnjenja upotrebe prošlosti* (Beograd: Čigoja štampa, 2006).
- Lederach, John Paul. *Building Peace: Sustainable Reconciliation in Divided Societies* (Washington: U.S. Institute of Peace, 1997).
- Lederach, John Paul. "Civil Society and Reconciliation". U: C. A. Crocker i dr., ur. *Turbulent Peace: The Challenges of Managing International Conflict* (Washington D.C.: USIP, 2001): 841-854.
- Lilić, Stevan. "Lustracija da ili ne?". U: *Danas*, 06.11.2001.
- Marshall, Tony. *Restorative Justice: An Overview* (London: Home Office Research Development and Statistics Directorate, 1999).
- Minow, Martha. *Between Vengeance and Forgiveness: Facing History after Genocide and Mass Violence* (Boston: Beacon Press, 1998).
- Oz, Amos. "Krivica i odgovornost". U: *Reč*, 9. jun 1999. <www.b92.net/casopis_rec/arhiva/oz.html>.
- Popović, Dragan M. *Vodič kroz tranzicijsku pravdu u Bosni i Hercegovini* (Sarajevo: UNDP BiH, 2009).
- Preece, Jennifer Jackson. 'Ethnic Cleansing as an Instrument of Nation-State Creation: Changing State Practices and Evolving Legal Norms.' U: *Human Rights Quarterly* 20, 1998: 817-842.
- Rakić-Vodinelić, Vesna. "Uvod u tranzicionu pravdu: osnovni pojmovi." U: *Genero: Časopis za feminističku teoriju*, br. 10/11, 2007.
- Ramet, Sabrina. "Srpska i hrvatska povijesna naracija". U: *Anali Hrvatskog politološkog društva*, Vol.3. No.1. Svibanj 2007: 299-324.
- Renan, Ernest. "What is a nation?" U: Homi Bhabha, ed. *Nation and Narration*. Translated and annotated by Martin Thom (London: Routledge, 1990): 8-22.
- Rigby, Andrew. *Justice and Reconciliation after the Violence* (London: Lynne Rienner Publishers, 2001).

Rigby, Andrew. "Forgiving the Past": paths towards a culture of reconciliation." Paper presented at the IPRA Conference. Tampere, Finland: August, 2000.

Rill, Helena, Tamara Šmidling, Ana Bitoljanu, ur. *20 poticaja za buđenje i promenu: o izgradnji mira na prostoru bivše Jugoslavije* (Beograd-Sarajevo: Centar za nenasilnu akciju, 2007).

Sloterdijk, Peter. *Der starke Grund zusammen zu sein Sonderdruck: Erinnerungen an die Erfindung des Volkes*, 2. Auflage (Frankfurt am Main: Suhrkamp, 1998).

Smith, Anthony D. *National Identity* (London: Penguin Books, 1991).

Stanton, Gregory H. *The 8 Stages of Genocide*. Genocide Watch, 1998. Dostupno na: <http://www.genocidewatch.org/genocide/8stagesofgenocide.html>.

Ugrešić, Dubravka. *Kultura laži: antipolitički eseji* (Beograd: Fabrika knjiga, 2008).

Volkan, Vamik. "Transgenerational Transmissions and Chosen Traumas: An Aspect of Large-Group Identity." U: *Group Analysis*, Vol. 34, No. 1, 2001: 79-97.

Volkan, Vamik. *Bloodlines: From Ethnic Pride to Ethnic Terrorism* (New York: Farrar, Straus and Giroux, 1997).

Vukosavljevic, Nenad. 'Training for Peacebuilding and Conflict Transformation. Experiences of the "Centre for Nonviolent Action" in the Western Balkans.' U: *Online Berghof Handbook for Conflict Transformation* (Berlin: Berghof Research Center for Constructive Conflict Management, 2007).

Winter, Jay. "Thinking about silence". U: Ben-Ze'ev, Efrat, Ruth Ginio i Jay Winter, ur. *Shadows of War: A Social History of Silence in the Twentieth Century* (Cambridge: Cambridge Univ. Press, 2011): 3-31.

Zerubavel, Eviatar. "The social sound of silence: Toward a sociology of denial". U: Ben-Ze'ev, Efrat, Ruth Ginio i Jay Winter, ur. *Shadows of War: A Social History of Silence in the Twentieth Century* (Cambridge: Cambridge Univ. Press, 2011): 32-44.

Dokumente:

Basic Principles and Guidelines on the Right to a Remedy and Reparation for Victims of Gross Violations of International Human Rights Law and Serious Violations of International Humanitarian Law. UN General Assembly Resolution 60/147 of 16 December 2005, <www2.ohchr.org/english/law/remedy.htm>.

Final Report of the United Nations Commission of Experts Established Pursuant to Security Council Resolution 780 (1992), S/1994/674, *Annex IV: The policy of ethnic cleansing*, pr. M. Cherif Bassiouni, <www.ess.uwe.ac.uk/comexpert/report_toc.htm>.

General Assembly of the United Nations, *Convention on the Prevention and Punishment of the Crime of Genocide*, Resolution 260 A (III) of 9 December 1948, <www2.ohchr.org/english/law/genocide.htm>.

Faqe interneti:

Beyond Intractability, www.beyond-intractability.org

Centre for Justice and Reconciliation, www.restorativejustice.org

Priručnik za rad na suočavanju sa prošlošću Documenta – Centar za suočavanje s prošlošću, www.documenta.hr

Fond za humanitarno pravo, www.hlc-rdc.org

Koalicija za REKOM, www.zarekom.org

Međunarodni krivični sud za bivšu Jugoslaviju (MKSJ), www.icty.org

The Berghof Handbook for Conflict Transformation, www.berghof-handbook.net

The International Center for Transitional Justice, www.ictj.org/about/transitional-justice

Doracakë për trajnime/punëtori:

Fitzduff, Mary. *Community Conflict Skills. A Handbook for Group Work in Northern Ireland*, treće izdanje, 1997.

Vukosavljević, Nenad. *Nenasilje? Priručnik za treninge iz nenasilne razrade konflikata za rad s odraslima* (Sarajevo: CNA, 2000).

Dokumentacione tje trajnimeve tje QAP

Trajnime bazike:

Mocartov brat je bio crnac, Mavrovo, 6–16.07.2012.
Dokumentacija, Ulcinj, 20–30.04.2012.
Ponesite sposobnost samoreprodukcije, Tivat, 11.03–21.03.2011.
More, Sonce, Oblaci, Tivat, 19–29.03.2010.
Mišo Kovač FUN CLUB, Ohrid, 08–18.10.2010.
Dinosauri iz Arizone, Ulcinj, 23.10–02.11.2009.
Kafana "Kod Keme", Tivat, 20.03–30.03.2009.
Dokumentacija Osnovnog treninga iz izgradnje mira, Ulcinj, 4–13.04.2008.
Grupa HMBIHKS u epizodi Tajna starog tavana, Travnik, 19–29.10.2007.
Jeste, jeste, Tivat, 9–19.3.2007.
Osam miliona Kineza, Travnik, 8–18.12.2006.
Šlegnutost, Travnik, 23.6–3.7.2006.
Markovi konaci, Tivat, 7–17.4.2006.
Nisam ja!, Jahorina, 5–15.8.2005.
Ko će ako ne mi?, Tivat, 28.1–7.2.2005.
Razvedranje u glavama, Tivat, 21–31.10.2005.
Dokumentacija, Vogošća, 10–20.12.2004.
333-222, Tivat, 29.10–8.11.2004.
Ma nek' ide život!, Ulcinj, 16–26.4.2004.
Tupilo od nekuženja, Tivat, 20.2–1.3.2004.
Skok u nepoznato 2, Hajdučke vode, 2–12.5.2003.
Tko šuti muti, Vogošća, 13–23.12.2002.
Teretana, Jahorina, 26.7–5.8.2002.
Ču'sh pravo na rad, Jahorina, 17–27.5.2002.
Pozivam narod da pusti muziku, Ulcinj, 12–22.4.2002.
Ma nek' je nama dobro, ba!, Kiseljak, 7–17.12.2001.
Svak se svom Bogu moli, otsutra, Ulcinj, 9–19.11.2001.

Tektonski poremećaji, Žabljak, 22.6–2.7.2001.

Ovo još nije počelo, Rama, 8–18.6.2001.
Ko ima uši, čuje, Kiseljak, 23.02–5.03.2001.
P(L)INK!, Banovići, 21.4–2.5.2000.
Mrdni malo! Kiseljak, 25.2–6.3.2000.
Ovo je kaša-popara! Trebinje, 19–29.11.1999.
Conflict? Nonviolence?, Tata (Mađarska), 29.7–9.8.1999.
Zovi me loncem, ali me ne razbijaj, Teslić, 20–31.7.1998.
Izveštaj sa Treninga iz nenasilne razrade konflikata, Budimpešta, 1–11.6.1998.
Zdravo, Radovane! Kako si, Mujo?, Segedin, 30.12–9.1.1998.

Trajnime tje avancuara:

Napredni trening iz nenasilne razrade konflikata (Jahorina, 24.6–4.7.2005, Kikinda, 5–10.8.2005)
Napredni trening iz izgradnje mira (Jahorina, 4–14.8.2006, Ulcinj, 4–10.10.2006)
Napredni trening iz izgradnje mira (Jahorina, 08–18.08.2008, Tivat, 06–13.10.2008)
Korak dalje u izgradnji mira – vrednosti i prakse, 2011:
"Treba li nam pomirenje? Mogućnosti, prepreke, izazovi.", Blagaj, 17–23.06.2011.
"Šta možemo, kako i zašto? Preispitivanje praksi izgradnje mira", Zrenjanin, 29.07–04.08.2011.
"Hodanje neutabanim stazama. izazovi u radu na izgradnji mira", Andrevlje, 07–13.10.2011.

Trajnime pje trajnues/e:

4. program, jul 2002 – maj 2003:
Je l' jasno, Jahorina, 5–15.7.2002.
Farbala sam ogradu, Kolašin, 23.8–2.9.2002.
Daj novu grupu, Bečej, 23–28.10.2002; Bečej, 13–18.12.2002.
5. program, juli 2003 – maj 2004:
Možda je moguće, Jahorina, 4–14.7.2003.
Il' si lud ili kuću praviš, Bjelašnica, 11.8–1.9.2003.
Superbugarin, Ulcinj, 17–22.10.2003, Vogošća, 6–15.12.2003.

Trajnime me pjesëmarrës në luftëra:

Sastanak učesnika ratova: Ideje i planovi za zajedničke akcije, Brčko, 08–10.06.2012.

Kultura sjećanja, 20–22.05.2011.

Trening za veterane 2010, Faza I, 11–14.06.2010.

Trening za veterane 2010, Faza II, 09–12.07.2010.

Trening za učesnike ratova; Jahorina, 25–29.06.2009; Šamac, 31.07–04.08.2009.

Trening za učesnike ratova; Jahorina, 16–20.05.2008; Ilidža, 20–24.06.2008.

Trening za učesnike ratova; Bjelašnica, 26–31.05.2006; Jahorina, 14–17.07.2006.

Trening za učesnike ratova; Bjelašnica, 06–12.08.2004; Jahorina, 24–27.09.2004.

Dokumentacija treninga sa učesnicima rata, Ulcinj, 30.04–06.05.2003.

Dokumentacija treninga sa učesnicima rata, Bjelašnica, 13.06–16.06.2003.

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

061.2:[316.354.355.1

FRANOVIQ, Ivana

Pajtimi?! : doracak për punë me ballafaqimin me të kaluarën përmes trajnimeve dhe punëtorive / [Ivana Franoviq, Nenad Vukosavljeviq, Tamara Shmidling ; përkthimi Ardian Saliu]. - Prilep : Aksioni paqësor, 2020. - 146 стр. ; 21 см

Превод на делото: Pomirenje?! : prirucnik za rad na suocavanju sa prosloscu kroz treninge i radionice. - Фусноти кон текстот. -

Библиографија: стр. 141-145

ISBN 978-608-4883-07-4

1. Vukosavljeviq, Nenad [автор] 2. Shmidling, Tamara [автор]

а) Невладини организации - Ресоцијализација на воени лица - Прирачници

б) Ментално здравје - Прирачници

COBISS.MK-ID 112331530

